VENDIM
Nr.831, datë 28.12.2023

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË ZONAVE ARKEOLOGJIKE "A" DHE "B" TË QYTETIT TË DURRËSIT 2023-2030

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 47, të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të zonave arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit 2023-2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Albanian-American Development Foundation

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Plani i Menaxhimit
i Zonave Arkeologjike A dhe B të Qytetit të Durrësit
2023-2030

Përgatitur nga:

A.R.S. Progetti S.P.A.
Ambiente Risorse Sviluppo

Përgatitur për
Ministrinë e Kulturës, Shqipëri

Financuar nga
Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)

Përgatitur nga: ARS Progetti S.P.A, Romë, Itali

ARS Progetti dëshiron të falënderojë të gjithë ata që janë përfshirë në këtë projekt, veçanërisht angazhimin personal të Ministres së Kulturës, arkitektes Elva Margariti dhe stafit të Ministrisë së Kulturës, znj. Arta Dollani, znj.Kozeta Angjeliu Drejtor MK dhe znj.Rudina Zoto.

Falënderohet, gjithashtu, Instituti i Arkeologjisë, Prof.Dr.Luan Përzhita, Rektor i Akademisë së Studimeve Albanalogjike. Falënderime të veçanta Bashkisë së Durrësit, Kryetares së Bashkisë znj. Emirjana Sako dhe Nënkryetarit të Bashkisë znj. Florian Tahiri për ndarjen e të dhënave dhe mikpritjen e tyre. Falënderohet, gjithashtu, z.Elio Bajramaj, Drejtori i Qendrës Kulturore të qytetit. Një falënderim i ngrohtë i drejtohet, gjithashtu, arkeologut z. Eduard Shehi për ndarjen e njohurive të tij për thesaret arkeologjike të Durrësit. Falënderime të veçantë Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe në veçanti Dr.Ilir Parangonit (menaxher projekti) për udhëzimet dhe qëndrimin e tij bashkëpunues.

2023

Figurë 1 –Kapaku, panorama e amfiteatrit të Durrësit e parë nga lart
Figurë 2 –Faqja vijuese, hartë historike e Durrësit, fundi i shekullit XIX (e panjohur)

Porta Romana
Bishti i Pallës
Prenja
Rrushkull
Juba
Juba Veli Beut
Lumi Erzeni
Qerreti
Livadhi i Madh
Flake
Porta Romane
Cortëo
Shen Vlashi
Livadhi i Xhemal Beut
Fabrika e Tullave
M. Durrsit
Bejlek
Fusha Shkozet
Banja e Durrsit
DURAZZO
(DURRËS)

Tabela e përmbajtjes

Indeksi i Figurave
Shkurtesa dhe akronime

A. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
B. HYRJE
B.1 Ndjesia e lidhjes emocionale me vendin, por ende e shkëputur
B.2 Nevoja për Plan Menaxhimi dhe qëllimi i tij
B.3 Strategjia për zbatimin
B.4 Metodologjia
B.5 Qëllimi dhe afatet kohore
B.6 Konsultimet me grupet e interesit
B.7 Praktikat e mira
B.8 Njohja e Durrësit
B.9 Analiza Ligjore
C. PËRSHKRIMI I PASURISË KULTURORE
C.1 Evoluimi i qytetit
C.2 Arkeologjia e Durrësit
C.3 Autenticiteti
C.4 Integriteti
C.5 Arkitektura e Durrësit
C.6 Një vështrim i përgjithshëm mbi peizazhin urban dhe trashëgiminë
C.7 Zonat e mbrojtura arkeologjike A dhe B
C.8 Kuadri ligjor dhe institucional
C.8.1 Kuadri ligjor
C.8.2 Kuadri institucional dhe administrativ
C.8.3 Statusi i Trashëgimisë Botërore të Amfiteatrit
C.9 Pikat e forta, Pikat e dobëta, Kërcënimet dhe Mundësitë (ANALIZA SËOT)
C.10 Përmbledhje të çështjeve që do të trajtohen
Ç VLERËSIMI
Ç.1 Parimet e vlerësimit
Ç.2 Vlerat
Ç.3 Rëndësia
D. ASPEKTE TË TJERA TË LIDHURA ME PASURINË
D.1 Zhvillimi social dhe ekonomik
D.2 Aspekte të lidhura me turizmin
D.2.1 Zinxhiri i furnizimit të turizmit
D.2.2 Analiza e tregut dhe parashikimet
D.2.3 Menaxhimi i vizitorëve
PJESA 2 – PLANI I MENAXHIMIT
DH. VIZIONI, QËLLIMET & OBJEKTIVAT
DH.1 Deklarata e Vizionit
DH.2 Objektivat
DH.3 Përmbledhje e strategjive për përmbushjen e Objektivave
DH.3.1 Përmirësimi i konservimit dhe paraqitjes
DH.3.2 Rritja e nivelit të mbrojtjes
DH.3.3 Përmirësimi i menaxhimit, përdorimit dhe vlerësimit
E. ADMINISTRIMI I PASURISË KULTURORE – Masat sipas Objektivave
E.1 Përmirësimi i Ruajtjes dhe Paraqitjes
E.1.1 Përmbledhje e projekteve fizike
E.1.2 Gërmimet e ardhshme arkeologjike
E.1.3 Masa ndërgjegjësuese: Plani i Interpretimit, Edukimit, i Bashkëveprimit me Komunitetin113

E.2 Rritja e Nivelit Mbrojtjes
E.2.1 Miratimi i Planit të Menaxhimit
E.2.2 Përditësimi i Listës së Pasurive Kulturore
E.2.3 Rregullore të përmirësuara.
E.2.4 Zgjerimi i mundshëm i zonave arkeologjike A dhe B
E.2.5 Përmirësimi i Masterplanit të Durrësit
E.2.6 Mbrojtja e trashëgimisë të shekullit të 20-të
E.2.7 Zona Arkeologjike Nënujore
E.2.8 Mbrojtja e zonave periferike
E.2.9 Nominimi i Amfiteatrit në Listën e Pasurive të Trashëgimisë Botërore
E.2.10 Plani i Menaxhimit të Riskut
E.2.11 Sistemi I Informacionit Gjeografik
E.3 Përmirësimi i menaxhimit, përdorimit dhe vlerësimit
E.3.1 Qasje
E.3.2 Analiza e kërkesës për turizëm
E.3.3 Plani i gjenerimit të të Ardhurave
E.3.4.2 Opsionet e modelit të qeverisjes
E.3.5 Fondacioni i ri
E.3.6 Të dhënat financiare
E.3.7 Programi i zhvillimit të turizmit kulturor

Ë. PLANI I VEPRIMIT

Ë.1 Plani i veprimit, Afati kohor (7 vjet e përtej)
Ë.2 Masat fizike afatshkurtra. (5 vitet e para *të PM-së)*
Ë.3 Masat fizike afatmesme. Viti i 6-të dhe 7-të

F.IMPLEMENTIMI dhe MONITORIMI

F.1 Koordinimi dhe menaxhimi ndërinstitucional
F.2 Qasja e zbatimit dhe strategjia
F.3 Qasja e Menaxhimit të Pasurive Kulturore
F.4 Monitorimi dhe Vlerësimi
F.4.1 Struktura e Sistemit të Monitorimit
F.4.2 Rezultatet e ekuilibruar dhe indikatorët kyç të performancës
F.5 Konsultimi me Publikun

G. SHTOJCAT

G.1 Historia e Durrësit
G.2 Lista Monumenteve të Kulturës dhe vendimet e shpalljes
G.3 Institucionet që menaxhojnë trashëgiminë kulturore
G.4 Institucionet e Trashëgimisë Kulturore
G.5 Kuadri Ligjor për PM -në
G.6 Kuadri ligjor dhe procedurat për të shqyrtuar PM Durrës
G.7 Lista e pasurive të trashëgimisë kulturore arkeologjike jashtë Durrësit.
G.8 Shënim për materialet dhe teknikat e përdorura
G.9 Ndërtesa të propozuara për t'u deklaruar pasuri kulturore, pasaportat
G.10 Grupet e Palëve të Interesit
G.11 Abstract from the business plan of the new Foundation, elaborated and approved in August 2021 231
G.12 Kostot financiare për zbatimin e projekteve
G.13 Kostot financiare për gërmimet arkeologjike
G.14 Bibliografi

Indeksi i Figurave

Figurë 1 – Kapaku, panorama e amfiteatrit të Durrësit e parë nga lart.
Figurë 2 – Faqja vijuese, hartë historike e Durrësit, fundi i shekullit XIX (e panjohur)
Figurë 3 – Mozaiku Mesjetar brenda kishëzës(kapela) së Amfiteatrit Romak (James, L., 2017)
Figurë 4 – Përshkrim i Amfiteatrit Romak unik të Durrësit
Figurë 5 – Durrësi i njohur më parë si qyteti Epidamn në provincën e Shqipërisë MDLXXI - shtypur në Venecia nga G.F>CaMKio në 1571. Imazhe të tilla historike dëshmojnë për rëndësinë e Durrësit në antikitet.
Figurë 6 – Majtas, situata e hershme gjeografike(E. Shehi, L'Illirie méridionale et l"Epire dans l'antiquité)
Figurë 7 – Djathtas, Hartë e hershme e Durrësit (italiane, e panjohur)
Figurë 8 – Gërmimet e themeleve të mureve (mision arkeologjik franko-shqiptar)
Figurë 9 – Majtas, muret e poshtme
Figurë 10 - Djathtas, Amfiteatri (Misioni arkeologjik franko-shqiptar)
Figurë 11 – Termat, majtas
Figurë 12 – Forumi Bizantin (Misioni arkeologjik franko- shqiptar)
Figurë 13 – Termat dhe rruga Romake nën pallatin e kulturës (Misioni arkeologjik franko-shqiptar)
Figurë 14 – Majtas, kulla e murit bizantin (E. Shehi)
Figurë 15 –Djathtas, Insulae romake (Gj. Frashëri)
Figurë 16 – Sintezat arkeologjike të Durrësit (Misioni arkeologjik franko-shqiptar)
Figurë 17 – Strukturat e dukshme arkeologjike në Durrës (Misioni arkeologjik franko-shqiptar)
Figurë 18 – Shembull i një platforme GIS 2004 i krijuar për të kuptuar qytetin e Durrësit, trashëgiminë e tij kulturore dhe kontekstin urban
Figurë 19 – Fortifikime mbresëlënëse që datojnë nga periudha Bizantine
Figurë 20 – Detaje të monumenteve të zonës A (G. Reynal)
Figurë 21 –Ndërtesat vernakulare me naturë rurale (G. Reynal)
Figurë 22 – Ndërtesove banimi me detaje të arkitekturës neoklasike (G. Reynal)
Figurë 23– Majtas, rrugicat dhe ndërtesat që ende ekzistojnë. Figurë 24 – Djathtas, Rruga Tregtare (G. Reynal)
Figurë 25 – Majtas, Ndërtesa e Bashkisë ,përfaqësuese e fillimit të shekullit të 20-të.. Figurë 26 – Djathtas, hyrja e portit (G. Reynal)
Figurë 27 – Majtas, Pallati i Kultures, Djathtas, Pallati i sportit (G. Reynal)
Figurë 28 – Banesat sociale të ndërtuara gjatë zgjerimit të qytetit (G. Reynal)
Figurë 29 – I, II B Monument përkujtimor
Figurë 30 – Harta e trashëgimisë moderne të Durrësit (G. Reynal)
Figurë 31 – Hotel Vollga në një vend të spikatur, ende i braktisur
Figurë 32 – Zonat e mbrojtura arkeologjike A dhe B të Durrësit brenda kontekstit urban (Ministria e Kulturës)
Figurë 33 – Imazh satelitar i Amfiteatrit
Figurë 34 – Hyrjet dhe kalimet e këmbësorëve
Figurë 35 – Kufiri i qytetit jugperëndimor
Figurë 36 – Kufiri i qytetit lindor
Figurë 37 – Tuneli dhe pjesa veriore
Figurë 38 - Kapela Bizantine
Figurë 39 – Mozaikët
Figurë 40 – Galeria e brendshme
Figurë 41 – Pjesë të mureve fortifikuese (Eduard Shehi)
Figurë 42 –Rrënojate themeleve të fortifikimeve
Figurë 43 – Rrënojat e mureve të fortifikimit të përfshira në ndërtesa
Figurë 44 – Forumi Bizantin
Figurë 45 – Forumi Bizantin
Figurë 46 – Termat
Figurë 47 – Termat - pjesa e jashtme
Figurë 48 – Amfiteatri i Durrësit (Shqipëri) jo i regjistruar (Vendimet e Komitetit të Trashëgimisë Botërore, 1991)
Figurë 49 – Nara Grid dhe skema e vlerësimit bazuar në dokumentin Nara
Figurë 50 – Zhvillimi social dhe ekonomik i komunitetit si një input dhe output i vlerësimit të siteve të trashëgimisë
Figurë 51 – Treguesit e impaktit shoqëror që do të përdoren për vlerësimin e zhvillimit e tij

Figurë 52 – Vlerësimi ekonomik i siteve kulturor vs. zhvillimit social
Figurë 53 – Qasje e ngushtë dhe e gjerë ndaj vlerësimit të trashëgimisë kulturore, përshtatur nga Valentino, op. Cit
Figurë 54 – Mbërritjet e turistëve në Shqipëri, 2015-2019 (Burimi: UNWTO, 2020)
Figurë 55 – Turistët ndërkombëtarë në Shqipëri. Vitet 2007-2018. Burimi UNWTO, op. Cit
Figurë 56 – Të ardhurat nga turizmi ndërkombëtar në Shqipëri. Vitet 2007-2018. Përpunimi i konsulentit UNWTO, op. Cit
Figurë 57 – Numri i shtetasve të huaj sipas kalimit të kufirit (2018)
Figurë 58 – Mbërritjet e vizitorëve ndërkombëtarë në kufijtë e Shqipërisë (2007-2017)
Figurë 59 –Vizitorë në parqe arkeologjike, muze, kështjella dhe monumente të tjerë në Shqipëri sipas tipologjisë së sitit. Vitet 2014-2018 Burimi: INSTAT, 2020 115
Figurë 60 – Vizitorë në parqet kryesore arkeologjike, muzetë, kështjellat dhe monumentet e tjera në Shqipëri, 2019
Figurë 61 – Vizitorë vendas dhe ndërkombëtarë në Muzeun Kombëtar Arkeologjik, 2019
Figurë 62 – Vizitorë në muzeun arkeologjik kombëtar dhe Amfiteatrin Romak në Durrës. Vitet 2016-2020.
Figurë 63 – Vizitorë vendas dhe ndërkombëtarë në Muzeun Kombëtar Arkeologjik, 2019
Figurë 64 – Vizitorë vendas dhe ndërkombëtarë në Amfiteatrin Romak, 2019
Figurë 65 – Mundësia e akomodimit në hotel në Shqipëri. Numri i njësive Viti 2018
Figurë 66 – Faqja e parë, stabilizimi i Kullës C të mureve Bizantine e cila u shemb gjatë tërmetit 2019
Figurë 67 – Përmbledhje e veprimeve strategjike sipas objektivave dhe shtresave historike
Figurë 68 – Përpjekjet financiare për zbatimin e projektit të Amfiteatrit
Figurë 69 –Plani i përgjithshëm i gërmimeve arkeologjike në Amfiteatër (Eduard Shehi)
Figurë 70 – Kostot financiare për fazat e mëtejshme të gërmimeve arkeologjike lidhur me fazat arkeologjike në USD. Këto kosto u arritën nëpërmjet një llogaritjeje të m³ të nevojshëm për zhvendosjen, sipas përvojës së arkeologëve në ekipin konsulent
Figurë 70 – Kostot financiare për fazat e mëtejshme të gërmimeve arkeologjike
Figurë 71 – Kohështrirja ei pritshëm për implementimin e projektit
Figurë 72 - Katër sektorët e Parkut Arkeologjik, të Forumin Bizantin dheTermave Romake
Figurë 73 – Kostot financiare për implementimin e projektit Forum-Terma
Figurë 74 – Kohështrirja për implementimin e projektit
Figurë 75 – Kohështrirja e pritshëm për implementimin e projektit
Figurë 76 – Kostot financiare për zbatimin e projektit të itinirareve urbane
Figurë 77 – Projekti i itinerareve kulturore
Figurë 79 – Afati i pritshëm për implementimin e projektit
Figurë 80 – Gërmime të planifikuara rreth fortifikimeve
Figurë 81 – Gërmime në shkallë të vogël brenda qytetit
Figurë 82 – Gërmime në zonën e nekropolit dhe më gjerë
Figurë 83 – Kufijtë aktuale të zonave të mbrojtura A dhe B - Figurë 1
Figurë 84 – Zonat e shtuara me interes arkeologjik - Figurë 2
Figurë 85 – Zonat e reja arkeologjike A dhe B të propozuara
Figurë 86 – Propozim për të përshtatur rregulloret
Figurë 87 – Masterplan me shtresën e trashëgimisë moderne
Figurë 88 – Masterplan me shtresën e trashëgimisë arkeologjike
Figurë 89 – Një zbulim i fundit arkeologjik nga gjiri i Durrësit Figurë 109 - Gjetje nga gjiri i Durrësit të ekspozuar në pjesën e pasme të muzeut arkeologjik
Figurë 90 – Gjetje nga gjiri i Durrësit të ekspozuara në pjesën e pasme të muzeut
Figurë 91 – Zonat e propozuara A dhe B për arkeologjinë nënujore
Figure 92 – GIS - Platforma
Figure 93 – An example of the GIS platform created to understand the city of Durrës, its cultural heritage, and urban context.
Figurë 94 – Popullsia e qarqeve shqiptare
Figurë 95 – Popullsia e Durrësit
Figurë 96 – Turistët ndërkombëtarë që hynë në Shqipëri. Vitet 2007-2030. (Vlerësimi i konsulentit)
Figurë 97 - Njoftimet per të gjitha për konferencat, konferencat ndërkombëtare
Figurë 98 – Tipologjitë e eventeve që mund të realizohen në Amfiteatër
Figurë 99 – Segmenti kulturor, motivimet dhe pritshmëritë

Figurë 101 – Kategoritë kulturore brenda çdo segmenti kryesor. Burimi: Konkluzioni i konsulentit
Figurë 102 – Burimet që gjenerojnë të ardhurat
Figurë 104 – Modele menaxhimi për pasuritë kulturore pronë shtetërore
Figurë 105 – Modeli 3-E për vlerësimin e performancës organizative
Figurë 106 – Vlerësimi i dy alternativave të menaxhimit sipas modelit 3-E
Figurë 107 – Modeli i ri i menaxhimit bazuar në fondacion
Figurë 108 – Skema e organizimit të fondacionit të zhvillimit kulturor Durrës
Figurë 109 – Fondacioni i ri - Përgjegjësia e përgjithshme
Figurë 110 – Organigrama paraprake
Figurë 111 – Personeli i nevojshëm dhe fushat e përgjegjësive
Figurë 112 – Modeli konceptual
Figurë 113 – Kontributi i planit të menaxhimit të zonave arkeologjike Durrës në SKZHQT 2019-2023
Figurë 114 – PM Koordinimi dhe menaxhimi i strukturës ndërinstitucionale
Figurë 115 – Karta e rezultateve të balancuara të Durrësit
Figurë 116 – Karta e rezultateve të balancuara të Durrësit dhe shembuj të treguesve kryesorë të performancës
Figurë 117 – Përshkrim i vilës së mbretit Zog, aktualisht pronë private e mbyllur për publikun
Figurë 118 – Fortifikimeve antike bazuar në gërmimet e kryera gjatë viteve (Fonds de carte E. Shehi dans L. Perzhita Ats e Kongresit ndërkombëtar të studimeve arkeologjike shqiptare, Tiranë, 2014)
Figure 119 – Urban development assumption in antiquity (fonds de carte idem, MAFAD)
Figurë 120 – Durrës, Mesi i shekullit të 19-të (referencë)
Figurë 121 – Durrësi në fund të shekullit të 19-të (i panjohur)
Figurë 122 – Foto ajrore e Durrësit në 1925 (Ministria Italiane e Luftës, viti 1930)
Figurë 123 – Imazh ajror nga 1994 (Ministria italiane e luftës)
Figurë 124 – Harta e Durrësit nga 1978 (Republika Popullore Socialiste e Shqiperise))
Figurë 125 – Zonat e ndryshme të qytetit sot (Misioni arkeologjik franko-shqiptar)
Figurë 126 – Lista e pasurive Kulturore në Zonën arkeologjike A, Durrës
Figurë 127 – Lista e pasurive Kulturore në Zonën Arkeologjike B, Durrës
Figurë 128 – Majtas, fortifikimi Portez, 1924 (fotograf i panjohur) Figurë 129 – djathtas, fortifikimi Portez, 2020 (E. Shehi)
Figurë 130 – Planimetria e bazilikës në Arapaj
Figurë 131 – Majtas, Kalaja e Ishmit Figurë 132 –Djathtas, Bazilika e Gjuricaj
Figurë 133 – Majtas, Kisha e Shën Antonit, pas restaurimit Figurë 134 –Djathtas, Kalaja e Currilave, kulla kryesore dhe porta
Figurë 135 – Kalaja e Ishmit, porta kryesore
Figurë 136 – Mozaiku i famshëm Hyppocampus (kali i detit), Durrës
Figurë 137 – Kopertina e pasme, kompozim nga monumente të ndryshme arkeologjike dhe arkitektonike në Durrës

Figurë 3 – Mozaiku Mesjetar brenda kishëzës së Amfiteatrit Romak (James, L., 2017)

Shkurtesa dhe akronime

AADF	Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim
IA	Instituti i Arkeologjisë
BSC	Balanced Scorecard (Kartë e balancuar e rezultateve)
CAD	Program Kompjutetik për Vizatime Teknike
Konsulentët	Anëtarët e Konsorciumit
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
NJKZH	Njësia e Kontrollit të Zhvillimit
OMD	Organizata e Menaxhimit të Destinacionit
DPUR	Departamenti i Planifikimit Urban dhe Rural
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
MASHF	Misioni Arkeologjik Shqiptaro-Francez
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
VNT	Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgimi
PHU	Peizazhi Historik Urban
ICCROM	Qendra Ndërkombëtare për Studim të Ruajtjes dhe Restaurim të Pasurive Kulturore (International Centre for the Study of the Preservation and Restoration of Cultural Property)
ICOMOS	Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet
PM	Plani i Menaxhimit
IKTK	Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
OKS	Objektivat Kryesore Strategjike
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
MICE	Takime, Nxitje, Konferenca, Evente
MK	Ministria e Kulturës
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
AKT	Agjencia Kombëtare e Turizmit
KKTKM	Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale
AJSH	Aktorë jo Shtetërorë
SKZHT	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Territorit
SKZHQT	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 - 2023
VJU	Vlere e Jashtëzakonshme Universale
KP	Koordinatori i Projektit
SMP	Skuadra e Menaxhimit të Projektit
PPP	Partneriteti Publik Privat
PMR	Plani i Menaxhimit të Riskut
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
SVM	Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
AT	Asistenca Teknike
DE	Drejtuesi i Ekipit
ToR	Termat e Referencës
UNESCO, WHC	Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara, Qendra e Trashëgimisë Botërore,(World Heritage Centre)
UNWTO	Organizata Botërore e Turizmit e Kombeve të Bashkuara
WHC	Komiteti i Trashëgimisë Botërore, (World Heritage Committee)
WHP	Pasuria e Trashëgimisë Botërore

A. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kuadri i përgjithshëm për "Vizionin kulturor" të Durrësit:

Durrësi është një portë kulturore e Mesdheut, qendër dhe magnet kulturor për Shqipërinë dhe rajonin, me Amfiteatrin si ikonë që luan një rol kryesor në qendër të qytetit.

Ky vizion është ambicioz për ata që e njohin mirë qytetin dhe sfidat e tij. Vizioni duhet të jetë frymëzues. që të kontribuoj për kuadrin e mësipërm. në perspektivën e pesëmbëdhjetë viteve të ardhshme dhe mund të formulohet si:

> **Trashëgimia mbi 3000 vjeçare e vazhdueshme e këtij vendbanimi të ruhet, të aksesohet në të gjithë vlerat e tij , duke mbajtur ndërkohë ekuilibrin midis ruajtjes së trashëgimisë kulturore, turizmit dhe zhvillimit.**

Qëllimi i këtij plani menaxhim është të realizojë këtë vizion përmes objektivave si më poshtë:

1. **PËRMIRËSIMI I RUAJTJES/KONSERVIMIT DHE PARAQITJES/PREZANTIMIT** – nëpërmjet projekteve të restaurimit dhe rijetëzimit të pasurive kulturore, gërmime arkeologjike, muze, interpretime.
2. **RRITJA E NIVELIT TË MBROJTJES** - nëpërmjet kuadrit rregullator ose projekteve të destinuara për zgjerimin e zonave të mbrojtura, masat ligjore dhe rivlerësimin e hapësirave të hapura.
3. **PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT, PËRDORIMIT DHE VLERËSIMIT** - të pasurive të trashëgimisë kulturore të arkeologjisë dhe arkitekturës, që përfshin krijimin edhe të një modeli të ri menaxhimi.

Përmbajtja e PM-së është e organizuar në dy pjesë kryesore me nënseksione sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

Pjesa I prezanton gjendjen aktuale. Ajo përmban vlerësimin e kushteve aktuale dhe përfshin katër seksione kryesore duke filluar me hyrjen, përshkrimin e pasurive kulturore dhe vlerësimin e tyre. Brenda këtyre seksioneve përshkruhet trashëgimia arkeologjike dhe arkitektonike, evolucioni i sitit dhe një listë e pasurive kulturore më të spikatura. Kjo pjesë, gjithashtu, përfshin aspekte të tjera të lidhura me pronën, që përmbajnë kriteret e zhvillimit ekonomik, zhvillimit lokal dhe zhvillimit të biznesit. I rëndësishëm është përcaktimi i kuadrit ligjor dhe institucional dhe një përmbledhje e çështjeve që do të trajtohen në pjesën e dytë.

Pjesa II është Plani i Menaxhimit për sot dhe për të ardhmen. Ai merr në konsideratë qëllimet afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për të mbështetur vizionin. Kjo pjesë është strukturuar së pari me vizionin, qëllimet dhe objektivat e ndjekur nga objektivat specifike. Pjesa e dytë përshkruan, gjithashtu aktivitetet kryesore të parashikuara për zbatim dhe kohëzgjatjen e tyre në matricën e planit të veprimit. Matrica lidh vizionin dhe objektivat me detyra dhe cakton përgjegjësi brenda një afati kohor. Kjo kornizë kohore klasifikohet në periudhën afatshkurtër (pesë vjet), afatmesme (shtatë vjet) dhe afatgjatë (pesëmbëdhjetë vjet). Në fund, ndodhet një aneks që përfshin institucionet që menaxhojnë trashëgiminë kulturore, një analizë ligjore dhe një bibliografi e konsultuar për këtë PM.

Vlerat dhe Rëndësia

Në këtë dokument janë analizuar me kujdes vlerat kulturore ,historike, shkencore, estetike, sociale, dhe ekonomike. Vlerat historike lidhen me të gjithë qendrën urbane të Durrësit dhe mjëvjeçarin e pushtimeve në të njëjtën qendër të vogël. Kjo ka sjellë krijimin e një siti të pasur arkeologjik[1] dhe përfshin zonat e Amfiteatrit, Termave Romake dhe Forumit Bizantin. Vlerat shkencore janë të

[1] Vlera historike qëndron te lidhja me të kaluarën e këtyre dritareve të zbuluara në qytetin modern

përafruara ngushtë me vlerat historike në atë që njohuritë e së kaluarës janë të pamjaftueshme, dhe çdo zbulim arkeologjik zbulon informacione të reja dhe potencialin për përparimin shkencor. Vlerat estetike janë të rëndësishme pasi qyteti posedon shumë atribute natyrore që do t'i kishin zili qytetet e tjera, duke përfshirë një bregdet spektakolar me një shëtitore të re buzë detit, kodra dhe parqe të gjelbra dhe një qendër historike në një klimë mesdhetare të ngrohtë dhe me diell. Vlerat sociale dhe kulturore në Shqipëri kanë qenë gjithmonë të forta. Kjo shoqëri e fuqishme formohet nga lidhjet familjare dhe farefisnore, miqtë, fqinjët dhe kolegët. Është mjedisi fizik që e ushqen dhe lehtëson këtë. Vlerat ekonomike të Durrësit kryesisht mbështeten në rëndësinë e tij si port, por turizmi kulturor duhet të luajë një rol të rëndësishëm.

Rëndësia e Durrësit bazohet në vlerat e tij kulturore, historike, shkencore dhe ekonomike, duke marrë parasysh vërtetësinë dhe integritetin e qytetit. Kjo domethënie përfaqësohet në banimin e vazhdueshëm të qytetit që nga shekulli 7-të p.e.s., shtresë mbi shtresë, me rrënoja arkeologjike përbri arkitekturës së shekullit të 20-të. Shtresa të shumta historike të qytetit mund të vërehen në një zonë; Kishat mesjetare të përfshira në hapësirat e brendshme të Amfiteatrit Romak të shekullit të 2-të dhe Xhamia Fatih e Shekullit 16-të, që përfshin muret e jashtme të bazilikës bizantine të shekullit 11-të dhe fortifikime nga periudha të ndryshme. Rëndësia e Durrësit lidhet, gjithashtu, me pozicionin e favorshëm gjeografik në bregdetin e Adriatikut dhe në kryqëzimin e rrugëve tregtare, detare dhe tokësore. Duke filluar nga shekulli I-rë p.e.s., Durrësi u bë pikënisja e Via Egnatias e cila ishte vazhdimi i itinerarit nga Roma në Bizant. Kjo ishte rruga e Jul Cezarit dhe Pompeit, si dhe e Mark Antonit dhe Oktavianit kur ndoqën Kasin dhe Brutin.

Përmbledhje e masave nisur nga objektivat kryesor

PM parashikon një numër masash që trajtojnë tre objektivat e mëposhtëm specifik:

1. **Përmirësimi i ruajtjes/konservimit dhe paraqitjes/prezantimit**
2. **Rritja e nivelit të mbrojtjes**
3. **Përmirësimi i menaxhimit, përdorimit dhe vlerësimit**

1. Përmirësimi i ruajtjes dhe paraqitjes

Në **periudhën afatshkurtër** (0÷5 vjet të PM-së), objektivi i parë përfshin masa fizike (projekte restauruese dhe rijetëzuese), në sitet kryesore për t'u realizuar në një periudhë afatshkurtër, të cilat u identifikuan nga grupet e interesit dhe gjatë fazës fillestare të përgatitjes së këtij dokumenti. Ato bazohen gjithashtu në kuptimin e vlerave, integritetin dhe autenticitetin.

Këto site përfshijnë:

a) **Amfiteatrin Romak,**
b) **Termat Romake, Forumin Bizantin**
c) **Kalanë e sipërme**
d) **Itineraret Kulturore**

Projekte të tjera në zonë janë identifikuar dhe po zbatohen nga aktorë të ndryshëm, që përfshijnë:

a) **Muzeun Arkeologjik të Durrësit**
b) **Kullën Veneciane si qendër interpretimi informuese**
c) **Hamamin Mesjetar**

Masa të tjera fizike janë përshkruar gjithashtu në PM për periudhat afatmesme dhe afatgjata.

Ky objektiv përfshin a) një plan të përgjithshëm interpretues-didaktik për të gjitha monumentet e spikatura të periudhave historike dhe parashikon përfshirjen e shkollave lokale fillore dhe të mesme; dhe b) forcimin institucional (për ruajtjen, monitorimin dhe menaxhimin e të dhënave).

Në **periudhën afatmesme** (viti 6-të÷7-të i PM-së) objektivat janë si më poshtë:

a) Konservimi i fortifikimeve pranë Amfiteatrit
b) Rritja e kapaciteteve institucionale, nominimi i Amfiteatrit në listën e trashëgimisë botërore

Në **periudhën afatgjatë** [2](përtej PM-së) pas mbarimit të afatit të PM-së, objektivat që do të zhvillohen më tej janë si më poshtë :

- Rritja e kapaciteteve institucionale, krijimi i parkut arkeologjik nënujor të Durrësit

2. Rritja e nivelit të mbrojtjes

Në **periudhën afatshkurtër** (0÷5 vjet të PM-së), ky objektiv do të arrihet nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullator ose projekteve (jo-fizike) të destinuara për zgjerimin e zonave të mbrojtura, masave ligjore dhe vlerësimit të hapësirave të hapura.

- Miratimi dhe zbatimi i këtij plani menaxhimi.
- Rregullore të përmirësuara për ruajtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike A dhe B, veçanërisht në dhënien dhe zbatimin e lejeve të ndërtimit nga Bashkia Durrës.
- 2Rritja e nivelit të mbrojtjes për trashëgiminë e fillimit dhe mesit të shekullit të XX-të
- Mbrojtja e zonave periferike
- Përditësimi i listës së Pasurive Kulturore.
- Zbatimi i rregulloreve nëpërmjet forcimit të kontrollit të autoriteteve, rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit

Masat që do të zhvillohen në **periudhën afatmesme** (viti 6-të-7-të i PM-së) janë si më poshtë:

- Krijimi i qendrës arkeologjike shqiptar
- Forcimi i kuadrit ligjor për pasuritë kulturore arkitektonike, përfshirë legjislacionin për mbrojtjen e pasurive kulturore nënujore.
- Zbatimi i akteve rregullatorë nëpërmjet forcimit të kontrollit të autoriteteve, ndërgjegjësimit dhe edukimit
- Hartimi i planit të menaxhimit të riskut të fatkeqësive

Në **periudhën afatgjatë** (përtej PM-së)

- Vazhdimi i zbatimit të rregulloreve nëpërmjet forcimit të kontrollit të autoriteteve, dhe rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit.

3. Përmirësimi i menaxhimit, përdorimit dhe vlerësimit

Në **periudhën afatshkurtër** (0÷5 vjet të PM-së) përmirësimi i përdorimit dhe vlerësimit të aseteve të trashëgimisë kulturore, arkeologjisë dhe arkitekturës së qytetit të Durrësit, duke përfshirë menaxhimin, nënkupton veprimet e mëposhtme strategjike:

- Funksionimi i zonës së zhvillimit të turizmit (TID)
- Qasja e vlerësimit
- Zgjedhja e një modeli të ri qeverisjeje

[2] Megjithëse VkM përcakton një afat kohor jo më pak se pesë vjet, për të realizuar një vizion kaq ambicioz, PM ka parashikuar afatin kohor, më shumë se shtatë vjet.

- Fillimi i planit të gjenerimit të të ardhurave
- Krijimi i programit të zhvillimit të turizmit kulturor
- Kontributi për qëllimet e turizmit të SKZHQT-së
- Rritja e kapaciteteve të stafit menaxhues të muzeut

Në **periudhën afatmesme** (viti 6-të÷7-të i PM-së)

- Rritja e kapaciteteve të stafit menaxhues si një veprim tjetër strategjik
- Themelimi i një entiteti të ri, "Fondacioni", për të menaxhuar Parkun Arkeologjik, Amfiteatrin dhe disa funksione të Muzeut Arkeologjik.

Në **periudhën afatgjatë** (viti 8-15, përtej PM-së)

- Monitorimi dhe implementimi i plotë i një modeli të zgjedhur menaxhimi për punën operative, promovimin dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore të qytetit.

B. HYRJE

B.1 Ndjesia e lidhjes emocionale me vendin, por ende e shkëputur

Qendra e qytetit të Durrësit të jep ndjesinë e prekshme të një zone të gjallë, banorët shijojnë kafenetë e shumta në natyrë, shëtisin përgjatë shëtitores të sapo rindërtuar buzëdetit dhe rrugës kryesore. Përmirësimet e fundit të mëdha të infrastrukturës urbane në bregdet, në sheshin kryesor dhe rrugët anësore kontribuojnë për këtë ndjesi. Ekziston gjithashtu një rend i përcaktuar në qytet, i imponuar nga pasuritë natyrore deti dhe porti, së bashku me kodrat. Qendra e qytetit ka gjithashtu një rend urbanistik të përcaktuar me portin e lidhur me sheshin kryesor nëpërmjet boshtit të Bulevardit Epidamn.

Sidoqoftë, qyteti është tashmë i shkëputur nga historia e tij fisnike dhe i copëzuar së brendshmi nga sitet e izoluara kulturore. Pasuritë historike dhe rrënojat e konsiderueshme arkeologjike të qytetit janë kryesisht të patrajtuara siç duhet. Amfiteatri gati 2000-vjeçar është një shembull i tillë i vendosur shumë pranë nga aksi kryesor urban. Perceptimin e tij e vështirësojnë makinat e parkuara përreth dhe ndërtesat që ndodhen mbi rrënojat e tij. Duket si i harruar prapa dyqaneve, restoranteve dhe bareve. Kodrat e gjelbra të mrekullueshme me vilën mbresëlënëse të Mbretit Zog nuk janë lehtësisht të aksesueshme. Edhe pse është e dukshme nga bregu i detit dhe çdo lagje, ajo mund të arrihet vetëm me një automjet privat, pavarësisht faktit që ndodhet vetëm disa minuta larg në këmbë nga Amfiteatri. **Zhvillimet e pakontrolluara urbane private, të mëdha dhe të vogla, kanë mbyllur rrugët e lëvizjes urbane të këmbësorëve, duke shkëputur asetet kryesore turistike të qytetit**.

Nevojitet një vizion udhëzues, jo vetëm për të mbrojtur rrënojat arkeologjike, por edhe për të rilidhur ato brenda dhe jashtë qytetit, nëpërmjet itinerareve (rrugëve) kulturore. **Menaxhimi dhe përdorimi më i mirë i këtyre pasurive do të sjellë që numri i siteve kulturore të vizitueshme të Durrësit të jetë më i madh se pasuritë kulturore të veçanta që vizitohen sot**. Ky PM kërkon të bëjë pikërisht këtë, të sigurojë një vizion udhëzues për qytetin, të përshkruajë një seri projektesh kritike sipas shkallëve urbane dhe rajonale duke siguruar mbrojtje për rrënojat arkeologjike. Vizioni do të përmbushet vetëm nëpërmjet një Plani Menaxhimi me objektiva të qarta, një plan veprimi dhe indikatorë vlerësimi.

B.2 Nevoja për Plan Menaxhimi dhe qëllimi i tij

Burimet arkeologjike të Durrësit janë të rëndësishme referuar vlerave kulturore, shkencore, sociale dhe ekonomike. Sidoqoftë, ato janë një aset i panjohur për zhvillimin turistik dhe zhvillimin shoqëror të qytetit. Një arsye kryesore për mos shfrytëzimin e tyre në kapacitetet e mundshme, është mungesa e një Plani Menaxhimi. Prandaj, është qëllimi i këtij seksioni që të përshkruajë nevojën dhe të përcaktojë qëllimin e PM-së.

Zhvillimi i një plani menaxhimi është, sa proces, aq edhe një produkt. Gjatë këtij procesi u kontaktuan shumë palë të interesuara, si aktorët institucionalë, ashtu edhe ata të komunitetit në nivele të ndryshme. Autorët e këtij plani nuk kërkonin vetëm idetë e personave më me ndikim, por edhe idetë e grupeve më të vogla të komunitetit. Ky proces kërkoi kohë, megjithatë ishte i nevojshëm.

Gjithashtu, është e pamjaftueshme të përcaktohet vetëm vizioni i PM-së; kjo do të ishte e papërgjegjshme dhe e pamatur. Por vizioni duhet të mbështetet nga një seri qëllimesh, objektivash dhe detyrash të shumta. Detyrat e shumta krijojnë plane rezervë në rastin nëse disa objektiva nuk realizohen. Prandaj, ky PM përcakton gjithashtu një PLAN VEPRIMI, i cili është një udhërrëfyes për arritjen e vizionit.

Plani i Menaxhimit është dokumenti kryesor për menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të pasurive të paluajtshme kulturore. Ai përshkruan planifikimin dhe bashkërendimin e kompetencave të grupeve të interesit aktive në fushën e pasurive kulturore.

Vlerësimi është një komponent kritik i Planit të Menaxhimit pasi rekomandon ide për përdorimin aktiv të siteve të tilla si Amfiteatri, etj. Një premisë udhëzuese e këtij plani është që nëse sitet arkeologjike vizitohen dhe përdoren si pjesë të qytetit, ato do të perceptohen dhe vlerësohen si nga banorët dhe nga vizitorët. Nëse vende të tilla rijetëzohen, ruajtja dhe mbrojtja e vazhdueshme janë më të realizueshme.

Shumë e rëndësishme është që ky PM të shoqërohet nga një Plan Veprimi i detajuar për pasuritë arkeologjike të Durrësit. Kjo është metoda më e sigurt për të realizuar ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive kulturore arkeologjike dhe arkitektonike të qytetit.

B.3 Strategjia për zbatimin

Së pari, vizioni bazohet nga një analizë e thelluar e vlerave kulturore, autenticitetit, integritetit, njohjes së qytetit të Durrësit dhe mbështetet në tri objektiva kryesorë:

1) Përmirësimi i ruajtjes/konservimit dhe paraqitjes/prezantimit,
2) Rritja e nivelit të mbrojtjes,
3) Përmirësimi i menaxhimit, përdorimit dhe vlerësimit

Një pjesë kritike e strategjisë është që secila prej këtyre detyrave do t'i caktohet një subjekti specifik për zbatim, me një metodë të përcaktuar të monitorimit dhe vlerësimit. Brenda secilës prej këtyre objektivave, ekzistojnë tri lloje të detyrash: ndërhyrje fizike, përmirësim i kuadrit rregullator dhe forcim organizativ dhe institucional. Këto, më pas, ndahen në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë

B.4 Metodologjia

Metodologjia e përdorur për të përgatitur PM-në ishte e drejtpërdrejtë. Ekipi e filloi studimin duke lexuar materialet e shumta të siguruara nga Ministria e Kulturës, AADF dhe kontributet individuale të ekspertëve kryesorë. Ekipi, më pas, diskutoi rreth këtij hulumtimi paraprak nëpërmjet një sërë takimesh. Një hulumtim dytësor i lejoi ekspertët të formonin një vlerësim themelor solid të zhvillimit të qytetit dhe sfidave të tij të së kaluarës, aktuale dhe të ardhshme. Hulumtimi gjithashtu lejoi ekipin të fillojë të bëjë pyetje kritike në lidhje me burimet e trashëgimisë kulturore, llojin e tyre, gjendjen, nivelin e mbrojtjes dhe përdorimin aktual.

Vizitave e shumta në terren i lejuan ekipit të formonte një hipotezë për të ardhmen e qytetit dhe pasurive të tij kulturore. Kjo vizitë u shoqërua nga një seri takimesh me vendimmarrësit, grupet e interesit dhe ekspertë vendas të njohur. Shumë e rëndësishme ishte mbledhja e të dhënave të tilla, si informacioni GIS, imazhet, hartat dhe shënimet e intervistave. Këto vizita ofruan gjetje, analiza dhe ide të cilat formuan bazën për hartimin e PM.

Një aspekt i rëndësishëm i studiuar si pjesë thelbësore e metodologjisë ishte zbatimi i legjislacionit Shqiptar të përshkruar në këtë dokument. Hartimi i Planit të Menaxhimit gjithashtu mori në konsideratë standardet ndërkombëtare, qasjen e Peizazhit Historik Urban dhe përvojën e ekipit në qytete dhe sitet të tjera arkeologjike të Trashëgimisë Botërore. Në mënyrë të rëndësishme, rekomandimet e UNESCO-s dhe Udhëzimet Operative të Konventës së Trashëgimisë Botërore, u përfshinë gjithashtu në metodologji dhe u krahasuan me Ligjin Shqiptar.

Metodologjia për zhvillimin e Planit të Menaxhimit ndoqi elementët e renditur më poshtë:

1) **Kuptimi i legjislacionit** në lidhje me menaxhimin trashëgimisë kulturore, dhe VKM-në për hartimin e planeve të menaxhimit. Disa nga pikat e rëndësishme janë përfshirë në aneks. Lidhur me planet e menaxhimit dhe propozimet për strukturat menaxhues të trashëgimisë kulturore, legjislacioni është i qartë dhe duhet të ndiqet saktësisht.
2) **Diskutime me aktorë institucionalë**, si Ministria e Kulturës, Bashkia e Durrësit dhe aktorë të komunitetit. Kjo u bë për të kuptuar situatën aktuale, avantazhet dhe kufizimet
3) **Hulumtimi paraprak –** Ky hulumtim ishte shumë i dobishëm në fazat fillestare të punës për përgatitjen e ekipit, por gjithashtu vazhdoi gjatë gjithë përgatitjes së PM-së dhe zhvillimit të modelit të qeverisjes. Hulumtimi u krye në shqip, anglisht dhe italisht dhe u krijua një bibliografi për PM-në.
4) **Hulumtimi kryesor –** u krye në dy pjesë, diskutime me palët e interesuara institucionale dhe të komunitetit dhe vizita të shumta në sit gjatë dy viteve. Menaxhimi i të gjithë trashëgimisë arkeologjike dhe kulturore u vëzhgua drejtpërdrejt dhe u dokumentua me fotografi dhe forma të tjera dokumentimi.
5) **Konsultimet** - me anëtarët e komunitetit dhe aktorë të tjerë joinstitucional vazhduan gjatë gjithë hartimit të PM-së dhe përfshinin prezantime dhe diskutime. Është e rëndësishme të theksohet se konsultimet dhe hulumtimet u kryen në mes të pandemisë globale COVID-19, kur ligji shqiptar parandaloi shumë takime ballë për ballë. Shumë takime u mbajtën në ambiente të jashtme në Durrës.
6) **Inspektimet në sit** - ishin pjesë e rëndësishme e metodologjisë për hartimin e PM-së. Kjo përfshinte konsultime me ekspertë të arkitekturës, turizmit dhe arkeologjisë. Rezultatet janë paraqitur në dokumente të veçanta dhe kanë qenë thelbësore në hartimin e planit të menaxhimit.
7) **Shembuj të praktikave të mira** - për planet e menaxhimit për vendet e trashëgimisë kulturore do të ndiqen së bashku me statutet, deklaratat dhe udhëzimet e publikuara. Shumë plane menaxhimi të siteve kulturore ndërkombëtare u identifikuan si shembuj dhe ide të praktikave të mira dhe pasqyrohen në PM.
8) **Ligjet në fuqi** - metodologjia i referohet saktësisht shtojcës 3, të VKM nr.169, datë 20.02.2020 "Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme". Plani gjithashtu do të ndjekë të gjithë legjislacionin në fuqi të renditur në seksionin vijues.
9) **Diskutime dhe verifikime** - metodologjia përfshinte gjithashtu diskutime mbi draft versionin e planit, brenda ekipit si dhe me ekspertë të jashtëm në Shqipëri dhe ndërkombëtarë. Versionet draft PM-së janë qarkulluar me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Arkeologjisë dhe Bashkinë Durrës disa herë gjatë dy viteve.

Metodologjia e zhvillimit të Planit të Menaxhimit

Metodologjia e zhvillimit të PM-së përfshinte gjithashtu disa referenca ndërkombëtare të mëposhtme krahasuar me legjislacionin shqiptar.

METODOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PASURISË KULTURORE TË PALUAJTSHME

Standardet Ndërkombëtare dhe UNESCO-s	Ligji Shqiptar dhe VKM Nr.169 datë20.02.2020



a) Analiza e integruar e pasurisë kulturore të paluajtshme;
i. Të dhëna në terren duke përfshirë vlera të tjera të integruara me vlerat kulturore;
iv. Kuadri ligjor dhe institucional;

ii. Analiza e vlerave kulturore, rëndësia, integriteti, autenticiteti, statusi i ruajtjes;
iii. Analiza e vlerave të tjera;

v. Analiza SWOT e faktorëve që ndikojnë në ruajtjen e integritetit dhe autenticitetit;

c) Planifikimi strategjik, i cil i përfshin:
i. Aktivitete specifike për arritjen e objektivave
ii. Rezultatet dhe treguesit e pritshëm

ç) Planin veprimit, i cili përfshin:
i. Aktivitete specifike për arritjen e objektivave;
ii. Rezultate të matshëm dhe buxheti;
iii. Institucionet përgjegjëse për zbatimin, afatet kohore dhe burimet e nevojshme për të;

B.5 Qëllimi dhe afatet kohore

Sipas kërkesave të projektit përgatitja e MP ishte lancuar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Qëllimi i planifikimit përshkruhet nga pikat e mëposhtme:

1. Identifikimi i informacionit bazë në lidhje me sitin
2. Integrimi i përparësive të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë me një vizion të zhvillimit urban dhe menaxhimit të turizmit.
3. Vendosja e objektivave dhe politikave të menaxhimit
4. Përfshirja e menaxhimit mjedisor
5. Identifikimi i zonave arkeologjike dhe atyre me potencial arkeologjik si dhe të rrezikuara.
6. Paraqitja e një sistemi të integruar të menaxhimit të trashëgimisë duke përfshirë platforma GIS
7. Mbështetja e qasjeve inovative për zhvillimin e siteve të trashëgimisë kulturore
8. Hartimi i ToR-eve dhe parashikimit të kostove për projektet e ardhshme të konservimit për pasuritë kulturore (monumentet) kryesore.
9. Hartimi një Plani Veprimi për PM.
10. Këshillim në lidhje me strukturën e menaxhimit për Parkun Arkeologjik të Durrës
11. Identifikimi dhe rekomandime për burimet e mundshme të financimit të planit të biznesit.

Duke iu referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.169. Datë.20.02.2020, afati i planit të menaxhimit do të përcaktohet bazuar në objektivat që kërkohen për t'u arrirë. Në çdo rast, afati kohor i një plani menaxhimi nuk duhet të jetë më pak se pesë vjet.

Edhe pse PM është i orientuar në periudhën afatshkurtër, ai duhet të mbështesë vizionin afatgjatë për Durrësin. Plani i veprimit është i përqendruar në pesë vitet e ardhshme, PM përshkruan aktivitetet e mëtejshme që do të zbatohen në periudhën afatmesme (7 vjet), për projektet e përzgjedhura për hartimin e Termave të Referencës përkatëse për projektet afatshkurtra.

B.6 Konsultimet me grupet e interesit

Ky plan është hartuar në bashkëpunim dhe konsultim me aktorë të shumtë, institucione qendrore dhe vendore, si dhe komunitetin lokal. Për këtë arsye, u kryen një sërë konsultimesh për të informuar ekipin, e PM-së dhe për të ndërtuar konsensusin për idetë dhe konceptet. Konsultimet u ndanë në dy grupe të veçanta, institucionale si Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Durrësit, dhe grupet e komunitetit të përfaqësuara nga drejtues të shumtë[3]. Takimet, prezantimet dhe sesionet e pyetjeve dhe përgjigjeve të drejtuesve të institucioneve të grupeve të interesit u organizuan personalisht dhe me video konferencë. Duke pasur parasysh pandeminë aktuale, e vetmja mundësi për grupet e komunitetit ishte të komunikonin nëpërmjet drejtuesve, dhe kjo u krye nëpërmjet video-konferencës. Drejtuesit institucionalë të grupeve të interesit u konsideruan më shumë si partnerë në procesin e krijimit të kësaj PM-je. Atyre iu dërguan drafte seksionesh, takimet dhe prezantimet ishin të shpeshta dhe u krijuan marrëdhënie pune. Këto institucione kanë një interes të plotë për të përmirësuar, zhvilluar Durrësin dhe për të mbrojtur arkeologjinë e tij.

Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Kulturës
- Instituti i Arkeologjisë

[3] Fatkeqësisht, pandemia globale ndaloi takimet me grupe të mëdha. Sidoqoftë, janë kryer takime individuale me grupe të vogla interesi institucional dhe video konferenca me perfaqesues të komunitetit.

- Qendra Muzeore Durrës
- Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë
- Bashkia Durrës
- Qendra Kulturore Bashkisë Durrës

Grupet e interesit

Përveç institucioneve, një grup tjetër i rëndësishëm ishin komuniteti i grupeve të interesit. Këto grupe u zgjodhën pasi të gjithë janë të vendosur në Durrës, kanë projekte aktive në lidhje me kulturën në qytet dhe kanë interes për mbrojtjen arkeologjike.

- Shoqata Durrësi Autokton
- Shoqata e të Verbërve SHKSH
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës
- Durrësi Aktiv
- Shoqata e Turizmit AAT-HORECA
- Shoqata e Arkitekteve Durrës
- Rotary Club
- Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Shqipëri (CHwB)
- Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)
- Universiteti i Tiranës
- Universiteti i Durrësit

Detaje mbi konsultimin me palët e interesuara

Grupi i parë: Grupet e interest, institucionale dhe të komunitetit të përfshira në diskutime

Palët e interesit institucional	
Ministria e Kulturës – Ministri dhe stafi	Elva Margariti Doris Alimerko Ergis Stafa Klesta Qirici
Ministria e Kulturës - Drejtoria e Trashëgimisë Materiale dhe Muzeve - Drejtor	Kozeta Angjeliu
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore – Drejtor	Arta Dollani
IKTK, Drejtoria e Arkeologjisë së Shpëtimit, – Drejtor	Rudina Zoto
Qendra Muzeore Durrës - Drejtor	Alban Ramohitaj
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore – Planifikues urban	Marsela Plyku
Qendra Muzeore Durrës – Arkeolog	Eda Çekrezi
Instituti i Arkeologjisë – Drejtor (2013 to 2021)	Prof. Luan Perzhita
Instituti i Arkeologjisë - Arkeolog nënujor	Dr. Adrian Anastasi
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit – Drejtor	Adelina Greca
Bashkia Durrës - Kryetar Bashkie Bashkia Durrës - Nënkryetar Bashkie dhe stafi i zyrës së planifikimit urban	Emiriana Sako Florian Tahiri
Bashkia Durrës - Qendra Kulturore, Muzeu Etnografik, Galeria e Arteve - Drejtor	Elio Bajramaj
Bashkia Durrës – Muzeu Memorial – Drejtor	Alketa Tragaj
Palët e interesit	
Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim - Co-CEO	Martin Mata
Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim - Co-CEO	Aleksander Sarapuli
Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim – Manager Projekti	Dr. Ilir Parangoni
Durrësi AKTIV	Klaudio Hyseni
Shoqata e Turizmit ATA-HORECA	Edmond Xhepa
Shoqata e Arkitektëve Durrës	Indrit Hamiti

Trashëgimia Kulturore pa Kufij	Ms. Elena Mamani
UNOPS	Lejla Hadzic
TID (Touristic Improvement District) Arkitekt lokal TID (Touristic Improvement District) Arkitekt lokal	Genci Xhillari Blenard Durmishi
Arkeolog	Prof. Neritan Ceka
Arkeolog	Dr. Eduard Shehi
Grupi i dytë: <u>Palët e interesit që u kontaktuan por nuk u përfshinë në diskutime</u>	
<u>Palët e interesit</u>	
Shoqata Durrësi autokton	Avdulla Deliallisi (**)
Universiteti i Durrësit - Arkeolog	Dr. Ols Lafe (**)
Shoqata e të Verbërve SHKV	Petrit Çela (**)
Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës	Alban Isteri (**)
Klubi Rotaryan	Astrit Duci (*)
Universiteti i Tiranës - Profesor	Prof. Lorenc Bejko (*)
Universiteti i Tiranës - Profesor	Prof. Iris Pojani (*)

Të gjithë personat e përfshirë në të dy grupet u kontaktuan me email ose personalisht. Personat e grupit të dytë fillimisht u kontaktuan nga një përfaqësues lokal i Konsulentit në Durrës në gjuhën shqipe. Ata u informuan për hartimin e PM-ë dhe iu dha një numër/email për t'u kontaktuar për diskutime të mëtejshme. Ata u informuan gjithashtu se përfaqësuesi i ekipit do të kontaktonte me email ose telefon dhe iu dhanë emri dhe informacionet e kontaktit të tij. Pas këtij kontakti fillestar, të gjithë ata u kontaktuan nga Konsulenti me email: disa prej tyre nuk u përgjigjën (shënuar me një yll sipër); disa u përgjigjën dhe pati përpjekje fillestare për të organizuar diskutime, por pa ndonjë vazhdim (të shënuar me dy yje më lart). Të gjithë u thirrën përmes telefonit nga Konsulenti, por pa përgjigje. Duhet mbajtur parasysh se ky kontakt me palët e interesuara po kryhej në mes të një pandemie globale me kufizime udhëtimi. Takimet apo prezantimet e grupeve të mëdha ishin të ndaluara nga ligji shqiptar. Grupe të vogla prej më pak se pesë personash u takuan në ambjente jashtë në Durrës ose brenda Ministrisë së Kulturës, Bashkisë Durrës, ose në zyrat e AADF-së me të gjithë të pranishmit duke përdorur maska. Së fundi, disa prezantime online u bënë në Ministrinë e Kulturës, Bashkinë dhe IKTK, por të pranishmit nuk u regjistruan plotësisht. Mund të sigurohet një listë e plotë e takimeve me datat, oraret dhe temat.

B.7 Praktikat e mira

Ekzistenca dhe insistimi për një Plan të Integruar të menaxhimit për Durrësin është, në vetvete, një praktikë e mirë. Ndërsa nevoja për një plan menaxhimi mund të merret e mirëqenë dhe e pranuar, por nuk është gjithmonë kështu. Shumë pasuri kulturore botërore, megjithëse kërkohet nga udhëzuesit (operational guide) të UNESCO-s, nuk kanë ende plan menaxhimi. Prandaj, Ministria e Kulturës duhet të përgëzohen për ligjin e Trashëgimisë Kulturore 2018 që kërkon Plan Menaxhimi për Pasuritë Kulturore,.

Sipas Interreg Europe, "një praktikë e mirë është një iniciativë, një metodologji, një projekt, një proces ose teknikë që ka disa prova suksesi në arritjen e qëllimit të saj". Kjo demonstron "rezultatet e prekshme dhe të matshme të nismës". Është e rëndësishme të thuhet se një praktikë e mirë "ka

potencialin të transferohet edhe në zona të tjera gjeografike[4]". Por "praktikë e mirë" do të thotë ide të zbatueshme që adaptohen dhe aplikohen më lehtë.

Cilët janë shembujt e praktikave të mira që janë studiuar dhe përfshirë në këtë PMI?

- **Dëgjimi dhe bashkëveprimi me palët e interesuara institucionale dhe të komunitetit.** Kjo ishte thelbësore në procesin e informimit të këtij plani. Gjithashtu, ky proces përfshiu testimin e ideve me të njëjtat palë të interesuara nëpërmjet vlerësimeve të shumta, dialogëve dhe prezantimeve.
- **Krijimi i një ekipi multidisiplinar** me përvojë ndërkombëtare. Ky ekip njëkohësisht ka njohuri të thelluara lokale të kombinuara me njohuri të praktikave të mira diku tjetër.
- **Kryerja e vizitave njohëse në terren** të kombinuara me hulumtime dokumentare. Ky hulumtim parësor dhe sekondar përfshin një rishikim të legjislacionit, një inventar të shpejtë, zhvillimin e sistemit të informacionit gjeografik dhe krijimin e një bibliografie të gjerë. Kjo i lejoi ekipit të kuptonte sfidat e Durrësit dhe siteve të trashëgimisë kulturore arkeologjike dhe arkitektonike.
- **Strukturimi i përgjigjeve ndaj sfidave** të Durrësit i fokusuar tek aspektet pozitive, duke filluar me një vizion të mbështetur nga qëllimet, objektivat, objektivat specifike dhe detyrat në një afat kohor të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë.
- **Renditja e masave të rekomanduara nga objektivat në katër kategori përmirësimi** - ruajtja dhe prezantimi, mbrojtjes(legjislacioni), vlerësimi/përdorimi dhe valorizimi.
- **Zhvillimi i një plani veprimi të realizueshëm në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë** me përgjegjësi të caktuara, burime financiare të dedikuara në lidhje me objektivin.
- **Krijimi i një dokumenti të adaptueshem i cili mund të përshtatet kur paraqiten sfida të reja.**

B.8 Njohja e Durrësit

Kjo periudhë është po aq e rëndësishme sa gjysma e parë e shekullit të XX. Shumë struktura të ndërtuara gjatë gjysmës së dytë të shekullit, në periudhën e regjimit komunist, kanë vlerë dhe kontribuojnë për qytetin. Gjatë zhvillimit të rëndësishëm qyteti zgjerohet në veri dhe strukturon qendrën e tij administrative. Zona industriale gjendet në lindje. Një plan urban strukturon shtrirjen e qytetit dhe ndërtohen objekte publike si dhe shumë banesa sociale. Rëndësia e kësaj trashëgimie historike dhe vlera e saj është e rëndësishme të theksohet sepse përfaqëson një periudhë të rëndësishme për Shqipërinë dhe është gjithashtu përfaqësuese e rëndësishme e lëvizjes së arkitekturës ndërkombëtare të mesit të shekullit të XX. Shumë ndërtesa publike u ndërtuan në këtë periudhë përfshirë ato administrative (prefektura, posta), kulturore (pallati i kulturës, muzeu i luftës) dhe sportive (pallati i sportit, stadiumi).

Figurë27 –Majtas, Pallati i Kulturës, Djathtas, Pallati i sportit(G. Reynal)

Ndërtesat që funksionojnë si banesa kolektive janë shumë karakteristike dhe përbëhen nga rreshta të gjatë katër deri në pesë kate të larta. Banesat kolektive në periferi janë shumë të degraduara. Këto banesa u janë shitur banorëve të tyre në fund të periudhës komuniste. Banorët, për arsye ekonomike, nuk kanë mundur t'i mirëmbajnë ato. Gjendja e tyre e degraduar i delegohet gjithashtu cilësisë së dobët të ndërtimit të kohës (ndërtim i shpejtë, materiale të dobëta).

Figurë28 –Banesat sociale të ndërtuara gjatë zgjerimit të qytetit (G. Reynal)

Hapësirat publike që strukturojnë zgjerimin e qytetit modern kane nevojë për studim dhe njohje. Aksi urban më i rëndësishëm është ai i Muzeut të Luftës në vazhdimësinë e hyrjes në Durrës. Ky aks drejt Muzeut të Luftës, trajtohet si një qendër tregtare urbane me kafene në hapësirat e gjelbra përgjatë rrugës. Në gjatësinë e këtij aksi janë rreshtuar ndërtesa banimi të së njëjtës periudhë. Struktura ortogonale e rrugëve të lagjeve të reja në veri të aksit të Muzeut të Luftës është e identifikueshme dhe do të shërbejë si një strukture bazë për zhvillimin e të gjithë zonës deri në ditët tona.

Figurë29 –LIIB, Monument përkujtimor

Shumë e ndryshme, por njëkohësisht shumë karakteristike për kulturën urbane shqiptare, trashëgimia e periudhës komuniste është gjithashtu një trashëgimi e vlefshme. Objektet publike ende funksionojnë dhe kryejnë funksionin e tyre. Hapësirat publike janë cilësore dhe plotësojnë nevojën e qytetit. Sigurisht që ndërtesat përreth këtyre hapësirave publike (veçanërisht aksi i Muzeut të Luftës) përfaqësojnë vlera arkitektonike, një interes urban të pamohueshëm me domethënie historike dhe integritet në ruajtjen e tyre.

Figure 30 –Harta e trashëgimisë moderne të Durrësit(G. Reynal)



C.6 Një vështrim i përgjithshëm mbi peizazhin urban dhe trashëgiminë

Durrësi është një qytet gjithnjë në ndryshim. Projektet e fundit të mëdha të infrastrukturës civile, si shëtitorja buzëdetit, janë pothuajse në përfundim dhe puna vazhdon në shumë nga rrugët dytësore që të çojnë në port. Qyteti pati një impakt të madh negativ nga një tërmet i fuqishëm me madhësi 6.4 ballë në 26 nëntor 2019, ku vdiqën 51 vetë dhe u plagosën mbi 3000 të tjerë[12].Ky ishte dëmtimi më i rëndë në Shqipëri në 99 vjet. Sheshi kryesor publik ka përfunduar gjithashtu kohët e fundit. Paralelisht zhvillohen projekte të shumta private të të gjitha formave dhe madhësive. Trashëgimia kulturore e Durrësit është subjekt i presioneve të forta që lidhen me zhvillimin aktual urban të tij. Efektet e këtij presioni u ndjenë dhe u dëshmuan gjatë gërmimeve pesë vjeçare të Misionit Arkeologjik Franko-Shqiptar.

Zhvillimi urban i Durrësit u përcaktua nga vendndodhja e tij natyrore, veçanërisht e favorshme për vendbanimet dhe veprimtarinë portuale duke ofruar një zonë shumë të mbrojtur që hapej në lindje. Kjo i nënshtrohej një kufizimi të dyfishtë; aksesi vetëm në perëndim dhe prania e një kënete në lindje. Shtrirja e qytetit midis këtyre dy pengesave mund të ndodhte vetëm në veri, në një rrip toke në formën e një dardhe e cila vinte duke u ngushtuar. Në mënyrë të ngjashme, lidhjet me zonën përreth ishin veçanërisht të vështira. Kishte vetëm një kalim në jug përgjatë bregdetit dhe një korridor në veri deri në tharjen e kënetës në vitet 1970. Sot, drejtimet e rrugëve kryesore dhe hekurudhave vazhdojnë të ndjekin këtë drejtim.

C.6.1 Nën efektin e urbanizimit të shpejtë

Iniciativat private në sektorin e pasurive të patundshme janë jo proporcionale dhe, në shumë raste, të pakontrolluara në lidhje me historinë e qytetit. Ndërtesat me funksion banim dhe biznes, disa prej të cilave kanë mbetur të papërfunduara për vite me radhë, janë ndërtuar afër qytetit antik, brenda kufijve të tij ose në shpatet e pjerrëta të kodrës përgjatë detit, një shkollë private me arkitekturë neo-antike dominante përballë mureve. Në shumë zona të mbrojtura janë bërë ndërtime ndërsa, në të njëjtën kohë, ndërtesa shumë interesante historike janë braktisur, të tilla si Hotel Vollga pranë kullës Veneciane ose Vila e Mbretit Zog. Dy-tre vitet e fundit vihen re ndërtime të reja që shfaqen në zonat e vjetra të cilat respektojnë vëllimin e atyre ekzistuese por duke krijuar një histori të rreme arkitektonike, të tilla si në Disney (elemente arkitektonike voluminoze dhe dominante, trarë, frontone, kolonada dhe ngjyra të forta). Restaurimet e shtëpive neoklasike janë realizuar në një numër shumë të kufizuar.

Organizimi i hapësirave publike ndjek të njëjtën tendencë. Projektet komplekse të dizajnit nuk kanë lidhje organike me përdorimet reale të tyre. Karakteristikat e tyre nuk lehtësojnë vazhdimësinë e hapësirave në shkallë qyteti. Sheshi para Bashkisë dhe veçanërisht sheshi para hyrjes së portit nuk kanë lidhje me zhvillimin historik dhe të suksesshëm të dy rrugëve kryesore tregtare. Në të njëjtën kohë, hapësirat e tjera publike nëpër lagje janë lënë pas dore dhe pothuajse nuk mirëmbahen. Gjithashtu, vihet re një përkeqësim i dukshëm i lagjeve të trashëgimisë të fillimit të shekullit të 20-të. Sidoqoftë, disa ndërtesa përgjatë dy rrugëve tregtare janë restauruar ose janë në proces restaurimi. Situata në zemër të blloqeve është shumë e degraduar, kjo nënkupton rrezikun që këto struktura shpejt mund të zhduken.

Duhet përmendur gjithashtu trashëgimia e mesit të shekullit të 20-të. Këto struktura janë dëshmitare të historisë së vendit të kësaj periudhe dhe karakterizohen nga tiparet e arkitekturës të kësaj periudhe. Objektet përfaqësuese janë ato publike, si prefektura, gjykata, pallati i kulturës, pallati i sportit dhe Muzeu i Luftës. Më pak të evidentuara janë ndërtesat me funksion strehimin social, shumë

[12]https://sq.wikipedia.org/wiki/T%C3%ABrmeti_i_26_n%C3%ABntorit_2019_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri#cite_note-Vilater-1

karakteristike të këtyre viteve të cilat përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të historisë së qytetit. Pas rënies së komunizmit, këto banesa iu dhanë banorëve të tyre. Pas ndryshimit të pronësisë gjendja e tyre u përkeqësua ndjeshëm për arsye se banorët nuk ishin në gjendje të paguanin për mirëmbajtjen. Sidoqoftë, disa prej tyre kanë një funksion të rëndësishëm në peizazhin urban të Durrësit, pasi ato kornizojnë hapësirat kryesore publike të projektuara në atë kohë, siç është rruga përpara muzeut të Luftës.

Duke analizuar rrënojat arkeologjike, më të rëndësishmet janë Amfiteatri, pjesë të murit pranë bregdetit dhe Kulla Veneciane. Mbetje të tjera domethënëse ende të pazbuluara plotësisht përfshijnë Forumin Bizantin, një hapësirë boshe në qytet me gjithë kolonat e tij janë të ngritura dhe Termat Romake nën Pallatin e Kulturës. Trashëgimia arkeologjike nuk duket të jetë një vektor i zhvillimit. Në të vërtetë, shumica e aktivitetit arkeologjik konsiston në gërmimet gjatë ndërtimeve, të cilat më pas shkatërrohen ose mbulohen. Gjetjet e rëndësishme nuk janë zhvilluar dhe në shumicën e rasteve, mbulohen. Në investimet publike, mbetjet arkeologjike janë reduktuar në minimum ose injoruar plotësisht si në rastin e sheshit para bashkisë, një zonë e rëndësishme për të perceptuar qytetin antik. Këto mbetje sigurisht që mund të kishin përmirësuar dhe frymëzuar zhvillimin e sheshit.

Figurë31 – Hotel Vollga në një vend të spikatur, ende i braktisur

Cilat janë orientimet e PM-së referuar këtyre vëzhgimeve?

Përmirësimi i ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike nuk mund të realizohet pa bashkëveprim ndërmjet ruajtjes së trashëgimisë të shekujve 19-të dhe 20-të. Nocioni i trashëgimisë është një i tërë dhe Durrësi karakterizohet nga kjo tërësi. Pjesa më e madhe e trashëgimisë së shekullit të 19-të dhe e gjysmës së parë të shekullit të 20-të ndodhet mbi zonat e pasura me arkeologji. Nëse këto ndërtesa të vjetra ruhen, mbetjet arkeologjike nën to do të ruhen. Kufizimi i ndërtimeve në gjurmët e ndërtesave ekzistuese do të bëjë që mbetjet e fundit të mbrohen.

C.7 Zonat e mbrojtura arkeologjike A dhe B

Për të mbrojtur arkeologjinë e njohur dhe të panjohur në qytetit, qeveria miratoi një seri rregulloresh në lidhje me zhvillimin e ndërtimeve. Në vitin 2018, në zbatim të detyrimeve të Ligjit Nr. 27/2018 me propozim të Ministrit të Kulturës dhe me Vendim të Këshillit të Ministrave, u miratua Vendimi Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për Miratimin e Zonave Arkeologjike "A" dhe "B", të Qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre".

Zonat arkeologjike "A" dhe "B" përbëjnë hapësirën e mbrojtur urbane të arkeologjisë, historisë dhe vlerave kulturore të qytetit të Durrësit. Zonat A dhe B u kategorizuan sipas dendësisë dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike.

C.7.1 Evoluimi dhe themelimi

Qyteti i Durrësit ka disa akte rregullatore planifikimi që orientojnë planifikimin urban dhe lëshimin e lejeve të ndërtimit në zonat arkeologjike A dhe B. Projektet e zhvillimit, të konservimit, restaurimit, në zonat arkeologjike A dhe B, referuar VKM nr.786/2018 kalojnë për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Në rast se gjatë zbatimit të projekteve, zbulohen gjetje të rastësishme, ndërpriten menjëherë punimet në përputhje me nenin 145 të ligjit nr.27/2018. Drejtuesi teknik ose zhvilluesi njofton me shkrim për gjetjet e zbuluara organet e vetëqeverisjes vendore dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore. Procedura e zbatuar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 27/2018.

1. Zona A është zona me dendësinë më të lartë arkeologjike, gjithashtu, zonë ku ekziston trashëgimia moderne e fillimit të shekullit të 20-të. Qëllimi i rregullores është të pajtojë këto dy kufizime. KKTKM-ja duhet të vlerësojë/shqyrtojë, të gjitha projektet e vendosura në Zonën A:

a) mirëmbajtjen, restaurimin dhe konservimin e integruar të monumenteve të kulturës dhe strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projektit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM);

b) metodat e testimit, të tilla si sondazhet që nuk kërcënojnë shtresat arkeologjike, kërkimet gjeo-fizike, regjistrimin digjital të terrenit, siç parashikohet nga vendimi i KKTKM-së;

c) zhvillimin e projekteve të kërkimit shkencor të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;

ç) rindërtimin e rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik, në përputhje me projektet e miratuara nga KKTKM-ja;

d) rindërtimin e ndërtesave ekzistuese pa ndryshime në gjurmën e tyre, me kusht që vëllimi i tyre të mos cënojë pasurinë kulturore nëntokësore, në përputhje me projektet e miratuara nga KKTKM-ja;

dh) ngritja e konstruksioneve të lehta (prej druri, qelqi, plastike, metali) në lartësinë maksimale të një kati, për qëllime të informacionit publik mbi aktivitetet arkeologjike dhe të trashëgimisë kulturore dhe nevoja të tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë:

i. konstruksionet duhet të jenë lehtësisht të çmontueshme dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin.

ii. projekti për ngritjen e konstruksionit të lehtë do të aprovohet nga KKTKM-ja dhe në çdo rast duhet të përcaktojë qartë qëllimin, kornizën kohore dhe vendndodhjen e strukturave.

iii. instalimi duhet të ndërmerret nën mbikëqyrjen e institucioneve të specializuara shtetërore.

Projektet për ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe ndjekin procedurat në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Zona B është zona me dendësinë më të vogël arkeologjike dhe rregullorja është më fleksibël. Sipas nenit 4, VKM 786, KKTKM-ja, përveç ndërhyrjeve të lejuara në zonën arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit, në zonën arkeologjike "B" lejohen ndërtime të reja të miratuara nga KKTKM-ja, si më poshtë:

i. Projektet për ndërtimet e reja shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe ndjekin procedurën në zbatim të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

ii. Ndërtimet e reja do të lejohen vetëm pasi të kenë përfunduar testimet e parashikuara nga KKTKM-ja bazuar në potencialin arkeologjik të zonës.

iii. Gërmimet arkeologjike do të ndërmerren në zbatim të dispozitave të KKTKM-së dhe pas lidhjes së marrëveshjes përkatëse, një nga palët e së cilës në çdo rast do të jetë Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Për të dy zonat A dhe B parashikohen ndëshkime për mosrespektimin akteve ligjore dhe nënligjore (ndërprerja e punës ndërtimore brenda 24 orëve dhe madje ndjekje penale ligjore). Parashikimet në aktet rregullatore synojnë mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike dhe i përgjigjen një presioni shumë të fortë për ndërtime që është ushtruar që nga vitet 2000.

Zona Arkeologjike "A" dhe "B" e qytetit të Durrësit



Figurë32 –Zonat e mbrojtura arkeologjike A dhe B të Durrësit brenda kontekstit urban (Ministria e Kulturës)

C.7.2 Monumentet

AMFITEATRI

Amfiteatri është një nga monumentet kryesore të antikitetit i ndërtuar gjatë dekadave të para të shekullit II-të, ndoshta gjatë sundimit të perandorit Romak Hadrian. Ndryshe nga Amfiteatrot e tjerë të asaj kohe të ndërtuar tërësisht në një terren të rrafshët, ai mbështetet pjesërisht në shpatin e një kodre për të siguruar mbështetjen në njërën anë të shkallares, ndërsa pjesa tjetër është e ngritur në tokë të rrafshët. Ka një paraqitje eliptike me përmasa të jashtme rreth 132m x 113m; dimensionet e brendshme rreth 61x42m në lartësinë 20 metra. Një bazë e lartë 2.5 metra rrethon arenën dhe parapetin, prapa së cilës qëndronte shkallarja. Baza përmbante disa pasazhe me qemer për hyrjen e kafshëve dhe gladiatorëve në arenë. Zonat që shërbyen për të mbajtur kafshët (aksesoheshin përmes galerive) ruhen në anën verilindore të shkallares, të zbuluara gjatë gërmimeve arkeologjike. Pas bazës, *praecinctio* (shtegu i parë) me gjerësi 2.5m, i lejonte spektatorët të uleshin në katër rreshtat e parë të shkallares. Mbi këtë shtresë shtrihet një shteg tjetër ku gjenden hyrjet (*vomitorium*) të galerive të brendshme, të cilat furnizonin *maenianium-in* e parë (ballkon) të *cavea*-s (shkallare). Amfiteatri u shpall monument kulture në vitin 1973. Deri më tani, është gërmuar më pak se gjysma e monumentit, e përbërë nga shkallarja, galeritë dhe *maenianium*-et.

Figurë33 – Imazh satelitor i Amfiteatrit

Gjatë shekujve, Amfiteatri ka pësuar modifikime dhe përdorime të ndryshme. Disa galeri u përdorën si kishë (sot, kapela bizantine është qartësisht e dukshme), ndërsa pjesët e tjera u përdorën si varrezë. Arena qendrore u pushtua nga shtëpitë gjatë epokës osmane, ndërsa sot është kryesisht e mbushur me mbeturina nga prishjet dhe shembjet.

Figurë34 - Hyrjet dhe kalimet e këmbësorëve

Figurë 35 - Kufiri i qytetit jugperëndimor

Figurë 36 - Kufiri i qytetit lindor

Figurë 37 - Tuneli dhe pjesa veriore

Figurë 38 - Kapela Bizantine

Figurë 39 - Mozaikët

Figurë 40 - Galeria e brendshme

KALAJA DHE MURET FORTIFIKUESE TË DURRËSIT

Përshkrim i shkurtër:

Kalaja e Durrësit është kompleks i fortifikimeve, kryesisht nga periudha mesjetare, që përfshin edhe pjesë të ndërtuara në periudhën osmane. Kalaja mesjetare ndodhet në skajin jugperëndimor të gadishullit të Durrësit. Nga muret antike të vona të Durrësit, shtrirjet e mëposhtme janë të dukshme, ato kanë nivele të ndryshme konservimi, valorizimi dhe prezantimi.

Pjesa 1 Fragmenti që përfshin katër kulla në anën jugperëndimore është sot zona e ruajtur më mirë. Sidoqoftë, linja e mureve të fortifikimit që shkon nga citadela në drejtimin juglindor është prishur në shumë pjesë. Seksionet e mbetura janë mirë konservuara, të integruara në strukturën urbane dhe të dallueshme qartë.

Observacione mbi Pjesën 1:

- Kjo pjesë ka një nivel të mirë **mbrojtjeje** (statusi i mbrojtjes si Kategoria I).
- **Konservimi** strukturor dhe arkitektonik është thelbësor, por disa pjesë janë prekur nga tërmeti 2019 dhe kanë nevojë për ndërhyrje strukturore (një projekt ruajtjeje për stabilizimin dhe rindërtimin po vazhdon). Monumenti ka nevojë për ndërhyrje të vazhdueshme konsoliduese, por është në gjendje të mirë.
- Për sa i përket **paraqitjes** dhe **vlerësimit/valorizimit**, kjo pjesë e fortifikimeve është e integruar mirë me peizazhin për ekspozimin e saj, por brezi i gjelbër përgjatë anës së tij të jashtme, instalacionet artistike dhe disa panele shpjegues janë shume të konsumuar.
- Ka një **Aksesibilitet** të mirë për këmbësorët - dhe automjetet gjithashtu; mundësi të kufizuara parkimi përgjatë rrugës.

Potenciali për sa i përket tërheqjes turistike është shumë i lartë për arsye të nivelit të lartë të Integritetit dhe Autenticitetit, edhe pse vetëm në anën e jashtme.



Figurë 41 - Pjesë të mureve fortifikuese

Pjesa 2 Pjesa më e lartë e kompleksit të fortifikimit përfshin katër kullat e kështjellës Mesjetare dhe shtrirjen e tyre në drejtimet jugore dhe lindore (fortifikimet pjesa n. 3): vija e parë lidh torren me fragmentin. (A) përgjatë Amfiteatrit. Linja tjetër (3) përfshin disa fragmente që zbresin në

sheshin Liria, duke kaluar ndërmjet Amfiteatrit dhe Xhamisë së Madhe dhe vazhdon përgjatë rrugës Grigor Durrsaku.

Observacione mbi Pjesa 2:

- Kjo pjesë ka një nivel të mirë të **mbrojtjeje** (statusi i mbrojtjes si Kategoria I).
- **Konservimi** strukturor duket mjaft i mirë por rekomandohet një vlerësim për disa pjesë të palidhura që mund të jenë prekur nga tërmeti i vitit 2019. Ndërhyrja arkitektonike e konservimit duhet të planifikohet, veçanërisht për kullat veriore.
- Për sa i përket **prezantimit** dhe **valorizimit**, kjo pjesë e fortifikimeve ka nevojë për planifikime të masave urgjente pasi është shumë e vështirë të kuptohet kompleksiteti i monumentit dhe të perceptohet bërthama e vjetër e kalasë dhe lidhja e saj me pjesët e tjera të fortifikimit.
- **Aksesibiliteti nga këmbësorët** është i pamundur nga bërthama e qytetit për shkak se kalimet ekzistuese të vjetra janë mbyllur nga gardhe dhe ndërtime të paligjshme. Sidoqoftë, disa dekada më parë, ishte e mundur të arrihej në këto zona nga pasazhet afër Amfiteatrit. Pjesa e sipërme e kalasë mund të arrihet vetëm me makinë, por s'ka mundësi parkimi.
- **Potenciali për sa i përket tërheqjes turistike** është shumë i lartë për shkak të pamjes mahnitëse që mund të shijohet nga lart. Për më tepër, kullat e braktisura ose të fshehura në anën veriore duket se mbrojnë nivelin e lartë të Autenticitetit dhe Integritetit që duhet të valorizohet nga prezantimi. Duhet të hartohet dhe miratohet një plan specifik për heqjen e ndërtimeve të paligjshme/shpronësimit dhe për sistemin e ndriçimit për të evidentuar peizazhin.

Observacione mbi Pjesa 3

Pjesa 3 Kjo është shtrirja e mureve fortifikuese nga kalaja në drejtimet jugore dhe lindore

- Kjo pjesë ka një nivel të mirë **mbrojtjeje** (statusi i mbrojtjes si Kategoria I) megjithëse duhet të parashikohet një hapësirë më e përshtatshme për ruajtjen e saj.
- **Konservimi** strukturor është i mirë dhe duhet të planifikohet ndërhyrja arkitektonike e konservimit si një ndërhyrje parandaluese si dhe të vazhdojë mirëmbajtja periodike.
- Për sa i përket **prezantimit** dhe **valorizimit**, kjo pjesë e fortifikimeve ka nevojë për masa për të harmonizuar pjesë të ndryshme të mureve dhe për të lejuar një perceptim më të plotë të kompleksit të monumentit.
- **Aksesibiliteti nga këmbësorët** është i mundur nga qendra e qytetit dhe pjesa lindore edhe pse pjesa e sipërme e kalasë nuk mund të arrihet.
- **Potenciali për sa i përket tërheqjes turistike** është shumë i lartë .

Pjesa 4 Linjat lindore janë më të degraduarat dhe rrënojat janë shumë të kufizuara, duke përjashtuar nivele të ndryshme të strukturës së brendshme urbane krahasuar me nivelin e jashtëm dhe rrugët përkatëse.

Figurë 42 – Rrënojat e themeleve të fortifikimeve

Figurë 43 - Rrënojat e mureve të fortifikimit që përfshihet në ndërtesa

Observacione mbi Pjesa 4:

- Kjo pjesë është pa **mbrojtje** (nuk është përfshirë në listë ose harta). Elementi i mbetur duhet të hartëzohet dhe të listohet për mbrojtje.
- **Konservimi** strukturor komprometohet nga ripërdorimi i përfshirjes së tij në konstruksionin e ndërtuar duke përdorur muret. Mbetjet e kufizuara arkeologjike duhet të konsolidohen dhe ruhen.

- Për sa i përket **prezantimit** dhe **valorizimit**, kjo pjesë e fortifikimeve ka nevojë për masa urgjente për të lejuar evidentimin e kompleksit të fortifikimit që ishte atje. Duhet të parashikohet një plan për të hequr parkimin mbi nivelin e murit dhe një hapësirë sigurie.
- **Aksesibiliteti** për këmbësorët dhe makinat është i mundur nëpërmjet të gjithë linjës së qarkut të murit lindor.
- **Potenciali për sa i përket tërheqjes turistike** të kësaj pjese nuk është i lartë por kontribuon për të kuptuar plotësisht rolin antik të qytetit. Prandaj, ndërhyrja për ruajtjen, konservimin dhe prezantimin duhet të planifikohet edhe për këtë pjesë të mureve.

Pjesa 5 Një segment tjetër i shkëputur nga muri juglindor që përbëhet nga pak mbetje në nivelin e tokës. Muri mund të gjurmohet në mbetjet e izoluara të rrafshuara në tokë, prapa ish-bankës së shtetit.

ROTONDA/(*Macellum*-i, Forumi Bizantin)

Pazari i Vjetër u zbulua në 1987-1990 dhe u shpall monument kulture në vitin 2003. Gërmimi zbuloi rrënojat e forumit të *macellum*-it të periudhës Bizantine. Supozohet se monumenti u ndërtua në shekullin e 2-të p.es deri në shekullin e 4-të dhe i shërbeu atij funksioni deri në shekullin e 7-të. Më vonë, forumi u shndërrua në një varrezë. Monumenti është ndërtuar në formën e një portiku të rrumbullakët, qendra e të cilit është e zënë nga një podium. Monumenti ka shërbyer si një forum publik për organizimin e panaireve.

Monumenti aktualisht përshkohet nga tubat e kanalizimeve dhe ka aksesibilitet shumë të kufizuar. Ai kërkon ndërhyrje për konservim dhe rekomandohet një projekt i madh dhe "mise en valeur" i prezantimit për ta lidhur atë me zonën ngjitur të *Macellum*-it.

Figurë 44 - Forumi Bizantin

Figurë 45 - Forumi Bizantin

TERMAT ANTIKE ROMAKE NËN PALLATIN E KULTURËS

Termat u zbuluan në Durrës në vitin 1960 gjatë ndërtimit të qendrës kulturore Aleksandër Moisiu. Në vitin 1973, ato u shpallën monument kulture. Këto banja datohen në fazën e rëndësishme urbane të gjysmës së parë të shekullit II para Krishtit, kur zhvillimi i jetës publike në qytetet romake solli përhapjen e praktikave higjienike të cilat çuan në ndërtimin e banjave përkatëse publike dhe private. Termat ishin të pajisura me *tepidarium*, *frigidarium*, pishinë. Aktualisht, dy zonat janë të dukshme. Në perëndim të këtij kompleksi kalon e vetmja rrugë romake që gjendet në drejtimin veri-lindje. Kompleksi kërkon disa ndërhyrje konsoliduese dhe restauruese. Për më tepër, strukturat në pallatin e kulturës duket se kërkojnë ndërhyrje konsoliduese. Monumenti nuk është lehtësisht i arritshëm dhe ka pak shpjegime për këtë. Kërkohet një projekt i madh për prezantim dhe valorizim, që ta lidhë atë me zonën ngjitur të *Macellum*-it.

Figurë 46 - Termat

Figurë 47 - Termat - pjesa e jashtme

HAMAMI NE OBORRIN E SHKOLLËS "16 SHTATORI"

Hamami Mesjetar i Durrësit ndodhet në qendër të qytetit, në rrugën "Stefan Vokopola". Nuk ka ndonjë tregues që përcakton ndërtimin e Banjave Mesjetare të Durrësit, megjithatë, bazuar në teknikën e ndërtimit dhe raportet krahasuese, supozohet se ky objekt daton në shekullin e 18-të. Hamami Mesjetar i Durrësit është një monument kulture i kategorisë së parë dhe mori statusin e monumentit të kulturës në 1973. Pjesa qendrore e objektit përmban një kupolë, ndërsa pjesa tjetër e poshtme përmban harqe prej guri. Ndriçimi bëhet i mundur përmes hapësirave të vogla në kupolë me dimensione 15x15 cm. Ngrohja realizohej nëpërmjet kaldajave të bakrit ku avulli qarkullonte nëpër tuba qeramike.

Pas tërmetit të 26.11.2019, specialistët e DRTK Tiranë kanë inspektuar monumentin i cili rezultoi se kishte pësuar dëme të moderuara në strukturë. Çarjet kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme në mënyrë që të shmanget thellimi i dëmit. Një projekt u nis nga MK-ja dhe punimet duhet të zbatohen së shpejti. Rrugët para monumentit dhe bllokut ku ndodhet monumenti kanë nevojë për një projekt të dizajnit urban që duhet të përfshihet në projektin në vazhdim TID.

PUSI I TOPHANËS

Pusi i Tophanesë është një monument i shekullit të 16-të. Supozohet se më parë ka qenë një *nymphaeum* i lashtë. Gjatë Mesjetës ai furnizonte me ujë qytetin, gjë që vazhdoi deri në 1970. Duhet të ketë pasur një ndërhyrje serioze gjatë periudhës veneciane, siç është e dukshme nga përdorimi i elementeve antikë si kolona dhe granit, dhe plloçat e mëdha të gurit që rrethojnë grykën e pusi në formë kalldrëmi. Sipas historianëve, pusi mesjetar i shërbeu gjithashtu një punishteje për prodhimin e barutit, prandaj dhe emri "Tophane" (depo armësh). Monumenti mirëmbahet nga DRTK-Tiranë, e cila ka nën juridiksioni e saj edhe qarkun e Durrësit Kjo zonë ka nevojë për një projekt prezantimi duke përfshirë ndriçimin e duhur. Ky objekt duhet të përfshihet në projektin në proces TID.

BANESA KU LINDI DHE KALOI DISA VITE TË FËMIJËRISË ALEKSANDËR MOISIU

Struktura është arkitekturë tipike osmane e vonë dhe e fillimit të shekullit të 20-të, e veçantë me strukturën e saj harmonike të gurtë dhe me dysheme druri, shkallët të mbuluara nga harkata të bukura. Ndërtesa u ndërtua nga një familje tregtare në shekullin 20-të. Aleksandër Moisiu ka kaluar një pjesë të jetës së tij në këtë shtëpi. Në fillim të shekullit të 20-të, ajo u shndërrua në një strehë deri në vitin 1980. Në 1973, u shpall monument kulture i kategorisë së parë. Ajo është një shtëpi dy katëshe me çardak (pergola). Shtëpia ka një çati me tjegulla vendi, dysheme me pllaka guri dhe tavane druri. Fasada është zbukuruar me gurë të gdhendur, shkallët janë bërë me blloqe guri. Shtëpia ka një ulluk për të mbledhur ujin nga çatia. Kangjellat e shkallëve janë punuar me dorë. Sot, kjo ndërtesë ka funksionin edhe të Muzeut Etnografik të Durrësit.

Një projekt u lançua nga MK-ja dhe punimet duhet të zbatohen së shpejti. Ishte një projekt i planit të Konservimit me identifikimin e të gjitha ndërhyrjeve të nevojshme për ruajtjen dhe konservimin e monumentit. Rruga para monumentit ka nevojë për një projekt urban që duhet të përfshihet në projektin në proces TID.

BANESA KU KA JETUAR F. S. NOLI

Shtëpia daton në fillim të shekullit të 20-të. Është një shtëpi tre katëshe me elemente dekorative. Fan S. Noli ka jetuar në këtë shtëpi për rreth një vit në vitet 1914 - 1915. Aktualisht ndërtesa nuk është e hapur për publikun pasi ndodhet pranë ndërtesës së Shërbimit të Inteligjencës së Shtetit.

Përveç shënjuesve të dukshëm të peizazhit - muri mesjetar i ruajtur mirë, Amfiteatri Romak i jashtëzakonshëm dhe imponues, Forumi Bizantin, gërmimet arkeologjike kanë zbuluar një sasi të konsiderueshme elementesh gjatë gërmimeve të shpëtimit, gjatë ndërtimit të ndërtesave ose zhvillimit të hapësirave publike. Shumica nuk janë më të dukshme në qytet, të tjerët janë ruajtur në bodrume, përmendim veçanërisht kompleksin që përbëhet nga Termat dhe një rrugë e rëndësishme romake nën pallatin aktual të kulturës.

Përveç trashëgimisë antike, në fillim të shekullit të 20-të, u krijuan ndërtesat e periudhës së shtetit shqiptar. Bëhet fjalë për banesa me karakter borgjez ose urban të një lloji më modest ose edhe rural, por edhe për ndërtesat e para simbolike publike si bashkia e qytetit dhe Banka e Shqipërisë. Periudha komuniste zhvilloi edhe mjediset publike dhe një lloj banese kolektive karakteristike të kësaj periudhe. Përballja e këtyre elementeve të ndryshme të trashëgimisë me qytetin modern në zhvillim të plotë në fund të shekullit të 20-të dhe deri në ditët e sotme është një tipar i papërsëritshëm i qytetit. Në periudhën e parë, ndërtimet anarkike të ndërtesave, shpesh të larta, pasojat e bumit ekonomik të Shqipërisë pas periudhës komuniste, rëndonin mbi ruajtjen e trashëgimisë, si arkeologjike ashtu edhe moderne. Gjatë dekadës së kaluar, janë përcaktuar politikat e mbrojtjes të cilat kanë nevojë për t'u përkrahur.

C.8 Kuadri ligjor dhe institucional

C.8.1 Kuadri ligjor

Kuptimi i situatës ligjore në Durrës është thelbësor për të planifikuar mbrojtjen e aseteve arkeologjike dhe arkitekturore, duke lejuar zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit. Mbrojtjet ligjore për arkeologjinë dhe llojet e tjera të trashëgimisë kulturore për Durrësin janë të shumta dhe komplekse. Kjo perfshin edhe ligje të tilla të cilët kërkojnë hartimin e Planeve të Menaxhimit, duke përfshirë edhe këtë plan.Mbrojtja përfshin gjithashtu akte dhe nënakte ligjore të përgjithshme në nivel kombëtar që mbrojnë trashëgiminë kulturore dhe renditjen specifike të aseteve me rëndësi kombëtare, siç është Amfiteatri.
Ekzistojnë gjithashtu akte dhe nënakte ligjore më specifike të hartuara për të trajtuar situatën në Durrës në lidhje me trashëgiminë kulturore, duke përfshirë VKM-në e sipërcituar për Zonat A dhe B. Por ka edhe akte të tjera të planifikimit në bashkinë e Durrësit, duke përfshirë tre Masterplane, 1) një i miratuar ende i vjetëruar, 2) tjetri në fuqi de facto, ende i pa miratuar zyrtarisht, dhe 3) një plan i ri është duke u hartuar.
Për më tepër, amfiteatri është në tentativ listë të trashëgimisë botërore dhe është ambicie e Ministrisë së Kulturës që ta nominojë atë në Listën e Trashëgimisë Botërore. Analiza e legjislacionit në fuqi është shumë e shumëanshme dhe të shumëfishtë. Ky proces filloi me një hulumtim për të gjitha ligjet që lidhen me trashëgiminë kulturore, pasuritë e paluajtshme, ndërtimet, planifikimin territorial dhe rajonal dhe shpronësimet. Kjo listë e përgjithshme u fokusua më pas në analizën e mëparshme të çështjeve në Durrës, duke përfshirë cenimet ligjore dhe të paligjshme, ndërtimet dhe çështjet brenda kuadrit ligjor dhe masterplanit ekzistues.
Llojet e rishikimit të legjislacionit përfshijnë:

- **Legjislacioni për Trashëgiminë Kulturore, siç është ligji nr.27/2018 që kërkon plane menaxhimi**

- **Legjislacioni për Ndërtimin në lidhje me sigurinë e jetës, strukturat pa leje, inspektimet, lartësitë e ndërtesave dhe ndërtimet e paligjshme**
- **Shpronësimet në interes të publikut**
- **Masterplanet, planifikimi, zhvillimi dhe urbanizimi i territorit**
- **Turizmi dhe promovimi i zhvillimit ekonomik**

Kuadri ligjor, që përfshin ligjet, vkm, udhëzime, urdhrat më të rëndësishme në lidhje me ruajtjen e trashëgimisë në Durrës, është përmbledhur më poshtë me një analizë të shkurtër. Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse janë përfshirë në Aneks, duke paraqitur më shumë informacion në lidhje me kuadrin ligjor.

Kjo pasohet nga dy seksione të rëndësishme në lidhje me listën e pasurive kulturore(monumente) brenda qytetit të Durrësit dhe datat e shpalljes së tyre, dhe një përshkrim të Udhëzuesit të Ruajtjes dhe mospërputhjet e tij me VKM e Zonave Arkeologjike A dhe B, të qytetit të Durrësit.

Kuadri ligjor:

1. **VKM, Nr. 786 date 26.12.2018, "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre".**
   Ky vendim në lidhje me zonimin u propozua nga Ministria e Kulturës dhe u formulua nga ekspertë të arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore. Ai është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe ky nivel përfshirjeje dhe shqetësimi kombëtar për arkeologjinë e nëntokës së Durrësit është kritik. Mbrojtjet brenda këtij vendimi janë të forta dhe të dobishme. Duke e ndarë qytetin në tri zona (mbrojtje me kushte mbrojtje më të forta për zonën "A", me kushte më të moderuara për zonën "B" dhe pjesa tjetër e qytetit me edhe më kushte me të lehta mbrojtje) është një kompromis midis ruajtjes dhe zhvillimit të ardhshëm. Sidoqoftë, problemet në këtë vendim janë se disa zona kritike nuk u mbuluan mjaftueshëm, veçanërisht në Zonën A.
2. **PLANI I DURRËSIT - UDHËZUES PËR RUAJTJEN, SHTOJCA III.**
   Ky udhëzues në lidhje me konservimin e zonave arkitektonike të qytetit është i dobishëm dhe i konceptuar mirë. Sidoqoftë, nuk është një dokument ligjor specifik i ndarë nga plani Në seksionin tjetër përfshihet më shumë detaje.
3. **LIGJI 27/2018 "PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE MUZETE".**
   Ky ligj i dedikohet trashëgimisë kulturore kombëtare dhe muzeve, veçanërisht është i rëndësishëm duke pasur parasysh që Muzeu Kombëtar Arkeologjik i Durrësit dhe Parku Arkeologjik janë renditur së bashku dhe u është dhënë status kombëtar në nenin 202 dhe 212. Gjithashtu, parashikohet struktura raportuese drejtpërdrejt tek Ministria e Kulturës, përshkruan funksionin dhe kërkon që muzetë të bashkëpunojnë dhe koordinojnë me qeverinë lokale dhe rajonale, si dhe dhe përcakton kufijtë e PA. Të kuptuarit e këtij ligji është thelbësor nëse propozohet një strukture e re e menaxhimi. Ajo që duhet të shihet është se nuk përmendet marrëdhënia me Institutin e Arkeologjisë.
4. **VKM Nr. 442, datë 3.6.2020** në lidhje me zonën e re të zhvillimit në Durrës dhe emërimin e FSHZH-së si njësi ekzekutive. Ky vendim është thelbësor për suksesin dhe menaxhimin më të mirë të zonave arkeologjike. Njohja në këtë nivel e vendimit nxjerr në pah nivelin e besimit midis njësive publike dhe private dhe njohjen e përfitimeve të bashkëpunimit. Menaxhimi i këtyre zonave dhe mundësitë gjeneruese të të ardhurave për përmirësim të qëndrueshëm janë të mira. Përfshirja e FSHZH-së mund të përdorë burimet e saj intelektuale dhe financiare për të përmirësuar konservimin dhe menaxhimin. Një situatë e favorshme për të gjithë.
5. **VKM nr. 399, datë 13.5.2020 - kufijtë e parkut arkeologjik të Durrësit** - ky vendim është kritik pasi qartëson parkun arkeologjik brenda Zonës A. Kjo është e rëndësishme pasi i jep rëndësi më të madhe Zonës A dhe mund të përdoret si një zonë tampon nëse MK-ja dëshiron të sigurojë nominimin e Amfiteatrit si Trashëgimi Botërore. Kjo kërkohet nga Udhëzimet Operative të ËHC-së. Sidoqoftë, kjo VKM shtesë e bën më kompleks ndryshimin e kufijve të Zonës A.
6. **Udhëzimi nr. 583, datë 14.10.2019 -** Për miratimin e kritereve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi lejon fondacionet private të administrojnë pasuritë publike të trashëgimisë kulturore brenda kufijve.
7. **Urdhri i Ministrisë së Kulturës nr. 216, datë 19.04.2016** - Për miratimin e formularit të aplikimit për lëshimin e lejes për ndërhyrje në Zonën Arkeologjike A dhe B për qytetarët dhe qytetin. Kjo është kritike sikurse ishte vendosja e kufijve fillestarë të këtyre zonave. Kjo vendosi një precedent për këto zona dhe filloi zbatimin; megjithëse, zbatimi mbetet i diskutueshëm.
8. **Ligji Nr. 9482 datë 03.04.2006,** për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, i ndryshuar. Kjo është e rëndësishme pasi lidhet me shkeljet brenda siteve arkeologjike.
9. **VKM Nr. 280/2015, e ndryshuar,** sepse përcakton në mënyrë konkrete strukturat që nuk mund të legalizohen, dhe që cenojnë ose shkelin trashëgiminë kulturore.
10. **VKM Nr. 792, datë 07.10.2020** "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të veçanta të licencimit, dokumenteve shoqërues, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin dhe heqjen e licencave, si dhe detyrimet vjetore të licencës për ndërhyrjet në pasuritë materiale kulturore "
11. **VKM Nr. 793** "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të veçanta të licencimit, dokumenteve shoqërues, nënkategorive të licencave, procedurave për shqyrtimin dhe heqjen e licencës për veprimtari arkeologjike dhe nënujore ".
12. **Ligj nr.152/2015** " Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"

Udhëzues për ruajtjen

Plani urbanistik i qytetit të Durrësit, Shtojca III, përfshin Udhëzuesin për Ruajtjen, i cili është një dokument tregues, jo-detyrues i krijuar për të ruajtur identitetin urban të lagjeve të ndryshme (Ruajtja e Identitetit Urban). Lidhur me pjesën e parë (III-1): Nëse ka një mospërputhje midis Udhëzuesit Bashkiak të Ruajtjes dhe VKM të Zonave arkeologjike A dhe B, çështja kryesore **lidhet me shtesat, kate shtesë, në objektet private (të shpallura ose jo)në qendër të qytetit. Udhëzuesi Bashkiak për Ruajtjen e Durrësit aktualisht lejon ndërtimin e një kati shtesë, ndërsa VKM e zonës A nuk shprehet takstativisht për këtë lloj ndërhyrje**. Ajo kërkon që volumi i ndërtesës të mos cënojë pasuritë kulturore të nëntokës,. dhe në çdo rast projekti, duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga KKTKM-ja;

Gjithashtu, ndërtesat në një mjedis urban me elemente kontribuuese për përcaktimin e karakterit të historisë, kulturës dhe të rëndësisë artistike nuk janë përfshirë në listën e pasurive kulturore. Zbatimi i kësaj PM-je dhe rishikimet në Udhëzuesit e Ruajtjes duhet të bëhen në përputhje me dokumentet e planifikimit të një rëndësie më të lartë, planifikimin urban dhe planin e përgjithshëm vendor.

Elementet teknike të cilat duhet të mbrohen përfshijnë:

- Vëllimin e ndërtesës (gjeometria e strukturës, shtrirja e fasadave, gjerësia, lartësitë e kufizuara në 1 nivel)
- Fasadat dhe çarjet e tyre (përqindja e hapjeve, materialet dhe veçoritë)
- Trajtimin e kulmit (pjerrësia, materialet dhe ulluqet)

Udhëzuesi i Ruajtjes ofron informacion për materialet që do të përdoren, ngjyrat, shenjat (reklama të ndaluara). Rekomandohen gjerësitë e rrugëve, si dhe lloji e mbjelljeve (bimëve). Udhëzuesi i Ruajtjes gjithashtu ofron rekomandime në lidhje me ndërtesat e identifikuara historikisht ose të rëndësishme artistikisht (Ruajtja e Ndërtesave të Rëndësishme Historikisht dhe/ose Artistikisht), të renditura në PM (III-2). Por, rregullat përsëri duhet të plotësojnë ato të PM-së. Përveç kësaj, për rekomandimet e Pjesës III-1, rekomandimet e mëposhtme duhet të merren parasysh në lidhje me strukturën e ndërtuar dhe dekorin.

Funksioni i ndërtesës duhet t'i përshtatet strukturës së saj. Çdo modifikim duhet të ketë të bëjë me mbrojtjen strukturore të ndërtesës. Në rast se dekori do të ruhet dhe kërkon ruajtjen e strukturës, zëvendësimi me elemente moderne prej betoni ose tullash nuk lejohet, përveç në rastin e një dëmtimi të rëndësishëm të pariparueshëm. Materialet e përdorura/ripërdorura duhet të jenë në përputhje me ato të ndërtesës ekzistuese ose të tipit tradicional në rast të një zëvendësimi. Vëmendje u kushtohet shkallëve kur ato janë elemente unike dekorative. Me pas ka të njëjtat kufizime si në III-1 në lidhje me muret e jashtme të ndërtesës, fasadat dhe çatitë.

Udhëzuesi i Ruajtjes duhet të konsiderohet, duke supozuar që KKTKM do të shprehet për të gjitha projektet që zhvillohen në zonat e mbrojtura A dhe B. Ndërsa formulimi i rregullave të qarta për vlerësimin e projektit është thelbësor. Ky dokument ka të bëjë vetëm me ndërtesa me vlera të spikatura (të shpallura dhe të pashpallura). Sidoqoftë, sipas rregullave të zonave arkeologjike, KKTKM gjithashtu duhet të japë sugjerime për të gjitha projektet e tjera të vendosura në zonat arkeologjike "A" dhe "B "

Është shumë e nevojshme të saktësohet që rregullat e ruajtjes së strukturave ose kërkesat e materialeve, që nuk i pengojnë pronarët të kryejnë punime duke mos lejuar përkeqësimin e pronës së tyre. Kjo neglizhencë do të çonte në një situatë ku pronari mund të kërkojë prishjen e objektit. Zbatimi i një politike efektive dhe në mënyrë të arsyeshme kërkon përfshirjen dhe konsultimin e vazhdueshëm të pronarëve privatë .

C.8.2 Kuadri institucional dhe administrativ

Ka një numër entitetesh publike që janë përgjegjëse për aspektet e ndryshme të trashëgimisë kulturore në Durrës. Më poshtë trajtohen entitetet publike dhe fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore. Një përshkrim më i detajuar gjendet në Aneks.

- **Ministria e Kulturës** është institucioni përgjegjës për trashëgiminë kulturore kombëtare, ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të pasurive kulturore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Këto funksione i ushtron vetë ose nëpërmjet institucioneve të specializuara të fushës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera shtetërore dhe privatët, në bazë të marrëveshjeve apo formave të bashkëpunimit, të parashikuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore
    - Aktive në Durrës me një sërë projektesh për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore;
    - Aktive në Durrës me një numër partneritetesh dhe promovimin e formave të reja të menaxhimit për trashëgiminë kulturore, përfshirë promovimin e planeve të menaxhimit.
    - Punë efektive me projekte të ndryshme të BE-së dhe financime në lidhje me sitet e trashëgimisë kulturore të dëmtuara nga tërmeti 2019.
- **Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), është organ kolegjial vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.,**
    - Në cilësinë e kreut të Këshillit është Ministri i Kulturës
    - Centralizon dhe kordinon aktivitetet në lidhje me trashëgiminë kulturore
    - Funksionon në nivel kombëtar si organ vendimmarrës në lidhje me kërkesat për ndërhyrje mbi pasuritë kulturore të luajtshme e të paluajtshme; pasuritë arkeologjike. dhe jep mendime për të gjitha projektet e Shqipërisë në lidhje me arkeologjinë; Ekziston rreziku i mbingarkesës ose ngërçeve të komisionit.
    - Pagesa, në lidhje me takimet, është jashtëzakonisht e ulët dhe nuk mbulon shpenzimet.
- **Qendra Muzeore Durrës (QMD)** është institucion varësie i Ministrisë së Kulturës, përgjegjës për Muzeun dhe Parkun Arkeologjik.
    - Personeli i përbërë nga profesionistë të aftë dhe të përkushtuar për muzetë, por jo menaxherë sitesh ose arkeologë.
    - Burime jashtëzakonisht të kufizuara për sa i përket financimit dhe kapacitetit të personelit që ndikojnë dhe kufizojnë iniciativa të tjera të denja, siç janë koncertet brenda Amfiteatrit.
    - Fryma sipërmarrëse duket se mungon, duke pasur parasysh një muze me shikueshmëri të lartë me hapësirë të tepërt, të nënvlerësuar si dhe duke pasur parasysh mungesën e kapacitetit dhe burimeve.
    - Probleme të vazhdueshme me Institutin e Arkeologjisë, në lidhje me ndërtesën e përbashkët (godina e muzeut Arkeologjik) pa ndarje të qarta dhe numrin e madh të objekteve në depo, kjo edhe për arsyen pasi institucionet raportojnë në ministri të ndryshme.
    - Vende të interpretuara brenda Amfiteatrit, por këto mbetën të vogla dhe të kufizuara pa kapacitet të mjaftueshëm promovimi ose zgjerimi.
    - Mirëmbajtësit aktualisht punojnë në sit me kapacitet dhe burime të pamjaftueshme.

- **Bashkia e Durrësit** është përgjegjëse për territorin e bashkisë se saj. Bashkëpunon me MK në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes të pasurive kulturore , sipas parashikime ve të ligjit
    - Ndryshimi i shpeshtë i situatës brenda strukturës së pushtetit të zyrave bashkiake çon në ndërprerje të komunikimit me entitetet e tjera.
    - Disa mospërputhje midis Udhëzimeve për Ruajtjen dhe VKM-së së zonave arkeologjike A dhe B.
    - Mosmarrëveshje me Institutin e Arkeologjisë pasi Bashkia në përgjithësi është pro zhvillimit, dhe Instituti kryen gërmime të shpejta shpëtimi.
    - Duke pasur parasysh presionet e zhvillimit, gërmimet e shpëtimit kryhen nga subjekte të licencuar, ose specialist arkeolog nga Drejtoria e Shpëtimit Arkeologjik(DSHA) në IKTK. Institutin e Arkeologjisë përfshihet vetëm në zona më të rëndësishme, pa dyshim zonën A. kur vlerësohet me vendim të KKTKM
    - Mosmarrëveshje me Qendrën Muzeore Durrës, pasi Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë instaluar infrastrukturën e hapësirës publike në park.
    - Mosmarrëveshje rreth zonave arkeologjike pasi hapësira e hapur përdoret si park ose u jepet me qira subjekteve private për kafene ose shërbim të tjera.
    - Më pak të prirur për mbrojtje arkeologjike, duke favorizuar zhvillimin, dhe për të dëgjuar arkeologët.
- **Instituti i Arkeologjisë është entiteti kryesor që lidhet me gërmimet arkeologjike në Durrës**
    - Instituti varet nga Akademinë e Studimeve Albanologjike, i cili është institucion varësie i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.
    - Partneritete ndërkombëtare me misione të shumta.
    - Mosmarrëveshje të mundshme me Qendrën Muzeore Durrës, duke pasur parasysh burime të kufizuara, hapësirë dhe zona të përgjegjësisë të mbivendosura.
    - Merret edhe me arkeologjinë e shpëtimit në zonën A ose në raste të tjera me rëndësi.
    - Burime dhe kapacitete të kufizuara, me arkeologë shumë të aftë, por jo menaxherë, mungesa e financave dhe mungesa e personelit krijojnë probleme
- **Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kombëtare Tiranë (DRTK),** institucion rajonal i specializuara, në varësi të Ministrisë së Kulturës, përgjegjës për kontrollin e territorit në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër, lidhur me trashëgiminë kulturore
    - Kontrollon zyrtarisht zonën e mbrojtur A dhe B dhe territore të tjera të pambrojtura
    - Transferimi i fundit i këtij institucioni nga Durrësi në Tiranë e ka dobësuar ndikimin e saj.

Analizë - Ndërkohë, ka shumë subjekte të tjera të përfshira në trashëgiminë kulturore të Durrësit; të lartpërmendurat janë aktorët kryesorë[13]. Këto subjekte janë të gjitha aktive në qytet dhe kanë kapacitete unike ndryshe nga të tjerat, por kanë edhe limite.

Mandate të ndryshme - çdo institucion ka misione dhe fusha të ndryshme të përgjegjësisë. Ministria e Kulturës ushtron funksionet e saj në fushën e trashëgimisë kulturore në nivel kombëtar. ndërsa Instituti i Arkeologjisë është përqendruar ngushtësisht në arkeologji dhe qëllimet e tij janë të lidhura

[13] Këto njësi të tjera gjithashtu kanë një ndikim në trashëgiminë kulturore të Durrësit, por nuk janë aktorë thelbësorë për \ zonat arkeologjike. Ato përshkruhen në detaje në Aneks.

ngushtësisht me shkencën dhe konservimin. Ekzistojnë mekanizma për bashkëpunim, por kryesisht ndonjëherë joefektive në nivelin e një siti të vetëm arkeologjik.

Burime të kufizuara - Pesë nga entitetet e përmendura kanë nevojë për burime financiare dhe profesionale. Megjithatë, shumica e tyre nuk lejohen të përfitojnë nga pasuritë e tyre të paçmueshme, si për shkak të kufizimit të ligjeve, ashtu edhe për shkak të mungesës së njohurive, d.m.th., Muzeu di të shfaqë dhe interpretojë objekte kulturore, por nuk ka domosdoshmërisht aftësinë ose përvojën për të menaxhuar "fitime" apo "të ardhura" nga një aktivitet privat siç është një kafene apo librari. Muzeu gjithashtu nuk ka përvojë në menaxhimin e eventeve më të mëdha jo-akademike ose me organizimin e vazhdueshëm të ekspozitave[14] për të tërhequr vizita të përsëritura. Kjo është e rëndësishme të njihet pasi bizneset e vogla të brendshme, eventet dhe ekspozitat e veçanta gjenerojnë të ardhura (jo fitim) që kontribuojnë në qëndrueshmërinë e aktiviteteve të tjera jo-fitimprurëse. Ligji aktual nuk lejon subjekte të tilla si muzeu të kryejnë aktivitete të tilla të ngjashme me biznesin; prandaj, personeli i muzeut nuk është, as i përgatitur dhe as përfshijnë aktivitete te tilla brenda përgjegjësive të tyre. Megjithatë, këto janë aktivitetet kryesore për financimin e mungesave të buxhetit për muzetë në të gjithë botën.

Këto kufizime janë të kuptueshme duke pasur parasysh që çdo njësi ekonomike po operon brenda kufijve të saj specifikë. Nevojitet një organizatë menaxhimi holistik që përfiton nga çdo njësi ekonomike ndërsa përfshin ndryshimet e tyre, që kombinon dhe tërheq nga aftësitë, kapacitetet dhe pasuritë e secilit entitet duke krijuar lidhje për të përmirësuar menaxhimin në një nivel lokal.

Qendra Muzeore Durrës

Sipas nenit 212 të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, nr. 17/2018, Qendra Muzeore Durrës është një institucion me statusin "muze kombëtar", në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, i vendosur në qytetin e Durrësit, që administron Muzeun Kombëtar të Arkeologjisë dhe Parkun Arkeologjik Durrës.

Neni 212, i cili i referohet Muzeut Kombëtar të Arkeologjisë dhe Parkut Arkeologjik Durrës, përcakton se:

- funksioni themelor i Qendrës Muzeore të Durrësit është ruajtja, mbrojtja, hulumtimi, administrimi dhe ekspozimi i trashëgimisë kulturore në Muzeun Kombëtar të Arkeologjisë dhe Parkun Arkeologjik në Durrës;
- Parku Arkeologjik Durrës është një territor i përcaktuar qartë në qytetin e Durrësit, në të cilin përfshihen prova të rëndësishme arkeologjike dhe prani të provave kulturore, historike, arkitektonike, urbanistike dhe peizazhit kulturor të organizuara me elemente të një muzeu natyror;
- Muzeu Kombëtar i Arkeologjisë ka për detyrë të përmirësojë dhe shtojë më tej ekspozitën nëpërmjet kërkimit të fondit të tij të pasur arkeologjik dhe muzeal;
- QMD-ja ka për detyrë të ekspozojë dhe interpretojë në mënyrë aktive njohuritë në lidhje me artefaktet e periudhave ilire, antike greke, romake dhe mesjetare të zbuluara në gërmimet arkeologjike, kryesisht në rajonin e Durrësit, por jo vetëm. Organizon ekspozita dhe evente promovuese me çdo metodë të mundshme të komunikimit publik;

[14] Ministrisë së Kulturës, miraton të gjitha ekspozitat, kjo i heq kopetencat administratës të muzeut.

- Muzeu Arkeologjik i Durrësit, në zbatim të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Qendra Muzeore është institucioni administrues, i cili administron Muzeun Arkeologjik Durrës dhe Parkun Arkeologjik.

Është e rëndësishme të vërehet se Instituti i Arkeologjisë zë disa hapësira në Muzeun Kombëtar të Arkeologjisë, të cilat mund të lirohen për të marrë funksione të tjera

C.8.3 Statusi i Trashëgimisë Botërore të Amfiteatrit

Është synimi i Ministrisë së Kulturës që të përfshijë Amfiteatrin e Durrësit në Listën e Trashëgimisë Botërore. Për fat të mirë, Amfiteatri është aktualisht në Tentativ Listë.

Fatkeqësisht, amfiteatri ka qenë i nominuar në të kaluarën, por i refuzuar. Në vitin 1991, në sesionin e 15-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore (CONF 002),12 u dha vendimi i mëposhtëm (origjinal në frëngjisht)13. Amfiteatrit i mungonin vlerat e nevojshme të spikatura universale. Ekziston një problem me riemërtimin pasi refuzohet, një pronë nuk mund të emërohet. Por ky rregull u vu në fuqi pas refuzimit të amfiteatrit.

Figurë 48 – Amfiteatri i Durrësit (Shqipëri) i pa nominuar (Vendimet e Komitetit të Trashëgimisë Botërore, 1991)

C.9 Pikat e forta, Pikat e dobëta, Kërcënimet dhe Mundësitë (ANALIZA SËOT)

Pikat e forta: Mbi aspektet e TK-së: • Vlera e burimeve të trashëgimisë kulturore duke filluar nga shekulli 7-të p.e.s. • Site arkeologjike në qendër të qytetit • Rëndësia historike e Durrësit si fillimi i Via Egnatias që lidhte Romën me Bizantin dhe perëndimin me lindjen • Amfiteatri Romak në Listën e Provës të Trashëgimisë Botërore, vendndodhja qendrore • Muzeu Arkeologjik i Durrësit i cili përmban një koleksion të pasur nga periudhat e lashta Greke, Romake dhe Mesjetare • Arkeologjia nënujore • UNOPS, EU, AAFCP, projekte të trashëgimisë kulturore në proces Mbi aspekte të lidhura me turizmin • Afërsia me kryeqytetin, Tiranën dhe aeroportin ndërkombëtar • Porti kryesor i Shqipërisë me lidhje ndërkombëtare të stabilizuara • Mundësia për restorante të mira, hotele, ambiente akomodimi • Turizmi rajonal që është ndikuar më pak nga pandemia globale • Klima e ngrohtë me diell, shëtitorja e re në bregdet • Kosto e ulët e punës në krahasim me vendet e tjera mesdhetare	**Pikat e dobëta**: Mbi aspektet e TK-së: • **Trashëgimia e ndërtuar e pa zbuluar nga zhvillimi i papërshtatshëm urban.** • Prezantimi dhe interpretimi jo i përshtatshëm i siteve të trashëgimisë kulturore, veçanërisht i Amfiteatrit, Termat Romake dhe Forumi Bizantin • Vizita të pakta dhe nënvlerësimi i vendeve të trashëgimisë kulturore • Nuk ka lidhje të lehta urbane midis pasurive kulturore, hapësirave të hapura të gjelbra dhe bregdetit dhe sheshit kryesor të sapo rinovuar • Niveli i ulët i përfshirjes së institucioneve arsimore në sitet e trashëgimisë kulturor • Interesi/pjesëmarrja e ulët e banorëve të Durrësit në aktivitetet kulturore • **Mungesa e fondeve financiare për të mbështetur ruajtjen** Mbi aspekte të lidhura me turizmin • Mbizotërimi i turizmit masiv të diellit, detit dhe rërës • Varësia e lartë nga turizmi rajonal • Reputacioni i dobët i Shqipërisë si një destinacion turistik • Mungesa e mallrave dhe zanateve me cilësi autentike të cilat kufizojnë përfitimet ekonomike turistike • Mungesa e akomodimit të specializuar • Ndikimi i ulët aktual shoqëror dhe ekonomik i turizmit kulturor • Mungesa e një spektri të gjerë të ofertave nga hotelet
Kërcënimet: Aspektet e TK: • Zhvillim i pakontrolluar Mbi aspekte të lidhura me turizmin • Rritja e konkurrencës së turizmit nga vendet e afërta të Mesdheut • Shkalla e rritjes së turizmit e zvogëluar nga kapaciteti i akomodimit • Rritja e vazhdueshme e turizmit masiv të detit pengon rritjen e turizmit kulturor • Transporti • Pasiguria në lidhje me shërimin nga COVID-19-a	**Mundësitë**: • Rritja e nivelit të interesit institucional dhe shoqëror ndaj trashëgimisë kulturore • Identiteti lidh historinë e pasur, trashëgiminë kulturore dhe Via Egnatian Mbi aspekte të lidhura me turizmin • Ndërtimi i trenit me shpejtësi të lartë nga Tirana dhe aeroporti ndërkombëtar • Zbatimi i TID-it që synon të përmirësojë kontekstin më të gjerë të turizmit • Parashikimi afatmesëm dhe afatgjatë i rritjes së turizmit ndërkombëtar • Shtimi i digjitalizimit për të përdorur shërbime digjitale në vend dhe në internet • Pritshmëria për rritje të ekonomisë kombëtare • Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit, e cila parashikon zhvillimin e produktit tematik turistik • Faza e hyrjes në BE e cila do të siguronte akses në Fondet e Kohezionit të BE-së. • Hekurudha e re që do të lidh Durrësin me Aeroportin Ndërkombëtar dhe Tiranën

C.10 Përmbledhje të çështjeve që do të trajtohen

1. **Konfliktet janë duke u rritur midis presioneve të zhvillimit, mbrojtjes ruajtjes dhe hulumtimit të trashëgimisë arkeologjike/kulturore.**
   Gjatë inspektimit të qytetit u evidentua se qyteti po rritet dhe po zhvillohet me shpejtësi, dhe kjo krijon konflikte midis zhvilluesve dhe atyre që dëshirojnë të mbrojnë trashëgiminë kulturore. Kjo ishte gjithashtu e dukshme nga përmirësimet e mëdha në infrastrukturën urbane përgjatë bregdetit dhe sheshit kryesor. Kjo rritje është trajtuar më vonë në këtë raport në seksionin për zbulimin dhe dokumentacionin e karakteristikave të ndërtesave.

   Zgjidhja: hartimi i PM-së do të trajtojë këtë konflikt; PM-ja do të duhet të integrohet në planin e ardhshëm të miratuar nga Bashkia. Duhet të ketë gjithashtu një iniciativë për ndërtimin e kapaciteteve në nivelin vendor për të respektuar burimet arkeologjike dhe kulturore si dhe respektimin e ligjit. Pronësia, veçanërisht për objektet që kanë statusin e pasurisë kulturore ose që do të kenë këtë status më vonë, duhet të verifikohet nga institucionet lokale.

2. **Një rritje në çmimet e tokës dhe nevoja për ndërtesa që përmbushin kushtin antisizmik kërkojnë ndërtimin e themeleve më të thella të cilat ndikojnë në arkeologjinë nën tokë.**
   Nevoja për të kufizuar ndërtimin më të thellë nën tokë ishte e dukshme nga takimet e palëve të interesuara, me shumicën e profesionistëve të cilët ranë dakord se rregulloret duhet të forcohen dhe të respektohen, në lidhje me ndërtimet e reja/rindërtimet në zonat A dhe B. Kjo u përsërit gjatë gjithë konsultimeve të palëve të interesuara që gjurma, lartësia, dhe lloji i ndërtimit në këto zona duhet të mbetet i njëjtë, duke parandaluar kështu themelet më të thella.

3. **Mungesa e një strategjie të koordinuar për menaxhimin e turizmit në sitet e trashëgimisë kulturore në të gjithë qytetin (p.sh, parkimi, informacioni, objektet).**
   Kjo ishte e qartë nga angazhimi i palëve të interesit dhe inspektimi i siteve të ndryshme të trashëgimisë kulturore. Shumica e vendeve ishin mbyllur, duke përfshirë Forumin Bizantin, Termat Romake, Hamamin dhe Vilën e Mbretit Zog. Gjatë vizitës në Muze, u pyet se si ishin këto vizita, dhe përgjigja ishte që kuratori nga muzeu duhet t'i hapte ato, por kjo do të kërkonte mbylljen e muzeut. Përveç kësaj, kishte pak panele didaktike dhe pak ose aspak informacione në lidhje me sitet historike, përfshirë kullën Veneciane.

   Zgjidhja: PM-ja do të përfshijë një vizion udhëzues dhe elemente të qeverisjes, përfshirë komunikimin dhe koordinimin ndërmjet agjencive për të menaxhuar më mirë turistët, veçanërisht në sitet e trashëgimisë kulturore. Lëvizshmëria, përfshirë parkimin, do të trajtohet në projektin AADF- TID.

4. **Planifikim dhe bashkëpunim i pamjaftueshëm midis agjencive për menaxhimin e rrezikut (p.sh. tërmete, përmbytje). Ndikimet e mundshme negative të projekteve dhe aktiviteteve të rindërtimit pas tërmetit në sitet e trashëgimisë kulturore.**
   Kjo ishte e dukshme duke pasur parasysh dëmtimet nga tërmeti i vitit 2019. Edhe pse jashtë qëllimit të këtij PM , në këtë raport është përfshirë një pjesë e shkurtër për mënyrën e lidhjes me burimet kulturore.

5. **Pjesa më e madhe e të kaluarës së qytetit është zbuluar nëpërmjet gërmimeve të shpëtimit para ndërtimeve të reja, duke kufizuar mundësitë për ruajtjen në site të rrënojave dhe ruajtjen e objekteve.**
   Kjo u diskutua gjithashtu gjatë konsultimeve me palët e interesit dhe brenda takimeve të grupit dhe do të trajtohet më hollësisht në vijim .

   Zgjidhja: Një nga projektet e propozuara afatgjata do të jetë krijimi dhe financimi më i fortë i Institutit të Arkeologjisë për t'u bërë më proaktiv në gërmime arkeologjike të planifikuara, sesa reaktiv për gërmimet e shpëtimit. Kjo do të përfshihet në PM. Gjithashtu për t'u përfshirë IKTK-ja e cila duhet të ketë një rol më proaktiv së bashku me Institutin e Arkeologjisë.

6. **Amfiteatri është i ekspozuar vetëm pjesërisht dhe disa pjesë mbeten nën banesa të fillim-shekullit 20-të .**

   Kjo ishte e qartë edhe para vizitës. Amfiteatri është një burim i pasur i historisë ende të pazbuluar dhe duhet të zhvillohet një program i qartë për gërmimet e vazhdueshme, të kontrolluara dhe të programuara, së bashku me ripërdorimin e këtij monumenti antik. Ndërsa disa nga grupet e interesit shprehën shqetësim, grupi i punës nuk mendon se gërmimet e vazhdueshme dhe përdorimi i tij përjashtohen reciprokisht. Përkundrazi, gërmimet mund të jenë pjesë e përvojës së vizitorëve kur ata kalojnë në Amfiteatër për evente kulturore.

   Zgjidhja: një ToR-s specifik dhe projekti pasues për të planifikuar gërmimet në të ardhmen, shpronësimin e banesave sipër Amfiteatrit dhe heqjen e pronave së parëndësishme. PM-ja duhet të sigurojë që vlerat e çdo prone apo ndërtese të analizohen plotësisht para një veprimi. Ky ToR-s gjithashtu do të propozojë përdorimin e Amfiteatrit në përputhje me statusin e tij si monument.

7. **Cilësi e dobët e ruajtjes së trashëgimisë më të vonë urbane.**

   Inspektimi i trashëgimisë më të re të fillimit dhe mesit të shekullit të 20-të krijoi një bazë për këtë shqetësim. Ky lloj dhe mosha e ndërtimit dukshëm nuk vlerësohen si pasuritë e tjera arkeologjike. Ky raport e trajton këtë shqetësim në një pjesë të titulluar Mbrojtja dhe Promovimi i Trashëgimisë së Shekullit të 20-të.

   Zgjidhja: Mbrojtja për trashëgiminë më të fundit duhet të përmirësohet nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve por edhe vlerësimit ndërmjet zhvilluesve dhe publikut të gjerë. Kjo, gjithashtu, duhet të ndodhë nëpërmjet forcimit të ligjeve dhe një inventari të përmirësuar.

8. **Mangësitë në kërkimet për disa periudha dhe pengesat për të aksesuar disa kërkime.**

   Kjo u diskutua gjatë konsultimeve me palët e interesit dhe u pranua gjerësisht. Një projekt i propozuar është të specializohet Instituti i Arkeologjisë në këtë drejtim.

   Zgjidhja: Instituti i arkeologjisë si një strategji brenda PM-së.

9. **Trashëgimia kulturore është një përbërës i vogël i ofertës turistike të qytetit.**

   Është absolutisht e qartë se Durrësi është një destinacion turistik dielli dhe rëre me rezidenca të dyta banimi për njerëzit. Sidoqoftë, duke pasur parasysh trashëgiminë e pasur arkeologjike dhe kulturore, kjo mund të shihet si një mundësi për të nxitur zhvillimin e ardhshëm shoqëror dhe ekonomik.

   Zgjidhja: Plani i Veprimit do të ketë një komponent specifik marketingu që do të nxjerrë në pah trashëgiminë kulturore si një burim unik dhe faktor diferencues për Durrësin.

10. **Muzeu nuk e arrin potencialin e tij të plotë dhe aktualisht përfshin ekspozita vetëm në njërin nga tre katet e tij, dhe ekspozitat mbulojnë nga periudha neolitike deri në periudhën romake.**

    Zonat e lira të muzeut ishin në kontrast të fortë me kopshtin jashtë, plot thesare arkeologjike. Ky kapacitet në hapësira duhet të shfrytëzohet më mirë. Prandaj, një nga projektet e propozuara është shfrytëzimi më i mirë i kësaj hapësire.

    Propozimi: Brenda PM-së do të ketë një strategji për përditësimin e menaxhimit të muzeut dhe gjithashtu një ToR-s specifik për një projekt të ardhshëm muzeu për të shfrytëzuar plotësisht objektin dhe territorin rreth tij.

11. **Shumë pak site të hapura për turistët të cilat nuk janë të lidhura mirë me njëra-tjetrën dhe nuk paraqiten si një atraksion i vetëm, i denjë për përcaktimin e Parkut Arkeologjik.**

    Inspektimi zbuloi se, për fat të keq, shumica e atraksioneve kulturore janë të mbyllura, duke përfshirë Hamamin Mesjetar, Forumin Bizantin dhe Termat Romake. Site të tjera janë të paarritshme, përfshirë kështjellën e sipërme, i cili ofron pamje mbresëlënëse të qytetit dhe Vilën e Mbretit Zog. Kjo mund të jetë edhe një mundësi për të zgjeruar ofertat kulturore të qytetit.

Zgjidhja: Projekte specifike nëpërmjet ToR-ve do të përshkruhen në këtë projekt për të hapur, gërmuar, mbrojtur dhe përmirësuar interpretimin e këtyre siteve. Kjo mund të përfshijë gërmime dhe lidhje të zgjeruara midis këtyre siteve të izoluara.

12. **Prezantimi dhe interpretimi në monumente dhe site të ndryshme janë me cilësi të ndryshme dhe pjesërisht mungojnë.**

    Nuk ka didaktikë publike, ture të organizuara, apo interpretime të trashëgimisë kulturore të Durrësit. Kjo duhet të korrigjohet dhe një projekt i propozuar do të zhvillojë ture në pasuritë arkeologjike të qytetit.

    Zgjidhja: Duhet të përshkruhet një ToR-s që përmirëson këtë interpretim dhe prezantim në një standard uniform dhe me cilësi të lartë.

13. **Ekzistojnë studime të ndryshme të zonave arkeologjike në platforma të ndryshme GIS, të palidhura ose të pa integruara me sistemet GIS të përdorura nga Bashkia për planifikimin e territorit dhe menaxhimit urban.**

    Hulumtimet e GIS-it zbuluan se nuk ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me burimet arkeologjike nga burimet zyrtare. Misionet arkeologjike me sa duket nuk janë të gatshme të ndajnë të dhënat e tyre dhe të dhëna të tjera janë të vjetruara. Bashkia vuri në dispozicion GIS-in e saj por të dhënat nuk kishin kufij të plotë dhe përshkrime të pasurive arkeologjike. Një analizë e plotë e sistemeve GPS përfshihet në këtë raport.

    Zgjidhja: Misionet arkeologjike duhet të ndajnë të dhënat e tyre me sitin, përfshirë të drejtat e autorit që do të vihen në dispozicion për projektet e trashëgimisë kulturore. Mungesa e të dhënave e vonoi këtë projekt dhe ishte e qartë se bashkia dhe shteti nuk kanë informacion të përditësuar. Për më tepër, forcimi i kapaciteteve të bashkisë në përdorimin e GIS-it duhet të përmirësohet.

14. **Mungesa e qartësisë në lidhje me pronësinë e disa ndërtesave në zonat qendrore. Një ligj që lejon legalizimin e ndërtimeve të paligjshme në Zonën B**

    Tema e pronësisë është ende nën hulumtim. Gjatë takimit me bashkinë, ekipi i punës kërkoi një hartë të ndërtimeve të paligjshme, por ky hartëzim nuk është kryer ende. Grupi hetoi disa ndërtime informale dhe të dyshimta, të paligjshme, brenda dhe përreth citadelës. Këto zënie bllokojë hyrjen midis pjesëve të qytetit dhe kështu pengojnë lëvizjen e këmbësorëve. Nevojiten më shumë punë në lidhje me pronësinë e tokës.

    Zgjidhja: Bashkia dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të udhëzohen për përgatitjen e hartave speciale kadastrale me pronësi të qartë të pasurive të patundshme dhe një hartë të ndërtesave të paligjshme të të gjitha llojeve. PM-ja do të kështillojë, pas hulumtimeve të vazhdueshme, bashkia të forcojë kapacitetin për të parandaluar ndërtimet e paligjshme, veçanërisht, pushtimin e monumenteve dhe prishjen e ndërtimeve të paligjshme edhe në rastet kur cenohet e drejta e kalimit .

15. **Leja e bashkisë së Durrësit për të lejuar pronarët të ndërtojnë një kat shtesë në Rrugën e Tregtarëve (zona e ardhshme TID),jepet pas shqyrtimit/miratimit të projektit në KKTKM.** (*Referuar VKM, nëse....volumi i përgjithshëm i ndërtesave nuk cenon pasuritë kulturore të nëntokës, mbi bazën projekteve të miratuara nga KKTKM-ja).*

16. **Menaxhimi proaktiv i pjesës arkeologjike të Durrësit**

17. **Durrësi është i përshtatshëm për turizëm sezonal masiv (diell dhe rërë).** Aktualisht, kjo tërheq kryesisht turistët e plazhit vendas dhe ata ndërkombëtarë gjatë sezonit të verës.

    Zgjidhja: PM parashikon përdorimin e amfiteatrit si një vend kryesor për eventet muzikore dhe artistike. Një pozicionim i tillë do të lejojë Durrësin të diferencohet nga destinacionet e afërta Mesdhetare.

Ç VLERËSIMI

Ç.1 Parimet e vlerësimit

Për qytetet historike, të tilla si Durrësi, vlerësimi është një propozim i vështirë, pasi ato janë njësi dinamike dhe gjithnjë në ndryshim. *"Qytetet historike janë produkt i proceseve të vazhdueshme të zhvillimit dhe ndryshimit dhe zakonisht kanë një përbërje heterogjene me zona natyrore, urbane dhe rurale me karakter historik dhe jo-historik. Prandaj, tërësia e zonave historike urbane nuk mund të vlerësohet vetëm në lidhje me kornizën e saj arkitektonike, por duhet të marrë në konsideratë kontekstin socio-ekonomik dhe vlerat njerëzore të lidhura me të "*[15].

Durrësi, në tërësi, u vlerësua nëpërmjet parimeve të lartpërmendura dhe katër aspekteve kryesore:

Vlerat *janë thelbësore për të vendosur se çfarë të ruajmë, cilat të mira materiale do të na përfaqësojnë ne dhe të kaluarën tonë për brezat e ardhshëm*[16]. Vlerat gjithashtu u referohen kuptimeve që individë ose grupe njerëzish u japin ndërtesave, siteve arkeologjike, peizazheve dhe shprehjeve jomateriale. Klasifikimet e vlerave përfshijnë ato historike, estetike, sociale, shkencore dhe ekonomike.

Autenticiteti varet nga lloji i trashëgimisë kulturore dhe konteksti i saj kulturor; pronat mund të përmbushin kushtet e autenticitetit nëse vlerat e tyre kulturore shprehen me vërtetësi dhe besueshmëri nëpërmjet një larmie atributesh, përfshirë formën dhe modelin; materialet dhe substancën; përdorimin dhe funksionin; traditat, teknikat dhe sistemet; vendndodhjen dhe kontekstin; gjuhën dhe format e tjera të trashëgimisë jomateriale; shpirtin dhe ndjenjat; dhe faktorë të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm.

Integriteti është një matje e tërësisë dhe paprekshmërisë së trashëgimisë natyrore dhe/ose kulturore dhe atributeve të saj. Prandaj, ekzaminimi i kushteve të integritetit kërkon të vlerësohet shkalla në të cilën prona[17] përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për të shprehur vlerën e saj të jashtëzakonshme universale dhe është me madhësi të përshtatshme për të garantuar përfaqësimin e plotë të karakteristikave dhe proceseve që transmetojnë kuptimin e saj.

Rëndësia është niveli i veçantë i kuptimit që ngre mbi të zakonshmen një gjë që ne duam ta mbajmë dhe t'ua transmetojmë brezave të ardhshëm [18]. Rëndësia është një term kolektiv për shumën e të gjithë vlerave të trashëgimisë që lidhen me një vend, qoftë një ndërtesë, apo një sit arkeologjik, ose një zonë më të gjerë historike, të tillë si një fshat të tërë ose peizazh[19].

---

[15] Jokilehto, 1993
[16] Vlerat dhe Ruajtja e Trashëgimisë, Instituti i Konservimit Geti (*Getty Conservation Institute*), 1997
[17] Udhëzimet Operative të UNESCO -s për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore
[18] Ian Boersma
[19] Trashëgimia angleze

Ç.2 Vlerat

Vlerat janë ato që e bëjnë një vend unik dhe ato që duhet të ruhen. Këto vlera përfaqësohen fizikisht në arkeologji dhe arkitekturë, së bashku me elemente qytetare si parqet dhe hapësirat e hapura. Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në të gjitha format e saj dhe periudhat historike është e rrënjosur në vlerat që i atribuohen trashëgimisë. Aftësia për të njohur këto vlera varet, pjesërisht, nga shkalla e besueshmërisë dhe vërtetësisë së burimeve të informacionit në lidhje me to. Njohja dhe të kuptuarit e këtyre burimeve të informacionit në lidhje me vlerat, karakteristikat origjinale dhe pasuese të trashëgimisë kulturore dhe domethënien e tyre, janë parakusht për vlerësimin e Durrësit. Prandaj, vlerat kulturore, historike, shkencore, estetike, sociale, dhe ekonomike duhet të vlerësohen. Kjo pjesë do të përshkruajë këto vlera dhe do të identifikojë konfliktet që duhen zgjidhur.

Vlerat historike lidhen me të gjithë qendrën urbane të Durrësit. Kjo përfshin sitet e njohura dhe të panjohura arkeologjike, si dhe ndërtesat historike përmbi. Edhe pse gërmimet arkeologjike u përqendruan kryesisht në zonat e Amfiteatrit, Termave Romake dhe Forumit Bizantin, vlera historike qëndron në lidhjen e këtyre dritareve të gërmuara në të kaluarën. Këto zona nuk ishin të izoluara kurrë, por ishin pjesë e një bërthame të gjallë, historike. Vlerat historike lidhen gjithashtu me shtresimin e zonave historike me kalimin e kohës, njëra mbi tjetrën. Ky shtresim është veçanërisht interesant në qytete të tilla si Durrësi që janë banuar vazhdimisht për mijëvjeçarë. Kështu, shtresa historike, si dhe shtresa e gjerë arkeologjike nën të, duhet të mbrohen.

Vlerat shkencore janë në përputhje të ngushtë me vlerat historike lidhur me papërsosmërinë e njohurive për të kaluarën dhe informacione të reja dhe potencialin për përparimin shkencor që sjell çdo zbulim i ri arkeologjik. Këto vlera shkencore kanë informacione në lidhje me të kaluarën që janë të paçmueshme. Për këtë arsye, shtresat/hapësirat me potencial arkeologjik të pa zbuluar, duhet të mbrohen deri në kohën e duhur për zbulim.

Vlerat estetike janë shumë të veçanta. Durrësi zotëron shumë atribute natyrore që do të ngjallnin zilinë e qyteteve të tjera, duke përfshirë një bregdet mbresëlënës me një shëtitore të re, kodra dhe parqe të gjelbra dhe një qendër historike, në një klimë mesdhetare të ngrohtë dhe me diell. Vlerat estetike gjithashtu përfshijnë një pamje të siteve të ekspozuara arkeologjike të tilla si Amfiteatri dhe Termat Romake/Forumi Bizantin dhe fortifikimet. Sidoqoftë, këto atribute janë të shkëputura dhe të rrezikuara.

Vlerat social-kulturore në Shqipëri kanë qenë gjithmonë të forta. Lidhjet familjare dhe farefisnore, miqtë, fqinjët dhe kolegët formojnë këtë shoqëri të fuqishme. Sidoqoftë, është mjedisi fizik që e ushqen dhe lehtëson këtë. Faktorët kryesorë për zhvillimin shoqëror përfshijnë ndjenjën e vendit, mundësitë për aktivitete kolektive dhe modelin që inkurajon ndërveprimin shoqëror. Ndërsa është i fortë në Durrës, ai duhet të përforcohet nëpërmjet lidhjeve dhe prezantimit më të mirë të siteve arkeologjike.

Vlerat ekonomike të Durrësit janë gjithashtu të rëndësishme , kryesisht për shkak të mjedisit natyror të qytetit përgjatë detit, një prirjeje drejt biznesit dhe afërsisë me kryeqytetin, Tiranën dhe aeroportin ndërkombëtar. Turizmi është pjesë e rëndësishme e këtyre vlerave ekonomike, qoftë nga shtëpitë e dyta pranë bregdetit, apo turistët ndërkombëtarë. Vlerat ekonomike të Durrësit janë gjithashtu të lidhura ngushtë me portin si pika kryesore tranzit midis detit dhe tokës dhe hyrja për shumicën e mallrave. Kur këto vlera janë në konflikt, ndodh ndërprerja e mjedisit urban. Ky është procesi që po zhvillohet në Durrës - vlera ekonomike e përfaqësuar në çmimet e tokës dhe presionet reale të zhvillimit aktual kanë një ndikim negativ dhe madje dërrmues mbi vlerat historike, shkencore dhe estetike. Vetëm nëpërmjet vlerësimit dhe ribalancimit, këto konflikte mund të zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe mund të vendosen masat mbrojtëse. Vlerësimi i vlerave trashëgimore formon një bazë

thelbësore për vlerësimin e rëndësisë kulturore dhe vendimmarrjen për të ardhmen e siteve të trashëgimisë.

ASPEKTET	DIMENSIONET				
	Historike	**Shkencore**	**Estetike**	**Sociale**	**Ekonomike**
Forma dhe dizajni	Shtresëzim kompleks i formave të ndryshme dhe pranëvënie e dizenjove - ruajtja e formës Y të qarkullimit dhe orientimit drejt portit	Zbulime të njohura dhe të panjohura shkencore arkeologjike në shtresa dhe në gjirin e portit.	Ndërtime të ulëta me kulla moderne aty-këtu, qytet me reliev të valëzuar, pamje të bllokuara ose në bllokim e sipër.	Ndjesia e vendit, mundësitë për aktivitete kolektive dhe pamje që inkurajojnë ndërveprimin	Shtyrja e ndërtimeve të qytetit drejt detit dhe në lartësi - në kontrast me qendrën historike, shtëpitë e dyta, pamja nga deti
Përdorimi dhe funksioni	Porti dhe kryqëzimi i vendkalimeve tokësore-detare, pikave të transitit të tokës dhe ujit	Porti historik dhe gjiri përmbajnë zbulime nën ujë dhe në breg	Koha e lirë, transporti dominojnë përdorimin dhe funksionin estetik	Shkëmbimi i njerëzve - pushime, biznes, familje	Port kryesor, mallra dhe njerëz, destinacion rajonal turistik, pushime
Vendndodhja dhe Konteksti	Pikënisja e përcaktuar e Via Egnatias, brenda kufijve për një mijëvjeçar, që lidh lindjen dhe perëndimin, Romën dhe Bizantin, tani shtrirja në brendësi në shekullin e 20-të	Zbulimet e njohura dhe të panjohura shkencore arkeologjike në shtresëzimet sipas vendndodhjes, kodrat siguruan hapësirë për nekropolin pasi bujqësia nuk ishte e mundur	Qendra historike, vendet arkeologjike në klimën e ngrohtë mesdhetare /me diell, kodra të gjelbra dhe det i kaltër	Orientuar ndaj detit, i hapur me hyrje të ngushtë pingule që tërhiqet në brendësi	Turizmi është një faktor i rëndësishëm për ekonominë dhe vendndodhja është thelbësore, por pasuritë historike duhet të kontribuojnë
Shpirti dhe ndjenjat	Përmasat njerëzore të ndërtimeve të arkitekturës historike të fillimit të shekullit të 20-të, një përzierje e lindjes dhe perëndimit, e mbushur me xhevahire të lashta arkeologjike, si Amfiteatri, atmosfera e hapur	Muzeu zbulon njohuritë e së kaluarës, frymën e qytetërimeve antike nëpërmjet artefakteve	Vendndodhje e bukur përballë detit, kodra të gjelbra, Rruga Tregtare plot gjallëri, port aktiv	Ka mundësi për ndërveprim shoqëror, megjithatë sitet arkeologjike nuk kontribuojë	Atmosferë çlodhëse pushimesh në bashkëjetesë me portin aktiv, qendër tregtare

Figurë 49 –Nara Grid, dhe skema e vlerësimit bazuar në Dokumentin e Nara-s[20]

[20] Van Balen, Koenraad, Rrjeti Nara (*Nara Grid*), 2008, Buletini APT: Gazeta e Teknologjisë së Ruajtjes

C.3 Rëndësia

Rëndësia e Durrësit bazohet mbi vlerat e tij kulturore, historike, shkencore, ekonomike dhe mbi konsiderimin e autenticitetit dhe integritetit të qytetit. Kjo domethënie përfaqësohet në banimin e vazhdueshëm të qytetit nga shekulli 7-të p.e.s. - shtresë pas shtrese, me mbetje arkeologjike historike të bashkuara me arkitekturën e shekullit të 20-të. Shtresa të shumta historike të qytetit mund të vërehen në një zonë; Kishat mesjetare të përfshira në hapësirat e brendshme të Amfiteatrit Romak të shekullit të 2-të dhe xhamia Fatih e shekullit 16-të që përfshin muret e jashtme të Bazilikës Bizantine të Shekullit 9-të dhe fortifikimet nga periudha të ndryshme. Rëndësia e Durrësit është gjithashtu e pranishme në pozicionin e tij të favorshëm gjeografik në bregdetin e Adriatikut dhe në kryqëzimin e rrugëve tregtare detare dhe tokësore. Duke filluar nga shekulli I-rë p.e.s., Durrësi u bë pikënisja e Via Egnatias e cila ishte vazhdimi i itinerarit nga Roma në Bizant. Kjo ishte rruga e Jul Cezarit, Pompeit, e Mark Antonit dhe Oktavianit kur ndoqën Kasin dhe Brutin. Trashëgimia historike urbane e qytetit, edhe pse vuante nga tërmete të shumta, presione të shpejta zhvillimi të dekadave të fundit dhe izolimi i zonave kryesore arkeologjike, ajo reflekton historinë e tij të gjatë me mbetjet/dëshmi të epokave të ndryshme, të gërshetuara së bashku në një mënyrë unike. Rëndësia e Durrësit vazhdon edhe sot si një destinacion turistik rajonal sikurse dhe porti vazhdon funksionin e tij historik si pika më e rëndësishme e hyrjes për mallrat dhe njerëzit. Sidoqoftë, domethënia e Durrësit nuk pasqyrohet sa duhet sot dhe kjo është forca lëvizëse prapa këtij plani menaxhimi.

D. ASPEKTE TË TJERA TË LIDHURA ME PASURINË

D.1 Zhvillimi social dhe ekonomik

Durrësi ka shumë aspekte të tjera, të tilla si zhvillimi social dhe ekonomik, që duhen përfshirë në PM. Zhvillimi shoqëror dhe ekonomik nuk mund të ndahen nga një plan menaxhimi por mund të përshkruhen veçmas për të nxjerrë në pah rëndësinë e tyre. Siç vlerësohet nga OBT-ja[21], komuniteti mund të ndikohet pozitivisht nga turizmi, nëpërmjet vendeve të punës, aktivitetit ekonomik dhe shërbimeve të përmirësuara shoqërore, dhe, negativisht, për shkak të stresit ose dëmtimit të burimeve lokale dhe vlerave kulturore. Rezultatet e ekuilibruara të këtyre ndikimeve do të sjellin pëlqyeshmërinë lokale ndaj turizmit, i cili është thelbësor për zhvillim të qëndrueshëm. Në raste ekstreme, armiqësia e komunitetit i ka larguar turistët. Veprimet nga industria për të mbajtur një marrëdhënie pozitive midis mikpritësve dhe turistëve mund të parashikojnë dhe parandalojnë incidentet dhe efektet negative. Komponentët e kënaqësisë mbulojnë një varg çështjesh reale dhe të perceptuara përfshirë grumbullimin njerëzor, aksesin në punë, ndarjen e përfitimeve, reagimin ndaj sjelljes turistike, etj.

Ndikimet sociale dhe ekonomike në një komunitet pritës janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme. Mund të ketë sinergji të dobishme ose marrëdhënie të kundërta midis dy fushave ndikimi dhe pikëpamje të ndryshme midis disa grupeve dhe individëve në komunitet lidhur me atë që është pozitive apo negative për komunitetin. Sidoqoftë, ky ndikim nuk mund të diskutohet në mënyrë abstrakte. Zhvillimi shoqëror dhe ekonomik janë në të vërtetë, si një rezultat i procesit të valorizimit, ashtu dhe një parakusht i tij. Një komunitet i pasur dhe i arsimuar lokal do të jetë më i ndjeshëm ndaj valorizimit të trashëgimisë kulturore dhe mund të pranojë shpenzimet për ruajtjen e tij.



Figura 50 – Zhvillimi social dhe ekonomik i komunitetit si një prurje dhe rezultat i valorizimit të siteve të trashëgimisë

Zhvillimi social dhe ekonomik duhet të merren parasysh edhe nga pikëpamja e komunitetit, pasi komuniteti nuk është një entitet i vetëm, por një ansambël i një morie aktorësh, duke përfshirë qytetarë, organizata joqeveritare, operatorë privatë dhe institucione publike, secili i përbërë nga një kaleidoskop grupesh interesi. Në një situatë të tillë, identifikimi dhe përzgjedhja e grupeve kyçe të

[21] OBT (2004). Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm për Destinacionet Turistike: Një Udhëzues. Madrid: Kombet e Bashkuara Organizata Botërore e Turizmit

interesit dhe pritshmërive të tyre janë çështje thelbësore. Këto pritshmëri duhet të kristalizohen në tregues të duhur të performancës, si rezultat i një plani përgjegjësie sociale, për t'u rishikuar në bazë vjetore. Kjo qasje prezantohet më vonë në këtë kapitull.

D.1.1 Zhvillimi shoqëror dhe trashëgimia kulturore

Edukimi, kohezioni dhe zhvillimi gjithëpërfshirës shoqëror përfshijnë një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë, pa u kufizuar, në çrrënjosjen e varfërisë, uljen e pabarazisë, krijimin e vendeve të punës , promovimin familjes dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile. Zhvillimi shoqëror përfshin gjithashtu vëmendjen ndaj të moshuarve, të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Zhvillimi shoqëror ka të bëjë me përmirësimin e mirëqenies së banorëve dhe krijimin e një ndjenje të komunitetit. Historiani i njohur urban Loëenthal deklaroi se "Sa më shumë monumente antike të shkatërrohen, aq më shumë prej nesh ndiejnë uri për një ankorim të qëndrueshëm në kohë dhe hapësirë" (Loëenthal 1985) (f38). "*Përparësia më thelbësore dhe e përhapur e së kaluarës që mbijeton, është ta bësh të tashmen të njohur*". Kjo është lidhja thelbësore midis zhvillimit shoqëror dhe trashëgimisë kulturore dhe konservimit e prezantimit të përmirësuar të saj.. Trashëgimia kulturore e Durrësit në sitet arkeologjike dhe arkitekturën e saj luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin shoqëror pasi këto site u ofrojnë banorëve mundësinë të marrin pjesë në aktivitete dhe të ndërtojnë rrjetet e tyre shoqërore. Aktivitete dhe vende të tilla pasurojnë jetën shoqërore të komunitetit dhe ofrojnë një platformë ndërveprimi.

Mirëqenia e komuniteteve pritëse mund të diskutohet nga disa këndvështrime. UNËTO-ja (op.cit.) na siguron çështje të ndryshme, nga të cilat kemi zgjedhur sa vijon, që janë të rëndësishme për sitet arkeologjike të Durrësit:

- Pëlqyeshmëria lokale ndaj turizmit ;
- Efektet e turizmit në komunitete ;
- Aksesi nga banorët lokalë në pasuritë kulturore (pjesëmarrja e komunitetit)

Për secilën çështje, prezantohen dhe raportohen në tabelën në faqen tjetër një grup i madh i treguesve kryesorë të performancës. Më e rëndësishmja mund të mblidhet në një kartelë të ekuilibruar, të përditësueshme çdo vit, që mund të përdoret për qëllime të përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve.

Treguesi i mirëqenies	Specifikimi/treguesit	Burimi i të dhënave
Çështja: Kënaqësia lokale ndaj turizmit		
Niveli i kënaqësisë së komunitetit	Ndryshimet në nivelin e kënaqësisë mund të jenë një tregues paralajmërues i hershëm i incidenteve të mundshme ose armiqësisë dhe një mjet për të vëzhguar informacionin në lidhje me problemet e reja ose irrituesit përpara se ato të bëhen serioze. Kjo është një masë e drejtpërdrejtë e opinionit aktual dhe është mënyra më e drejtpërdrejtë për të matur opinionin lokal të turizmit dhe efektet e tij.	Pyetësori i komunitetit, i përsëritur çdo vit
Numri i ankesave nga banorët lokal	Për sa i përket reagimit lokal, perceptimi mund të jetë më i rëndësishëm se çdo masë objektive. Monitorimi i ankesave është më pak përfaqësues i të gjitha mendimeve, por mund të jetë një sistem paralajmërues i hershëm për shfaqjen e pakënaqësisë. Mund të ndihmojë në hartimin e çdo pyetësori të përdorur për të matur çështjen në mënyrë më objektive	Autoritetet lokale, nëse pajisen me regjistrin e ankesave
Çështja: Efektet e turizmit në komunitete		
Përfitimet e komunitetit të lidhura me turizmin	– Numri i shërbimeve sociale në dispozicion të komunitetit me turizmin (% që i atribuohen turizmit) – Numri (%) i pjesëmarrësve në zanatet, aftësitë dhe zakonet tradicionale të komunitetit; – % e arkitekturës vernakulare të ruajtur.	Autoritetet lokale Pyetësori i komunitetit, i përsëritur çdo vit

Ndikimet e përgjithshme në jetën e komunitetit	- Numri i turistëve në ditë, në javë, etj; numri për km katrorë; - Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit; -% pjesëmarrje në evente të komunitetit; - Raporti i turistëve me vendasit në evente; - Perceptimi i ndikimeve negative në komunitet; -% e bashkësisë lokale që pajtohet që kultura e tyre lokale, integriteti dhe autenticiteti i saj po ruhen.	Pyetësori i komunitetit, i përsëritur çdo vit
Ndryshimet kulturore	– % e banorëve që ndryshojnë nga profesioni tradicional në turizëm gjatë vitit (eve) të mëparshëm; burra dhe gra; – Numri ose % e banorëve që vazhdojnë me veshjet lokale, zakonet, gjuhën, muzikën, kuzhinën, fenë dhe praktikat kulturore. (p.sh. ndryshimi i numrit të banorëve lokalë që marrin pjesë në evente tradicionale); – Rritja/zvogëlimi i aktiviteteve kulturore ose eventeve tradicionale; – Vlera e kontributit turistik në kulturën lokale (shuma e marrë nga aksesi, shuma e dhurimeve); – % e vendasve që gjejnë mundësi të reja rekreative të lidhura me turizmin	Pyetësori i komunitetit, i përsëritur çdo vit
Çështjet e strehimit	– % e strehimit të përballueshëm për banorët; – Numri i njësive të reja të strehimit dhe % për banorët lokalë	Pyetësori i komunitetit, i përsëritur çdo vit
Demografia e komunitetit	– Numri i banorëve që janë larguar gjatë vitit të kaluar; – Numri i emigrantëve (banorë të përkohshëm ose të rinj) që punojnë në turizëm gjatë vitit të kaluar; – Migrimi neto brenda/jashtë komunitetit (rendit sipas moshës së emigrantëve dhe migrantëve jashtë).	Pyetësori i komunitetit, i përsëritur çdo vit
Çështja: Aksesi nga banorët lokalë në pasuritë kryesore		
Hyrja në sitet e rëndësishme për banorët lokalë	– Hyrja nga vendasit në sitet kryesore (% e sitit me akses të lirë për publikun) – Shpeshtësia e vizitave nga vendasit në sit (et) kryesore, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.	Menaxhimi i sitit
Pengesat ekonomike për aksesin	Kostoja e aksesit e shprehur në orë të pagave lokale	Menaxhimi i sitit përputhet me statistikat zyrtare

Figurë 51 –Treguesit e impaktit shoqëror që do të përdoren për vlerësimin e zhvillimit e tij.

D.1.2 Zhvillimi ekonomik dhe trashëgimia kulturore

Zhvillimi ekonomik dhe ndjeshmëria e menaxhimit të trashëgimisë kulturore bazohen mbi zhvillimin e ekuilibruar të biznesit. Menaxhimi i Muzeut Kombëtar Arkeologjik mund të bëhen në përputhje me parashikimet në ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, nr. 27/2018. Neni 192 parashikon funksionet e muzeve si vijon:

a) ruajtja, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, e cila përfshin veprimtaritë që lidhen me administrimin e koleksioneve, analizën e rrezikut dhe zhvillimin e kapaciteteve për gatishmërinë dhe planet e emergjencës, sigurinë, konservimin parandalues e përmirësues, si dhe restaurimin e objekteve muzeore, për të siguruar integritetin e koleksioneve muzeore;

b) pasurimi i fondit, ekspozimi dhe hulumtimi i koleksioneve, funksione këto që mund të kryhen në bashkëpunim me të tretë, me qëllim përftimin e njohurive të thelluara, reflektimin mbi historinë në një kontekst bashkëkohor, interpretimin, përfaqësimin dhe prezantimin e koleksioneve ndaj publikut;

c) administrimi direkt e indirekt dhe bashkëpunimi me institucione publike ose private, me qëllim krijimin e formave të reja të të ardhurave, burimeve të financimit, për rritjen e shërbimeve ndaj publikut;

ç) edukimi, i cili përfshin edukimin formal e joformal të të mësuarit, zhvillimin dhe transmetimin e programeve edukative dhe pedagogjike nëpërmjet kulturës, rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, nxitjen e krijimtarisë artistike kulturore, në bashkëpunim me institucionet arsimore;

d) evidentimi dhe komunikimi, që përfshin mënyrën aktive të interpretimit e të shpërndarjes së njohurive mbi koleksionet muzeore, pasuritë kulturore, organizimit të ekspozitave dhe aktiviteteve promovuese për çdo grup moshë, sipas rastit dhe në çdo formë të mundur të komunikimit me publikun.

Ndërsa ligji kombëtar lejon inovacion në menaxhimin e skemave të biznesit, strategjia e zhvillimit të sitit nuk duhet të shpërfillë, së bashku me objektivat e brendshme financiare dhe maksimizimin e të ardhurave, ndikimet e tjera të mundshme në lidhje me arsimin, kohezionin social, ndikimin ekonomik të komunitetit, në përputhje me sa parashikon Konventa e Këshillit të Evropës mbi Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë (konventa e Faro-s).

Dallimet e theksuara midis qasjeve të ngushta dhe të gjera të përshkruara në seksionin vijues bazohen mbi masën e përfshirjes së aktiviteteve të biznesit nën ombrellën e drejtpërdrejtë (ose indirekte, nëpërmjet nënkontraktimit) të menaxhimit të sitit kulturor, ose të lënë pjesërisht përpjekjeve të komunitetit lokal dhe në përgjithësi, në marrëdhëniet e biznesit me komunitetin lokal. Shfaqen pyetje praktike:

- A duhet që muzeu të përfshijë një kafene në tarracë, apo përpjekje të tilla duhet t'u lihen sipërmarrësve vendas ?
- A duhet që menaxhimi të organizojë dhe shesë paketa udhëtimesh turistike, përfshirë eventet në Amfiteatër, apo duhet t'u lihen operatorëve lokalë të udhëtimit? Çfarë duhet të bëjë muzeu nëse mungojnë iniciativa të tilla?
- Deri në çmasë punonjësit dhe furnitorët duhet të zgjedhin nga komuniteti lokal ose sipas një qasjeje me të thjeshtë konkurruese ?

Këto çështje janë të rëndësishme ; parë nga perspektiva e sipërmarrësve, arsyetimi është në favor të mbajtjes dhe kthimeve financiare brenda strukturës së brendshme të organizatës. Nga perspektiva e komunitetit, një qasje më ekuilibruar është e mirëpritur dhe e pritshme. Prandaj, nga perspektiva e një fondacioni, vlerësimi i trashëgimisë duhet kryesisht të synojë të garantojë suksesin e organizimit të kufizuar të sitit kulturor, ndërsa komuniteti lokal pret ligjërisht që vlerësimi i vendit të mbështesë rritjen ekonomike dhe mirëqenien në një nivel më të gjerë, duke inkurajuar investime më të përhapura dhe punësim.

Figurë 52 –Valorizimi ekonomik i siteve kulturor kundrejt zhvillimit social.

Zgjedhja e një qasjeje të ekuilibruar midis dy qasjeve dukshëm të kundërta qëndron në thelb të menaxhimit të suksesshëm të trashëgimisë kulturore. Sido që të jetë kombinimi, duhet të supozohet se zhvillimi i biznesit është një çështje qendrore, që duhet të sigurojë minimizimin e peshës së menaxhimit të sitit në buxhetin publik, ndërsa siguron ndjeshmërinë e tij financiare nëpërmjet ndërtimit të të ardhurave operacionale, të cilat vijnë nga sigurimi i përvojave të kënaqshme të vizitorëve.

Këto konsiderata do të përfshihen në një Plan Biznesi shoqërues, i cili do të mbulojë fushat kryesore vijuese:

1. Si qeveriset siti në terma afat-shkurtër për të përfituar nga momenti i projekteve të përshkruara në këtë PM?
2. Si do të qeveriset siti në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë: me krijimin e Fondacionit të ri, fushëveprimi i tij, aktivitetet kryesore, anëtarësimi, vlerat themelore, struktura e së cilit ende nuk është përcaktuar?
3. Burimet financiare dhe të tjera (kapitali dhe të ardhurat) të nevojshme për të arritur objektivat e tij strategjike: përfshirë personelin, menaxhimin e përditshëm, kostot operacionale dhe kthimet.
4. Mënyrat e përdorimit më të mirë të aseteve kulturore të Durrësit në Fondacionin e ri.
5. Shkalla e menaxhimit të aktiviteteve jo-thelbësore, që u kalohen drejtpërdrejt nënkontraktuesve ose u lihet sipërmarrësve vendas.
6. Një sërë treguesish kryesorë të performancës që pasqyrojnë strategjinë e organizatës dhe mundësisht të lidhura me një qasje më të gjerë të valorizimit, duke përfshirë përgjegjësinë sociale ndaj tërësisë.

Evoluimi i zhvillimit lokal dhe trashëgimisë kulturore

Zhvillimi ekonomik lokal dhe rajonal është bërë një aktivitet gjithnjë e më i rëndësishëm për qeveritë kombëtare, si dhe ato lokale dhe rajonale në të gjithë botën. Sidoqoftë, konteksti është riformuar në mënyrë dramatike gjatë viteve të fundit nga ndryshimet e thella në modelin e aktivitetit ekonomik. Ai është bërë dukshëm më sfidues dhe do të ndryshojë përsëri për shkak të rimëkëmbjes problematike nga pandemia e Covid-19. Pavarësisht pandemisë, drejtuesit që mbështesin sistemin ekonomik ka mundësi që ta mbajnë atë shumë të ndërkombëtarizuar, me njohuri të forta dhe konkurruese, edhe pse sipas një normaliteti të ri. Prandaj, ndërsa perspektiva afatshkurtër për ekonominë globale mbetet e pasigurt, natyra gjithëpërfshirëse dhe e ndjeshme e rritjes dhe zhvillimit të territorit ka të ngjarë të sfidohet, me pyetjet thelbësore rreth asaj që përbën sukses dhe zhvillim në lokalitete dhe rajone. Veçanërisht të ndikuar nga kriza aktuale janë sektorët e turizmit dhe kulturës[22].

Entitetet publike janë gjithashtu në zhvillim, në sisteme me shumë nivele, me institucione të reja dhe marrëdhënie të reja që shfaqen. Ndërkohë, terreni i riformuar i zhvillimit lokal dhe rajonal ka stimuluar mënyra të reja ndërhyrjesh, nëpërmjet instrumenteve të politikave novatore publike, duke kërkuar të shfrytëzojnë format e brendshme dhe të jashtme të rritjes dhe zhvillimit, shpesh të bazuara rreth partneritetit dhe formave të ndryshme të bashkëpunimit publik-privat, të cilat përbëjnë rritjen e shkurtimeve në shpenzimet publike[23].

---

[22] Shiko p.sh, OECD (2020). *OECD Economic Outlook, Interim Report.* Settembre, OECD Publishing, Paris, https://doi.org/10.1787/34ffc900-en

[23] Pollitt C. and Bouckaert G. (2017). *Public Management Reform.* Oxford: Oxford University Press

Vëmendja gjithashtu është zhvendosur nga një përqendrim në masën e zhvillimit në një shqetësim për cilësinë e tij, duke evoluar në konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm, i cili është, sa i përhapur, aq edhe shumë i kontestuar në implikimet e tij. Ekonomia që del nga procesi i globalizimit dhe masa shtrënguese pas 2011-ës karakterizohet nga një polarizim më i madh shoqëror dhe shpesh gjeografik, me rajone të suksesshme që priren të jenë ato që kanë diçka të veçantë për të ofruar, në tregjet që zgjerohen përtej sferave tradicionale lokale dhe rajonale. Rajonet turistike janë ende në mesin e atyre që mund të arrijnë të gjejnë vendin e tyre të tregut në arenën e globalizuar, duke i dalluar ato në nivelin kombëtar dhe ndoshta ndërkombëtar.

Kuadri i Konventës së Këshillit të Evropës mbi Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë, (Konventa Faro), thekson aspektet e rëndësishme të trashëgimisë, pasi ato lidhen me të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Konventa promovon një kuptim më të gjerë të trashëgimisë dhe marrëdhënies së saj me komunitetet dhe shoqërinë. Shqipëria ka nënshkruar Konventën Faro, megjithëse nuk e ka ratifikuar atë.

D.1.3 Qasje për vlerësim/valorizimin

Vlera ekonomike që gjenerohet nga vlerësim i trashëgimisë kulturore mund të ndiqet dhe vlerësohet sipas një qasje të ngushtë ose të gjerë të valorizimit[24].

Qasja e ngushtë e vlerësimit kufizon fushën në kufijtë fizikë të vendeve kulturore dhe ka të bëjë me vetëmjaftueshmërinë. Theksi është tek maksimizimi i të ardhurave të vetë-gjeneruara, me përqendrim tek ruajtja, prezantimi dhe mbrojtja për të siguruar qëndrueshmëri. Zgjidhen objektivat e kërkesës, duke u dhënë përparësi atyre që sjellin vlerë maksimale ekonomike, dhe shërbimet kulturore organizohen sipas këtyre objektivave. Shpërndarja lokale e përfitimeve ekonomike nuk është një çështje kryesore, pasi stafi dhe furnizuesit zgjidhen në përputhje me konsideratat konkurruese. Rritja sociale dhe kulturore e komunitetit lokal është një efekt i mirëpritur indirekt i cili, megjithatë, nuk është, as strategjik dhe as i përfshirë në qëllimin e organizatës [25]. Në rastin më të mirë, konsiderohet si një opsion i përgjegjësisë sociale. Vlerësimi mund të përqendrohet në krijimin e një përvoje optimale të vizitorëve e cila sigurohet nga puna performuese dhe emocionale, mundësisht e shoqëruar me një temë udhëzuese. Kjo shërben për ta bërë rrëfimin shumë tërheqës dhe shpërblyes, duke promovuar kështu konsumin hibrid (gjithashtu, nëpërmjet shitjeve të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme) dhe shitjen në treg për të nxjerrë të ardhura shtesë.

Qasja e gjerë e vlerësimit, siç nënkupton vetë emri, përfshin më shumë çështje të politikave publike. Gjerësia u referohet kufijve të ndikimit ekonomik. Ndërsa vlerësim i ngushtë përqendrohet në performancën financiare të sitit të trashëgimisë, vlerësim i gjerë e konsideron trashëgiminë si një mjet për të arritur qëllime më të gjera ekonomike, veçanërisht në lidhje me krijimin e vendeve të reja të punës.

Kjo është arsyeja pse vlerësim i trashëgimisë është bërë shumë i popullarizuar në politikën e kohezionit të BE-së, me pasuritë kulturore të supozuara si një burim social, kulturor dhe ekonomik për të gjithë komunitetin lokal dhe për rritjen rajonale.

Qëndrueshmëria financiare e sitit është akoma e rëndësishme dhe mund të zbatohet një qasje tematike për vlerësimin, por ndikimet e sjella në komunitetin e gjerë bëhen qendrore, duke përfshirë kështu çështje të tilla si përfshirja sociale dhe rritja afatgjatë ekonomike lokale. Siti kulturor interpretohet, gjithashtu, jo si një objekt i vetëm i konsumit të vizitorëve, por si një strukturë që

---

[24] Valentino P. (1999). "Strategie innovative per uno sviluppo economico locale fondato sui beni culturali". In Valentino P. Musacchio, Perego F.(1999). *La Storia al Futuro.* Firenze: Giunti

[25] Bryman A. (2004). Disneyizimi i Shoqërisë. Thousand Oaks, Ca: Sage

supozohet të shkaktojë risi sociale, kulturore dhe ekonomike (produkte të reja kulturore, teknika të reja të ruajtjes dhe mbrojtjes, etj).

Qasjet e ngushta dhe të gjera nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, pasi së paku në planin afatgjatë, një destinacion i ekuilibruar socio-ekonomik i shërben suksesit ekonomik të sitit, por në planin afatshkurtër, një qasje më e gjerë nënkupton që menaxhimi i sitit merr në konsideratë, brenda strategjive të tij, një shqetësim për mbrojtjen dhe rritjen e kontekstit lokal, në mënyrë që të shkaktojë një mori aktivitetesh të reja dhe të qëndrueshme në fusha të ndryshme të mbrojtjes, ruajtjes, turizmit, mikpritjes dhe shërbimeve kulturore, etj



Figurë 53 –Qasje e ngushtë dhe e gjerë ndaj vlerësimit të trashëgimisë kulturore, përshtatur nga Valentino, op. Cit.

D.2 Aspekte të lidhura me turizmin

Zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet nëpërmjet ekuilibrit midis ekonomisë, mjedisit, shoqërisë dhe kulturës. Prandaj, është e nevojshme të harmonizohet ekuilibri ekologjik me prodhimin efikas, barazinë sociale dhe respektimin e kulturës dhe diversitetit kulturor.
Mbrojtja e diversitetit kulturor dhe qasja ndaj kulturës nëpërmjet arritjeve në art, shkencë dhe teknologji është thelbësore.

D.2.1 Zinxhiri i furnizimit të turizmit

Pasuritë e prekshme

a) Atraksionet turistike

Në qytetin e Durrësit, atraksionet kryesore janë të lidhura me diellin dhe rërën ndërsa monumentet kulturore kanë rol dytësor dhe rol ndihmës. Këto nën-alternativa janë të dokumentuara nga shifra, të cilat tregojnë se vizitat kulturore në Durrës, fatkeqësisht, janë më të ulëta se ato të vendeve të tjera. (shiko§ 5.4.3).

Atraksionet e pranishme janë :

- Trashëgimia Kulturore, e cila është qendra e planit të tanishëm (Muzeu Arkeologjik i Durrësit, Amfiteatri, Forumi Bizantin, Termat Romakë, Kulla Veneciane dhe muret Bizantinë);
- Site të tjera kulturore, të cilat krijojnë atmosferën e qytetit. Vizitat më të shumta përfshijnë Bulevardin Epidamn me ndërtesa të shekullit të fundit, Xhaminë e Madhe, Xhaminë e Vjetër Fatih, Rrugën "Dok Margariti", të vizatuar me piktura murale, dhe Sheshin Liria, në afërsi të Amfiteatrit, në të cilën gjendet Bashkia, dhe nga ku fillon dhe Bulevardi Dyrrah nga ku starton "xhiro-ja". Përpara Bashkisë, sipër Termave Romake, gjendet teatri kryesor i cili ka një kapacitet prej 300 personash.

b) Akomodimi

Si u përmend dhe më sipër, Durrësi ofron mundësitë më të mëdha të akomodimit në Shqipëri, me rreth 6,700 dhoma të deklaruara zyrtarisht. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (SKZHQT) 2019-2023, thekson se shumica e mundësive të akomodimit operojnë në mënyrë jo formale dhe këtu më së shumti përfshihen shtëpitë private, apartamente dhe dhoma me qira, të cilat ofrojnë kushte dhe shërbim minimal. Për më tepër, ka një mungesë të theksuar të markave të mirënjohura të hoteleve, standardeve të cilave u referohen turistët e huaj për të pasur garanci të cilësisë së shërbimit dhe, në të njëjtën kohë, shërbejnë si garanci për besueshmërinë e destinacionit. Në këtë moment, nuk ka marka hoteli ndërkombëtare në Durrës.

c) Lehtësirat [26]

Sipas këtyre shërbimeve vërehet se :

- Transporti publik lokal nuk është një pikë me rëndësi pasi atraksionet kryesore janë shumë afër njëra-tjetrës dhe të arritshme në këmbë nga Bulevardi Dyrrah dhe Bulevardi Epidamn;
- Për sa i përket ***paraqitjes dhe valorizimit***, kjo pjesë e fortifikimeve është e integruar mirë me mjedisin përreth për sa i përket prezantimit të saj, por rripi i gjelbër përgjatë anës së tij të jashtme, instalimet artistike dhe disa tabela shpjeguese janë aktualisht të konsumuara.
- Ka ***nivel të mirë aksesueshmërie nga këmbësorët***- dhe për makinat gjithashtu, mundësi të kufizuara parkimi përgjatë rrugës
- ***Potenciali për sa i përket atraksioneve turistike*** është i moderuar për shkak të një niveli të paplotë të integritetit dhe autenticiteti, edhe pse vetëm në anën e jashtme.

Konstatime dhe rekomandime për Pjesën 2 të fortifikimeve:

- Kjo pjesë ka një nivel të mirë ***të mbrojtjes*** (statusi i mbrojtjes Kategoria 1).
- ***Konservimi*** strukturor duket i përshtatshëm, por rekomandohet një vlerësim për disa pjesë të palidhura që mund të jenë prekur nga tërmeti i vitit 2019. Ndërhyrja arkitektonike e konservimit duhet të planifikohet për kullat veriore.
- Për sa i përket ***paraqitjes dhe valorizimit***, kjo pjesë e fortifikimeve ka nevojë për planifikimin e masave urgjente, pasi është shumë e vështirë për të kuptuar kompleksitetin e monumentit

dhe perceptimin e bërthamës së vjetër të kalasë dhe lidhjen e saj me pjesët e tjera të fortifikimit.

- ***Aksesueshmëria nga këmbësorët*** - nuk është i mundur aksesi nga bërthama e qytetit për shkak të kalimeve ekzistuese të vjetra që janë mbyllur nga gardhe dhe ndërhyrje të paligjshme. Disa dekada më parë, ishte e mundur të arrihej në zonë nga pasazhet afër Amfiteatrit. Pjesa e sipërme e kalasë mund të arrihet vetëm me makinë, por mungon parkimi.
- ***Potenciali për sa i përket atraksioneve turistike*** është i moderuar për shkak të pamjes mahnitëse që mund të shijohet nga lart. Për më tepër, kullat e braktisura ose të fshehura në anën veriore duket se mbrojnë nivelin e lartë të autenticitetit dhe integritetit, që duhet të valorizohet nga prezantimi. Duhet të miratohet një plan i posaçëm për eliminimin e ndërtimeve të paligjshme/shpronësimit dhe sistemit të ndriçimit për të paraqitur peizazhin.

Plani i Detyrueshëm vendor për Zhvillim të Ri, Zona 5 (PDyV)

Teksti i mëposhtëm është marrë nga raporti i Son Engineering që ka përgatitur PDyV5, mbi të cilin u mbështet PM-ja. Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, qeveria shqiptare mori iniciativën për të mbështetur bashkitë e prekura, nëpërmjet një plani për rindërtimin dhe rimëkëmbjen sociale. Zona e Re e Zhvillimit u propozua nga bashkitë për miratim në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit (KSHR) dhe më u shpall me Vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i KShR-së është baza për hartimin e termave të referencës (TeR) për hartimin e PDyV. Programi i propozuar i KShR-së, përmban fillimisht kapacitetin e familjeve që pritet të akomodohen, të grupuara sipas tipologjisë së familjes, 1-2 anëtarë; 3-4 anëtarë; 4+ anëtarë. Programi shoqërohet, sipas rastit, me parashikime për objektet/shërbimet publike dhe infrastrukturën publike. Këshilli i Ministrave, në zbatim të Aktit Normativ 9/2019, ka miratuar VKM Nr. 887, datë 24.12.2019, "*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyrueshëm vendor, si dhe procedurën për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e katastrofës natyrore*". Këtu parashikohen rregullat kryesore për hartimin dhe miratimin e PDyV që Qeveria Shqiptare ka caktuar nga Fondi i Rindërtimit, një fond i veçantë për hartimin e Planeve Vendore të Detyrueshme dhe ka ngarkuar Agjencinë e Planifikimit të Territorit si njësinë zbatuese për hartimin e PDyV,

Rezultatet e këtij plani:

- Inspektim dhe dokumentim i hollësishëm i ndërtesave të shumta në Zonën A
- Dëmtimi i një numri të madh të ndërtesave pas tërmetit të vitit 2019 në Zonën A
- Zhvendosja e njerëzve nga qyteti dhe shpronësimi i pasurive
- Prishja e afërsisht 80 ndërtesave në qendër të qytetit
- Planet për amfiteatrin, të cilat përfshijnë eliminimin e strukturave pa leje dhe ngritjen e strukturave të reja

Ajo që është e panjohur janë aspektet arkeologjike të këtij plani, mënyra se si ky plan lidhet me PM-në, dhe procesi i shpronësimit dhe prishjes.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS)

Zyra e Kombeve të Bashkuara për shërbime të projekteve me financim nga Bashkimi Evropian zbaton një numër projektesh. Sipas faqes së tyre të internetit, ata po zbatojnë Projektin EU4CULTURE për të mbështetur rimëkëmbjen e monumenteve të vendit të trashëgimisë kulturore të prekur nga tërmeti i vitit 2019.

- Stabilizimi dhe përmirësimi i Muzeut Arkeologjik;
- Restaurim, Rijetësim i Hamamit Mesjetar;
- Restaurim, Rijetësim i Kullës Veneciane, si një qendër informacioni.

Ky ent zbatues është duke zhvilluar dhe projekte të tjera në këtë zonë.

E.1.2 Gërmimet e ardhshme arkeologjike

Durrësi ishte një qytet antik i dendur dhe i gjerë që ka qenë vazhdimisht i banuar prandaj, ka shumë pjesë që mbeten akoma për t'u zbuluar. Janë planifikuar gërmime arkeologjike për zonat e ardhshme dhe është hartuar një plan të përgjithshëm. Ky seksion i PM-së përfshin këtë plan, të organizuar sipas fushave dhe temave të caktuara.

Gërmimet e lidhura me fortifikimet. Një nga problemet kryesore të lidhura me arkeologjinë dhe paraqitjen për turistët, është mungesa e kuptueshmërisë, sesi fortifikimet kanë evoluar. Deri tani, kërkimet janë bazuar në pjesën jugperëndimore, e cila i ka mbijetuar shekujve dhe disa gërmimeve. Është e domosdoshme të kemi një qasje tjetër në lidhje me këtë çështje, duke zgjeruar zonën e gërmimeve dhe shpërndarjen e tyre në të gjithë perimetrin e fortifikimeve. Më anë të shpronësimeve dhe të zgjerimit të hapësirës përreth mureve, në pjesën jug-perëndimore dhe në citadelën mesjetare, do të krijohet mundësia e të pasurit hapësirë të mjaftueshme, për sa i përket gërmimeve. Por ndërhyrjet janë akoma më shumë të domosdoshme dhe në disa pjesë të tjera të fortifikimeve. PM-ja këtu liston zonat më të rëndësishme ku propozohen ndërhyrjet, dhe në shumë raste, aty ku është e mundur, ekspozimi e strukturave të zbuluara për turistët.

Në pjesën e pasme të kullës Veneciane, *intra dhe ekstramuros* (brenda dhe jashtë mureve), ka hapësirë për gërmime. Qëllimi i gërmimeve të nevojshme të *ekstramuros*, qëndron në zbulimin e plotë të kullës mesjetare, e cila shërbente si një kullë qoshe që lidhte pjesën jugperëndimore me atë juglindore. *Intramuros*, (brenda mureve). Në hapësirën ku është kthyer në një lokal, është e nevojshme të gërmohet në mënyrë që të gjenden fortifikimet antike të vona që mbyllnin perimetrin në këtë pjesë të qytetit (**Nr. 1**).

Në pjesën perëndimore të zonës së sapondërtuar të quajtur Veliera, është e nevojshme të bëhet gërmimi në mënyrë që të bëhet e dukshme e gjithë *stoae* romake (portiku klasik ose kolonada me çati) që ishte këtu (**Nr. 2**) dhe gjithashtu themeli i të gjithë mureve mesjetare dhe shtëpive mesjetare përkrah saj. Është e rëndësishme të pasqyrohet e gjithë struktura trans-kronologjike e qytetit.

Në perëndim të kësaj stoa-je, ekzistonte një termë (banjë) e madhe romake. Kjo shtrihet nën një lokal modern dhe nën platformën e një ambienti, i cili përdoret për parkim (**Nr. 3**). Gërmimi këtu jo vetëm që nxjerr në dritë këtë monument, por krijon një lidhje me gërmimet e tjera, duke i dhënë jetë një parku të rëndësishëm arkeologjik.

I gjithë kopshti i *ekstremuros*, në perimetrin jugperëndimor të fortifikimeve, mund të gërmohet për arsye të dy ndërhyrjeve (**Nr. 4**). E para, ajo shkencore, e organizuar në hendeqe të përmasave të vogla, gjë që do të ndihmonte për të njohur më mirë historinë e fortifikimeve, për të identifikuar më mirë kronologjinë dhe ndërhyrjet e tyre. Lloji i dytë i ndërhyrjes, e cila do të kryhet në një shkallë më të gjerë, do të nevojitej për të zbritur pjesërisht në nivele/shtresa më të hershme të strukturës, në disa pjesë deri në nivelin origjinal bizantin, duke u dhënë një imazh më të mirë fortifikimeve dhe lartësisë së tyre për vizitorët.

Për *Intramuros*-in, në varësi të madhësisë së tokës së lirë, me shumë vlerë dhe e domosdoshme do të ishte veçanërisht organizimi i gërmimeve të kufizuara për të zbuluar monumente të reja që mund të jenë një pikë tjetër e rëndësishme atraksioni. Gërmime të tilla do të ishin kryesisht të domosdoshme për zonat ku tashmë është e njohur ekzistenca e monumenteve të periudhave të ndryshme (**Nr. 5**).

Zona e citadelës mesjetare (**Nr. 6**), dikur një zonë e lirë nga ndërtimet moderne, tashmë është zona ku duhet të fillojnë gërmimet në një shkallë të gjerë. Qëllimi nuk do të jetë thellimi jonë në lidhje me këtë pjesë të fortifikimeve, por nxjerrja në pah e gjurmëve të strukturave dhe dhënia e një interpretimi të qartë të përdorimit të zonës ndër shekuj.

Në vijën veriore të kalasë osmane, janë të dukshme rrënojat e kullës së sahatit, e ruajtur pjesërisht, me hapësirë të gjelbër përreth saj (**Nr. 7**). Duke gërmuar tërësisht ose një pjesë të hapësirës së gjelbër (duke reduktuar përmasat e saj aktuale), do të jetë e mundur që të bëhet e dukshme e gjithë struktura e kullës dhe muret e periudhës romake. Një rindërtim sipërfaqësor i tyre do t'i transformonte tërësisht dhe do t'i jepte jetë monumenteve të reja të rëndësishme për historinë e qytetit.

Linja veriore e fortifikimeve më të vogla bizantine përfshin zona ku është e mundur të bëhen gërmime për të zbuluar dy kulla të tjera (**Nr. 8**) (një e tretë është tashmë e dukshme nën një ndërtesë moderne që mund të hapet për turistët).

Në majë të Kodrës së Stanit, pjesërisht në Zonën e Mbrojtur A dhe pjesërisht në Zonën B, ndodhet kështjella e periudhës Bizantine (**Nr. 9**). Ekzistenca e saj është e njohur nga burimet historike, por nuk është gërmuar dhe e zbuluar ende. Pranë saj gjendet një kullë kryesore e qytetit e shekullit të 13-të dhe një strukturë mesjetare, e ruajtur relativisht shumë mirë. Në këtë pozicion, gërmimet e organizuara, mbrojtja dhe ndërhyrjet në infrastrukturën ekzistuese, duhet të vihen në jetë. Në anën jugperëndimor të kopshtit të Pallatit të Sporteve, kalon një Fortifikim i madh Bizantin (**Nr. 10**). Në fakt është vendi i vetëm i lirë, që mundëson kryerjen e gërmimeve dhe gjetjet mund të lihen të hapura për publikun e gjerë. Në pjesën lindore të fortifikimeve, niveli i rrugës së ditëve tona "tradhton" prezencën e një strukture masive (**Nr. 11**). Faktikisht, në këtë zonë, ka shtëpi të cilat mbështeten në murin e mundshëm, dhe në krye të tij kalon rruga. Do të ishte me të vërtetë me rëndësi të gjendej mundësia që muret të bëheshin pjesërisht të dukshme për publikun e gjerë, dhe me shumë gjasa, një ose dy kulla.



Figurë 74 – Gërmime të planifikuara rreth fortifikimeve

Gërmime në shkallë të vogël - Në qendrën aktuale të qytetit, shtrihet nëntokë një katedrale e periudhës antike të vonë dhe mesjetare të Durrësit (fillon nga vetëm 30 cm nëntokë). Në këtë zonë, ka hapësirë për gërmime të pjesshme, dhe duke parë thellësinë jo shumë të madhe të strukturave, ato mund të hapen për publikun (**Nr. 12**).

Gjatë vitit 2007, në zonën **nr. 13** u krye një gërmim që zbuloi një kullë rrethore që i përkiste fortifikimeve të periudhës antike. Në vendin ku u zbulua mozaiku i shekullit IV para Krishtit i të ashtuquajturës "Bukuroshja e Durrësit", ka mundësi të zgjerohet zona e gërmimit dhe të zbulohet pjesa e mbetur e mozaikut (**nr. 14**). Duke qenë i vetmi mozaik i shekullit të 4-të para Krishtit në Shqipëri, ai do të bëhet një nga atraksionet më të rëndësishme të qytetit. Një pjesë e territorit është e mbuluar nga një shtëpi dy kate e ndërtuar në vitet 30', me tipare të këndshme arkitektonike. Kjo ndërtesë mund të ruhet dhe të shërbejë si një muze i vogël ose të shërbejë për një lloj tjetër aktiviteti turistik dhe në të njëjtën kohë të ofrojë shpjegime rreth mozaikut të gërmuar.

Kohët e fundit, u identifikua një pallat shumë i rëndësishëm, ndoshta perandorak, me mure relativisht të ruajtura mirë me një lartësi prej 3.5 m. I tërë pallati shtrihet nën një strukturë moderne (**Nr. 15**). Ne do të propozonim që gjatë një periudhe të mëvonshme, kjo zonë të shpronësohet dhe monumenti të gërmohet. Në këtë mënyrë, kjo ndërtesë do të bëhet një nga vendet më të rëndësishme për të gjithë Shqipërinë.

Gjatë viteve 1989-1990, u zbulua një monument që i përket periudhës së antikitetit të vonë në zonën e quajtur "Kinemaja Verore". Në të vërtetë, i gjithë territori është pjesërisht i mbuluar, por tashmë në pronësi të një pronari privat. Ka shumë hapësirë aty pranë për të zgjeruar gërmimet dhe për t'i bërë strukturat të dukshme (**Nr. 16**).

Në pjesën veriore të qytetit, ku janë gërmuar pjesë të disa insulave romake (blloqe antike të qytetit), të cilat tani janë pjesërisht të dukshme nën një ndërtesë moderne. Përpara saj, ka një hapësirë të hapur të gjelbër që mund të gërmohet dhe të shndërrohet në një park arkeologjik. Gjetjet mund të integrohen me njëri-tjetrin dhe të përmirësohen në mënyrë që të bëhen të dukshme për turistët (**Nr. 17**). Në kopshtin e ish-Muzeut të Luftës së Dytës Botërore u zbulua, falë bashkëpunimit shqiptaro-francez, një termë Romake (banjë) mjaft e dekoruar, pjesë e një strukture shumë të rëndësishme. I gjithë ky monument ruhet në këtë kopsht. Në këtë zonë, mund të gërmohet pjesërisht dhe këto gjetje arkeologjike mund të integrohen me gjelbërimin dhe pemët, dhe në këtë mënyrë të arrihet të bëhet një park natyror-arkeologjik. Monumente të tjera dihet se ekzistojnë këtu në formën e një mozaiku romak. Pikërisht përpara kësaj hapësire ekziston një vilë e madhe **ekstramuros** (nuk është e dukshme) nën një kopsht tjetër. Gjithashtu, këtu mund të gërmohet pjesërisht dhe kjo vilë të bëhet pjesë e këtij parku (**Nr. 18**).

Një pjesë e saj është private dhe pjesa tjetër publike. Ajo duhet t'i kthehet në pronësi publike, të pastrohet, të zgjerohen gërmimet dhe të hapet për publikun, në mënyrë që të ekzistojë mundësia e vizitave nga turistët (**Nr. 19**). Pjesa veriore e qytetit ekziston pjesërisht nën rrugën e ditëve të sotme, dhe pjesërisht nën një strukturë private, një strukturë e rëndësishme rezidenciale e zbukuruar me një mozaik që pasqyron një *hipokampus*. Aty pranë, nën një ndërtesë moderne, është ruajtur një mozaik tjetër, me një rozetë. Të dy ata duhet të jenë të hapur për publikun duke gjetur një mënyrë për të zgjeruar gërmimet (**nr. 20**).Në pjesën veriore të qytetit, nën një shtëpi të vogël, ruhet një nga mozaikët më të bukur të Shqipërisë që pasqyron Orfeun. Shtëpia duhet të shpronësohet dhe mozaiku të bëhet i hapur për publikun, duke zgjeruar gërmimet (**Nr. 21**). Një rast i veçantë është **nr. 22**. nga kërkimet e fundit të bëra, pasi besohet se ka shumë të ngjarë që këtu duhet të jetë teatri antik. Do të ishte me të vërtetë e rëndësishme gjetja e disa hendeqeve provë (për të cilat do të duhej hapësirë e madhe për shkak të thellësisë së strukturave), dhe në rastin e rezultateve pozitive në lidhje me ekzistencën e teatrit antik, e gjithë zona duhet të shpronësohet, të gërmohet dhe në këtë mënyrë të shndërrohet në një atraksion turistik.



Figurë 75 –Gërmime në shkallë të vogël brenda qytetit

Gërmime në zonën e nekropolit dhe në hapësirat përreth. Në kodrën perëndimore, të quajtur Kodra e Vilës, ekziston hapësira më e madhe e gjelbër e qytetit dhe në të njëjtën kohë, këtu ka vendndodhjen një nekropol i disa periudhave të ndryshme kronologjike dhe gjithashtu ka dhe disa gjurmë monumentesh (**nr. 23**). Në majë të kodrës, është ndërtuar rezidenca e ish-mbretit Zog, dukshëm një monument *naiskos* (tempull i vogël i stilit klasik me kolona dhe pediment) me një rrugë ceremoniale dhe disa varre monumentale nën ndërtesat moderne. Ekzistenca e dy kishave, e Shën Gjergjit dhe Shën Markut, në zonë tashmë është e njohur. Nëse ato arrihen të identifikohen dhe të gërmohen, do të ishte një zbulim vërtet i rëndësishëm për zonën. Në të njëjtën zonë, besohet se ka vendndodhjen një tempull arkaik Dorik. Në këtë situatë, sugjerohet të gërmohet pjesërisht dhe të bëhet e dukshme.

Ka disa pjesë të nekropolit romak, ku është e mundur të organizohen gërmime në shkallë të gjerë, veçanërisht rreth Stadiumit të qytetit (**nr. 24**). Duke parë që të gjitha gërmimet në lidhje me nekropolin janë bërë para vitit 1990 ose ishin gërmime shpëtimi, dhe tashmë është shumë e rëndësishme të kemi gërmime stratigrafike. Nekropoli i periudhës Arkaike-Helenistike, shtrihet në zonën kodrinore, në veri të Durrësit (**nr. 25**). Është e vështirë të gjesh hapësira për gërmime, por është e mundur që me ndërhyrjet e MK dhe Bashkisë të arrihet një marrëveshje me pronarët e tokës për të bërë gërmime dhe për t'i mbuluar ato përsëri. Ky ishte nekropoli më i pasur i qytetit, ndaj është shumë e rëndësishme të bëhen gërmime të reja stratigrafike në këto zona.

Duke marrë në konsideratë, të gjitha zonat e propozuara, ato nuk janë aq të shumta në numër ose në metra katrorë. Kjo hapësirë do të ishte më të vërtetë e rëndësishme për arkeologët për të përmirësuar thelbësisht njohuritë rreth qytetit të epokave antike-mesjetare. Vetëm për disa nga zonat, që parashikohen të gërmohen, ekziston mundësia e ruajtjes së këtyre gërmimeve dhe shndërrimit në atraksion turistik, ndërsa territoret që i përkasin nekropolit (**nr. 23-25**) duhet të mbulohen përsëri pas çdo gërmimi, dhe më pas do të jetë i mundur përdorimi i kësaj zone për aktivitet ndërtimor. Prandaj, nuk do të jetë barrë dhe mundim për qytetin t'i zbatojë këto propozime.



Figurë 76 –Gërmime në zonën e nekropolit dhe më gjerë

E.1.3 Masa ndërgjegjësuese: Plani i Interpretimit, Edukimit, i Bashkëveprimit me Komunitetin

Ekzistojnë kufizime financiare, rregullatore, fizike dhe kohore në çdo plan menaxhimi. PM-ja nuk është e mundur të shqyrtojë çdo aspekt të një qyteti të gjallë, që zhvillohet çdo ditë. Prandaj. PM-ja sugjeron një plan Interpretimi dhe Edukimi dhe Bashkëveprimi për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit të Durrësit, në lidhje më rëndësinë e trashëgimisë së tyre kulturore dhe arkitektonike. Përmirësimi i interpretimit/paraqitjes, do të ishte hapi i parë drejt ndërgjegjësimit dhe më tej dhe mbrojtjes më të mirë. Sipas Shoqatës Evropiane të Interpretimit të Trashëgimisë, *"Interpretimi i trashëgimisë lidh njerëzit me trashëgiminë e së shkuarës. Shndërron eksperiencat në burime frymëzimi dhe kreativiteti. Për ta bërë këtë, ai gjen pika të përbashkëta me njerëzit, ngjallë kuriozitetin e tyre, përfshin narrative që mund të jenë të lidhura me ta dhe nxit reflektimin"*.

Në vijimësi, një plan "Interpretimi, Edukimi dhe Bashkëveprimi me Komunitetin, duhet të zhvillohet, me pjesë përbërëse si:

1) **Bashkëveprimi me komunitetin dhe në veçanti me fëmijët në shkolla**
2) **Interpretimi i monumenteve në terren, me anë të mënyrave të ndryshme**
3) **Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe arsimin**
4) **Hartimi i një programi didaktik/edukues**

Bashkëveprimi me komunitetin dhe fëmijët në shkolla

Është thelbësore të informohet komuniteti dhe veçanërisht të rinjtë, të cilët kanë dëshirë të ndjekin një kurs studimi, dhe mundësisht një punë, që lidhet direkt ose indirekt me kujdesin e trashëgimisë kulturore të qytetit të tyre. Për këtë qëllim, është e nevojshme të përmirësohet vetëdija, krenaria për historinë dhe ndjenja e përkatësisë. Nxënësit e shkollave duhet të përfshihen në një projekt me pjesëmarrje që i inkurajon ata të përcaktojnë atë që është shqetësuese dhe si mund të përmirësohet dhe të bëjnë sugjerimet e duhura kundrejt autoriteteve përkatëse. Shpikja e historive rreth përdorimit të saj në të kaluarën bazuar në prova dokumentare mund të krijojë veprimtari të mëtejshme kulturore, të tilla si shfaqje të vogla teatrore.

Ky bashkëveprim duhet të përfshijë gjithashtu komunitetin e gjerë. Interpretimi i monumentit do të jetë i dobishëm, por është përdorimi i përmirësuar dhe valorizimi që do të ketë ndikimin më të madh. Nëpërmjet përdorimit, komuniteti do të kuptojë që vendet arkeologjike nuk janë relike statike të së kaluarës, por një pjesë e rëndësishme e vazhdimësisë së historisë së tyre. Përpjekja për të niminuar Amfiteatrin në Listën e Trashëgimisë Botërore mund gjithashtu të përmirësojë ndërgjegjësimin brenda komunitetit për rëndësinë e qytetit. Së fundi, projektet e ardhshme të ruajtjes në amfiteatër, banjat dhe forumin së bashku me projektet shumë të rëndësishme TID dhe UNOPS do të kenë një ndikim të madh në ndërgjegjësimin e komunitetit. Sidoqoftë, këto veprime duhet të bëhen më të njohura dhe promovohen si një strategji e përgjithshme e iniciativave kulturore, gjë që është përfshirë në Planin e Veprimit.

Interpretimi i monumenteve

Zhvillimi i një plani gjithëpërfshirës të interpretimit për të gjitha monumentet, të ndara sipas periudhave historike, duhet të jetë një prioritet dhe të zbatohet brenda 5 viteve të ardhshme. Ky plan duhet të bazohet në rezultatet të kërkimeve në terren dhe kërkimeve arkivore dhe duhet të përfshijë vetëm turistët/vizitorët, por edhe komunitetin dhe kërkesat e veçanta të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme me natyrë didaktik/arsimor. Ky plan interpretimi, gjithashtu mund të përmbajë dhe element digiital, siç është realiteti i zmadhuar (augmented reality), prezenca në internet dhe rrjetet sociale.

Zhvillimi i planit të interpretimit duhet të realizohet gjatë 5 viteve të para, duke filluar nga monumentet të përfshira në zonën TID, dhe më pas duke trajtuar në mënyrë progresive zonat e tjera të Durrësit, si më poshtë:

i. **Amfiteatri**
ii. **Banjat Romake dhe Forumi Bizantin**
iii. **Muzeu Arkeologjik i Durrësit**
iv. **Itineraret Urbane**
v. **Pasuritë Kulturore në zonën A**
vi. **Pasuritë Kulturore në zonën B**
vii. **Pasuritë Kulturore të tjera**

Bashkëpunim ndërmjet institucioneve, përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe arsimin

Si pjesë e planit të interpretimit dhe edukimit, duhet të ketë bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, shkollat e niveleve të ndryshme në qytet dhe Ministrinë e Kulturës. Të gjitha këto institucione kanë staf të motivuar dhe proaktiv që janë të përkushtuar ndaj kërkimeve dhe promovimit të njohurive më të gjera të trashëgimisë arkeologjike në tokë dhe në det. Ky bashkëpunim duhet të përfshijë organizata jofitimprurëse dhe të komunitetit, siç është Iniciativa "Miqtë e Monumenteve". Partneritetet duhet të kenë përparësi si me shkollat fillore dhe të 9 vjeçare në Durrës, publike (aktualisht 55 shkolla) dhe private (aktualisht 17 shkolla), por rekomandohet që fusha e veprimtarisë të shtrihet progresivisht në shkollat e mesme dhe në universitetet e Durrësit dhe Tiranës, për shembull nëpërmjet praktikave mësimore. Përfshirja e institucioneve vendore kulturore duhet të parashikohet në rregulloren e institucionit të ri arsimor.

Programi didaktik dhe arsimor

Një program i tillë duhet të vendoset në qendrat ekzistuese dhe të reja në Durrës kushtuar trashëgimisë kulturore, duke përfshirë muzeun Arkeologjik, por edhe Memorialin e Luftës, ndoshta edhe një qendër e re të krijuar për të vendosur objektet e zbuluara nga gërmimet arkeologjike, të ruajtura aktualisht prapa muzeut. Këto qendra duhet të bëhen katalizator për ndërmarrjen e një numri aktivitetesh interpretimi dhe arsimore të përqendruara në trashëgiminë kulturore, duke angazhuar fëmijët e vegjël. Horizonti i aktiviteteve duhet të zgjerohet fillimisht nga fëmijët vendas deri në fëmijët e atyre familjeve që do të zgjedhin Durrësin si një destinacion për pushimet dhe vizitat e tyre turistike. Fakti që Durrësi zë vend në blogjet e udhëtimit si një vendndodhje e përshtatshme për familjet (family friendly)[45] meriton vëmendje. Përmirësimi i veprimtarive të këtyre qendrave të qytetit, i cili aktualisht reklamohet në mënyrë të përshtatshme, mund të bëhet një atraksion për zgjedhjen e Durrësit si një destinacion pushimesh nga familje kombëtare dhe ndërkombëtare. Një projekt i tillë mund të jetë kandidat për një edicion të ardhshëm të çmimit "Destinacioni i Turizmit Kulturor të Qëndrueshëm", të organizuar nga Rrjeti Evropian i Turizmit Kulturor (RRETK) në partneritet me *Europa Nostra*, Komisionin Evropian të Udhëtimit dhe NECSTouR[46].

Treguesit e suksesit të këtij projekti tregohen në vijim:

- numri i shkollave të përfshira në programin edukues;
- numri i klasave të shkollave të përfshira;
- numri i iniciativave interpretuese edukuese të zhvilluara;
- rritja e numrit të fëmijëve dhe familjeve ndërmjet vizitorëve të tjerë në site;

[45] https://www.patatofriendly.com/una-vacanza-al-mare-a-durazzo-con-bambini/
[46] https://www.europanostra.org/destination-of-sustainable-cultural-tourism-awards-2021-apply-by-1-june/

- rritja e numrit të të regjistruar në degët e mëposhtme në Universitetin e Durrësit:
    - Menaxhim Turizmi Kulturor
    - Turizëm Arkeologjik

Burimet e verifikimit do të jenë si më poshtë:

- Marrëveshjet me programin didaktik dhe edukues, të përmbledhura në Raportin Vjetor të aktiviteteve të zbatuara
- Raporti vjetor i shkollës së zonës
- Kartat e familjes, të rezervuara për familjet e Durrësit, të cilat shiten çdo vit
- Të dhënat statistikore për Universitetin e Durrësit

Referencat ndërmjet objektivave dhe veprimeve/aktiviteteve

Për të integruar tre objektivat kryesore, ky seksion kryqëzon referencat dhe siguron zbatimin e PM-së. Lidhjet midis objektivave dhe veprimeve përshkruhen shkurtimisht më poshtë.

- Përmirësimi i ruajtjes dhe paraqitjes do të rezultojë në një rritje të numrit të vizitave dhe kënaqëshmëri të shtuar për vizitorët. Kjo do të përforcojë aspektet e turizmit kulturor të qytetit dhe do të fillojë një cikël përmirësimi, duke çuar kështu në përmirësimin e përdorimit dhe valorizimit.
- Aspektet e valorizimit, të tilla si përdorimi i amfiteatrit si një vend kulturor gjithashtu do të rrisin numrin e vizitave, duke përmirësuar kështu dukshmërinë dhe duke sjellë vlerësime për ruajtjen.
- Projektet brenda fushëveprimit këtij objektivi janë gjithashtu të integruara.

    - Fasadat kryesore të TID të Rrugës së Tregtarëve, infrastruktura qytetare në trotuare dhe itinerare që do të ndihmojnë në integrimin e amfiteatrit në qytet dhe restaurimi i fortifikimeve të Citadelës së Sipërme do të sigurojë një sfond për amfiteatrin.
    - Projekti UNOPS në Muzeun Arkeologjik do të tërheqë një numër më të madh vizitorësh dhe është dëshmuar se ekziston një lidhje e fortë me vizitat në amfiteatër.
    - Qeveria shqiptare për shpronësimin dhe eliminimin e strukturave pa leje në krye të amfiteatrit.

E.2 Rritja e Nivelit Mbrojtjes

E.2.1 Miratimi i Planit të Menaxhimit

Në përputhje me ligjin shqiptar, miratimi i këtij Plani të Menaxhimit është hapi i parë në rritjen e nivelit të mbrojtjes për trashëgiminë kulturore të qytetit. Kjo gjithashtu përfshin Planin e Biznesit të zhvilluar paralelisht me PM. Pjesë e procesit të miratimit të PM-së është përfshirja e një vlerësimi të menaxhimit të riskut dhe planit të menaxhimit të riskut, siç përshkruhet në seksionin për zbatimin dhe monitorimin.

E.2.2 Përditësimi i Listës së Pasurive Kulturore

Lista e pasurive kulturore duhet të përditësohet me ndërtesa me vlera kulturore të Durrësit. Shumica e këtyre ndërtesave janë ndërtuar më shumë se 70 vjet më parë dhe kanë karakteristika të rëndësishme arkitektonike, historike dhe stilistike. Përfshirja e këtyre ndërtesave në listën e pasurive kulturore është në përputhje me dispozitat e ligjit.

Ndërtesat që duhet të merren në mbrojtje janë ato të listuara më poshtë:

- **Xhamia e Durrësit**
- **Ndërtesa e Bashkisë**
- **Pallati i Mbretit Zog**
- **Hotel Vollga**
- **Muzeu i Dëshmorëve**
- **Pallati i Kulturës**
- **Ndërtesa e Prefekturës**
- **Pallati i Sportit**

Ka akoma ndërtesa të tjera, të cilat meritojnë mbrojtje për vlerat e tyre shumë të çmueshme arkitektonike, historike dhe kulturore, të cilat janë ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të. Legjislacioni aktual lejon vendosjen në mbrojtje dhe përcaktimin e ndërtesave pa marrë parasysh kohën e ndërtimit të tyre

E.2.3 Rregullore të përmirësuara.

Edhe pse VKM për mbrojtjen e zonave arkeologjike A dhe B ka fuqi mbizotëruese mbi Master Planin e Durrësit për përdorimin e tokës, rekomandohet ndryshimi i mëposhtëm në Nenin 3. Lidhur me "Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike "A":

- **Asnjë kat shtesë në ndërtesat ekzistuese nuk duhet të autorizohet në Zonën "A";**
- **Në rast të rindërtimit të rrugës dhe të gjitha punimeve në rrjetin inxhinierik, në përputhje me projektet e miratuara nga KKTKM, në prani të zbulimeve arkeologjike, paraqitjet alternative do të paraqiten për aprovim nga KKTKM;**

Për më tepër, në nenin 4 të lidhur me "Ndërhyrjet e lejuara në Zonën arkeologjike" B", sugjerohet të shtohet parashikimi i mëposhtëm:

- **Në rast të zbulimeve arkeologjike gjatë fazës së parashikuar të fazës së testimit, KKTKM do të vendosë nëse ato duhet të ekspozohen dhe, në një rast të tillë, pronari duhet të përshtatë projektin e ndërtimit dhe të marrë aprovimin me shpenzimet e tij, në mënyrë që të lejojë ekspozimin e përhershëm dhe ruajtjen e zonave arkeologjike.**

Rregullorja lidhur me zonën e mbrojtur (të re) B duhet të jetë një ndërthurje e zonave arkeolojike A dhe B. Është e nevojshme të eliminohet modeli i përdorur për zonën aktuale B, ku lejohet të bëhen sondazhe dhe, bazuar në to, të vendosin të kryejnë gërmime të përgjithshme ose të lejohen të ndërtohen. Është e nevojshme një qasje e re për të mbrojtur më mirë trashëgiminë nëntokësore. Çdo

zhvillues që do të aplikojë për leje për të ndërtuar në këtë zonë duhet të nënshkruajë se: do të kryhen gërmime të përgjithshme të territorit që do të ndërtohet, sondazhe provë; gjithçka që do të gjendet duhet të kalojë në proces konservimi dhe të jetë e hapur për vizita; zhvilluesi duhet të paguajë të gjitha kostot e këtyre punimeve dhe pjesa që do t'i kushtohet strukturave duhet të kalojë në pronësi të shtetit.

Të gjitha punimet publike infrastrukturore duhet të kenë të njëjtën rregullore me Zonën A (për të ndjekur linjat ekzistuese, ose në rast të atyre të reja që do të gërmohen plotësisht). Në rastin e ndërtimit të ndërtesave publike, të ketë të njëjtat kushte me ato private. Rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese duhet të jetë e ngjashme me rregulloret e zonës A, me përjashtim të rastit të hapësirës dhe thellësisë së zmadhuar, ku duhet të ndjekin të njëjtat rregulla si ndërtimet e reja.

E.2.4 Zgjerimi i mundshëm i zonave arkeologjike A dhe B

Studimet e fundit për zhvillimin historik të Durrësit kanë treguar se gjatë shekujve, kufijtë e qytetit janë zgjeruar dhe tkurrur. Në perëndim dhe në jug, zgjerimi i qytetit u kufizua nga Deti Adriatik, ndërsa kufiri lindor kufizohej nga një lagunë e cekët. Si rrjedhim, zgjerimi ishte i mundur vetëm në pjesën veriore. Zbulimet arkeologjike tregojnë se vija e fortifikimeve të periudhës pararomake ishte e përqendruar brenda zonës së kufizuar nga Kodrat e Stanit (vendndodhja e rrënojave të kalasë mesjetare). Gjatë periudhës romake, qyteti u zgjerua përtej fortifikimeve të tij, duke u shtrirë me ndërtime në hapësira të reja dhe duke u zgjeruar më pranë bregdetit, por kryesisht drejt veriut. Arsyeja e mundshme për të ndërtuar fortifikime më të mëdha gjatë antikitetit të vonë pranë kodrës së Dautës ishte përfshirja e strukturave të hershme. Kjo linjë fortifikimesh ishte shtrirja maksimale e strukturës urbane gjatë antikitetit dhe antikitetit të vonë. Më pas, qyteti u tkurr brenda fortifikimeve më të vogla bizantine, të cilat mbetën kufijtë e qytetit gjatë periudhës mesjetare. Qyteti u tkurr më tej gjatë periudhës së hershme osmane dhe filloi të zgjerohet vetëm në shekullin e 18-të. Ky zgjerim dhe tkurrje tregon se vetëm gjatë antikitetit të vonë dhe periudhave mesjetare ekzistojnë kufij të qartë historikë të qytetit, kryesisht për shkak të fortifikimeve. Sidoqoftë, kufijtë e qytetit janë më pak të qartë gjatë periudhës së gjatë romake.

Zona aktuale e mbrojtur A bazohet te perimetri i antikitetit të vonë/fortifikimeve mesjetare. Zona e mbrojtur B tregon ngjashmëri për sa i përket shtrirjes territoriale periferike, jashtë mureve të lashta dhe përfshin nekropolin kodrinor, nekropolin fushor dhe strukturat helenistike në kënetën e dikurshme. Zona e mbrojtur A ishte e mirëmenduar dhe bazuar në kërkime, por ka disa probleme:

- **Kufijtë përjashtuan zona të rëndësishme arkeologjike - *muret shtesë***
- **Kufijtë devijojnë nga linja aktuale e fortifikimeve të antikitetit të vonë**
- **Kërkimet e reja kanë zbuluar gjetje shtesë arkeologjike**



Figurë 77 – Kufijtë aktualë të Zonave të mbrojtura A dhe B

Pesë zona të mëdha kanë mbetur me mbrojtje të pamjaftueshme, përfshirë antikitetin e vonë/fortifikimet bizantine, nekropolin dhe periferinë romake me mozaikët Orfeu, Hipokampusi, Polikromi dhe Roseta. Prandaj, është e kështillueshme që të hulumtohet çdo zgjerim i mundshëm i Zonës A gjatë zbatimit të kësaj PM-je. Këto zbulime mund të jenë të pamjaftueshme për të justifikuar zgjerimin e Zonës A, por tregojnë për mbetje të mundshme arkeologjike të cilat mund të zbulohen në të ardhmen.

Në funksion të çdo zgjerimi të ardhshëm, është thelbësore të vlerësohet ndikimi i VKM-së aktuale Nr. 786, datë 26.12.2018 "*Për Miratimin e Zonave Arkeologjike "A" Dhe "B" të Qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre*". Ka pak rezultate/monitorime se si zbatohet ky akt nënligjor dhe për efektivitetin e tij. Pas një rishikimi të tillë, rregullorja e shkruar lidhur me Zonën A mund të kërkojë përmirësim. Rregulloret mbrojnë qartë arkeologjinë nëntokësore nga shkatërrimi, por është më pak e qartë ajo që ndodh me ndërtimet pa leje dhe joformale. Rregulloret duhet të përpunohen për të përfshirë përgjegjësitë, veprimet dhe procedurat që duhen ndjekur në rastin e ndërtimeve, ad hoc. Nëse rregulloret aktuale lejojnë pronarët të përmirësojnë pronën e tyre, ato duhet të jenë më të detajuara për kushtet e përmirësimit - si do të realizohet ndërtimi, si do të paraqitet dhe si do të merret leja nga Ministria e Kulturës. Çdo rishikim duhet gjithashtu të përfshijë elementet e rëndësishme arkeologjike dhe përmirësimet e nevojshme. Këto përmirësime do të siguronin më shumë mundësi dhe qartësi për zotëruesit e pronave.



Figura 82 – Zona shtesë me interes arkeologjik. Konturet me ngjyrë të zezë përfaqësojnë pesë zona të ardhshme për hulumtim dhe zgjerim të mundshëm të Zonës A. Konturet me ngjyrë kuqe përfaqësojnë zona shtesë që kërkojnë hulumtim dhe propozimin e rregulloreve të zgjeruara në Zonën B.

Zona e Mbrojtur B përfshin periferinë romake dhe nekropolin e lashtë. Çfarë ndodhet jashtë Zonës B përfshin shtrirjen e të gjithë kodrave veriore, ku njihet ekzistenca e disa tempujve, një nekropoli më të vogël dhe siteve të tjera arkeologjike. Kjo përfshin muret e fortifikimeve të Porto-Romanos, të cilat u dëmtuan rëndë në vitin 2020, dhe Bazilikën në Arapaj.

PM Zona A

Hulumtimi dhe vlerësimi për një zgjerim të mundshëm të Zonës A mund të fokusohet në pesë zona të vogla (të treguara në figurën e mësipërme). Kjo do të përfshinte jo vetëm fortifikimet më të vogla bizantine por, njëkohësisht, pjesë të periferisë romake, nekropolit dhe disa mozaikë të rëndësishëm. Në anën perëndimore, plani duhet të përfshijë të gjithë Kodër-Vilën (me nekropolin romak të antikitetit të vonë dhe Vilën e Mbretit Zog). Në anën jugore, zona duhet të zgjerohet pak rreth fortifikimeve, ndërsa nga ana lindore, ajo duhet të ndjekë rrugën Rruga Egnatia. Ndërtimet e lejuara duhet të përcaktohen në mënyrë specifike dhe të qartë me elemente teknike. Rregullorja e rishikuar e shkruar duhet të përmendë në mënyrë specifike se çdo punim për realizimin e ujësjellës-kanalizimeve (për ujërat e shiut, ujërat e zeza dhe furnizimin me ujë të pijshëm) duhet të ndjekin linjat ekzistuese. Nëse do të hapen kanale të reja, atëherë duhet të jetë e detyrueshme që të kryhen gërmime arkeologjike

stratigrafike. Leja për rindërtimin e banesave duhet të përcaktohet më mirë dhe të shprehë llojin e punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit të propozuar, përfshirë gërmimet nëntokësore. Bashkia dhe Ministria e Kulturës duhet të marrin të gjithë dokumentacionin ligjor nga institucionet e tjera, duke konsideruar faktin që ka pasur shumë ndërtime joformale. Neni 6 i VKM-së 786/2018 parashikon institucionet përgjegjëse për kontrollin dhe marrjen e masave në rast të veprimtarisë së paligjshme, por kjo nuk është zbatuar. Duhet të përcaktohet qartë institucioni lokal i MK-së, që ka përgjegjësinë për të kontrolluar zonën e mbrojtur, dhe cilat hapa administrativë duhet të ndiqen në rast të veprimtarisë ilegale.

PM Zona B, rregulloret e zgjeruara të propozuara

Burimet e rëndësishme kulturore arkeologjike në këtë zonë, nuk janë me të njëjtën dendësi si në Zonën B për të justifikuar bllokimin e të gjitha ndërtimeve. Sidoqoftë, dendësia nuk është e njëtrajtshme në këtë zonë. Për këtë arsye, përfundimisht, propozohet përmirësimi i rregullores në Zonën ekzistuese B për të përmirësuar mbrojtjen. Kufijtë e zonës së mbrojtur të zgjeruar brenda zonës ekzistuese B do të pozicionohen në pjesën jugperëndimore të zonës A, e cila përmban punishtet e lashta, kryesisht për prodhim qeramikash dhe pjesë të një nekropoli të vogël, por të pasur, helenistik. Në pjesën veriperëndimore të Zonës A, ajo duhet të përfshijë të gjithë luginën midis Kodrës se Stanit dhe Kodrës së Dautës. Ky territor ishte pjesë e qytetit antik dhe antik të vonë, i cili nuk ka qenë në qendër të kërkimeve dhe në të cilën janë kryer pak gërmime. Gjetjet e rastësishme tregojnë për një nivel të lartë rëndësie. Në pjesën veriore të Zonës A, kufijtë e rregulloreve të zgjeruara brenda zonës ekzistuese B duhet të përfshijnë fortifikimet më të mëdha bizantine.

Modeli i përdorur për zonën B duhet të modifikohet. Aktualisht kërkohet të bëhen vetëm sondazhe dhe të vendoset nëse nevojitet një gërmim arkeologjik total duke u bazuar në to. Prandaj, propozohet që të realizohen një seri sondazhe, më të gjera, të cilat të kryhen bazuar mbi dëshmitë e gjetura në sit. Kjo do t'i lejonte arkeologët të kërkonin gërmimin e plotë para ndërtimit. Rregulloret Arkeologjike përcaktojnë qartë hapat që duhen ndjekur në secilën zonë, por kjo nuk njihet nga zhvilluesit ose nuk zbatohet rreptësishtë. Çdo zhvillues që aplikon për leje ndërtimi duhet të jetë i vetëdijshëm për serinë e kërkuar të gërmimeve dhe mundësinë e gërmimit total. Gjykimi i bazuar vetëm në gërmime të vogla prove nuk lejohet më. Çdo gjë e rëndësishme që gjendet duhet të kalojë nëpërmjet konservimit dhe siti duhet eksploruar për vizita. Zhvilluesi duhet të paguajë të gjitha kostot e një pune të tillë dhe pjesa që do t'i kushtohet arkeologjisë duhet të bëhet pronë e shtetit.

Të gjitha punët publike infrastrukturore në Zonën B të zgjeruar duhet të kenë të njëjtën rregullore si Zona A (për të ndjekur linjat ekzistuese të shërbimeve ,ose në rast të atyre të rejave - ato duhet të gërmohen tërësisht nga një arkeolog). Çdo planifikim i përmirësimit të infrastrukturës duhet të përfshijë një arkeolog.



Figurë 78 – Zgjerimi i propozuar i Zonave të mbrojtura A dhe B (me ngjyrë blu), zona të nevojshme për zbulimet e ardhshme jashtë zonës A janë treguar në diagramin e mëparshëm

Plani i Menaxhimit është plotësuar me informacion nga njohuritë e arkeologëve për zhvillimin historik të qytetit dhe trashëgimisë arkeologjike. Zonat me mbetje të mundshme arkeologjike ndodhen menjëherë jashtë kufijve aktualë të mbrojtur të Zonës A. Rrjedhimisht, PM-ja kështillon që kërkimet e mëtejshme duhet të intensifikohen në këto zona për të identifikuar planet e mundshme të zgjerimit të Zonës A për t'i mbrojtur këto thesare arkeologjike. Sidoqoftë, duhet konsideruar fakti se Durrësi është një qytet i banuar dhe ndryshime të tilla me kufizime shoqëruese për aktivitetet në pronën private dhe publike kërkojnë kohë dhe vullnet politik për t'u zbatuar. Për më tepër, pranohet se aktualisht është në proces zhvillimi i Masterplanit të ri të qytetit. Prandaj, zgjerimi i Zonës A nuk ka nevojë të realizohet menjëherë dhe duhet të bëhet gradualisht me kalimin e kohës. Pesë zonat nuk ka nevojë të përfshihen menjëherë në Zonën A, por mund të përfshihen një nga një. Në fakt, Plani i Veprimit i detajuar në PM e planifikon këtë zgjerim të mundshëm të zonave të mbrojtura në fazat përfundimtare të PM-së pas pesë vjetësh. Në vazhdim, duhet të monitorohet VKM-ja aktuale 786/2018. Ndërkohë, këto zona janë ende nën mbrojtje të kufizuar duke qenë se ato përfshihen në Zonën B dhe nën mbrojtjen e Ministrisë së Kulturës dhe Institutit të Arkeologjisë. Ekzistojnë gjithashtu mbrojtje të tjera ligjore në rast se zbulohet diçka gjatë ndërtimit.

Është e rëndësishme që zgjerimi dhe zbatimi i planifikuar i Zonës A të rivlerësohen çdo vit, para dhe gjatë ndërtimit të çdo ndërtimi të propozuar, veçanërisht para projekteve të infrastrukturës, që mund të ndikojë trashëgiminë kulturore nën tokë. Përveç kësaj, ideja e zgjerimit duhet të rivlerësohet nëse

ka ndonjë zbulim të rëndësishëm arkeologjik pranë këtyre zonave. Zbulimet e mundshme do t'i përcaktojnë më mirë kufijtë e këtyre ndryshimeve të propozuara. Prandaj, projektet e ndërtimit në zonat e zgjerimit të përshkruara më sipër duhet të vlerësohen me kujdes rast pas rasti derisa zgjerimi i Zonës A të jetë i realizueshëm.

Qyteti modern i Durrësit aktualisht është zgjeruar në tre drejtime: drejt veriut (Portëz -Porto Romano), lindjes (Kënetë -Shkozet) dhe juglindjes (Plazh, Arapaj). Durrësi historik dhe zonat A dhe B përfshijnë vetëm një të pestën e kësaj zone. Kjo do të thotë se zgjerimi i vogël i Zonës A nuk ndalon zhvillimin dhe zgjerimin modern të qytetit. Qyteti modern mund të bashkëjetojë me qytetin antik dhe monumentet e tij të rëndësishme.

E.2.5 Përmirësimi i Masterplanit të Durrësit

Një veprim i rëndësishëm në rritjen e nivelit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të Durrësit është përmirësimi i masterplanit të qytetit. Siç u identifikua më sipër, ka boshllëqe midis legjislacionit kombëtar dhe atij vendor dhe zbatimit të pabarabartë të rregulloreve ekzistuese. Aktualisht ekzistojnë tre masterplane për qytetin, masterplani i aprovuar, por i vjetruar, masterplani i pa aprovuar por de facto (i cili është pothuajse i vjetruar) dhe masterplani i ardhshëm aktualisht në proces. Është thelbësore që kjo PM të ofrojë informacion për masterplanin e ardhshëm, dhe projektet, idetë dhe afatet kohore të përfshihen në këtë plan. Kërkohet një harmonizim i rregulloreve dhe zbatimit. PM është ndarë me bashkinë e Durrësit dhe janë zhvilluar diskutime gjatë përgatitjes së këtij plani.

Përmbledhja e rekomandimeve, për përshtatjen e mjeteve rregullatore të Masterplanit aktual, në mënyrë që të përmirësohet ruajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe arkeologjike të Durrësit.

Objektet që duhet të mbrohen	Zona e qytetit	Zonat përkatëse e planit urban	Elementet mbrojtëse në rregulloren ekzistuese	Rekomandime për përshtatje në rregullore	Udhëzime për ruajtjen	Rekomandime për përshtatjen e udhëzimeve	Rekomandime të tjera
Arkitektura Popullore (vernakulare)	Qendra e qytetit, jugu, dhe lindja	Zona A : M2.0	Në rast shkatërrimi të një ndërtese në zonën M2, mund të rikonstruktohet me të njëjtin vëllim sipas kushteve të udhëzimeve për ruajtjen Rregullorja e planifikimit: Sipas studimit urban të qendrës.	Të lejohen shtesat, në rast të ndërtesave të vogla ose toke të lirë		Të shkruhen udhëzime për Arkitekturën Popullore.	Ndërtimet në volumin ekzistues duket se janë shumë të kufizuara dhe rreziku që pronarët e këtyre shtëpive të mos i rinovojnë ato është shumë i madh. Pronarët e shtëpive popullore duhet të mbështeten nga shteti, në mënyrë që të restaurojnë shtëpitë e tyre duke ruajtur origjinalitetin e tyre. Mekanizmat nxitës mund të jenë: norma të favorshme ose ulje të taksave.
	Qendra e qytetit, pjesa perëndimor-e			Në shpatet kodrinore, në lindje të sheshit Liria dhe të rrugës Aleksandër Goga (nuk përfshihen pjesët e pjerrëta dhe Bulevardi Epidamn përreth Amfiteatrit), identifikohet një zonë me ndërtime popullore referuar kartës I (1) Të lejohen shtesat, në rast të ndërtesave të vogla ose toke të lirë			
	Pjesa veriore, në lindje të rrugës Aleksandër Goga	Zona B : A1.1	Nuk ka direktiva për mbrojtje të veçantë. Zona me densitet të ulët përgjatë shpateve (parcela 400m2, intensiteti 0.6, maksimumi 3 nivele)				Rregulla korrespondojnë veçanërisht me karakteristikat e shtëpive popullore. Ndërtimet dhe vendbanimet e vjetra mund të bashkëjetojnë.

		Zona B: A2.1	Dendësia mesatare përgjatë bregut në qendër të zonës (parcela 400m2, intensiteti i tokës 1, 4 nivele maksimumi)				Dendësia është më e lartë. Kjo është një zonë ku nuk ka banesat tradicionale. Lejohet një farë intensifikimi.
Objektet që duhet të mbrohen	Zona e qytetit	Zonat përkatëse e planit urban	Elementet mbrojtëse në rregulloren ekzistuese	Rekomandime për përshtatje në rregullore	Udhëzime për ruajtjen	Rekomandime për përshtatjen e udhëzimeve	Rekomandime të tjera
Arkitektura me element neoklasik *Referuar Kartës II*	Qendra e qytetit. Pjesa Lindore	Zona A : M2.0	Në rast shkatërrimi të një ndërtese në zonën M2, mund të rikonstruktohet me të njëjtin vëllim sipas kushteve të udhëzimeve për ruajtjen Rregullorja e planifikimit: Sipas studimit urban të qendrës.	Identifikimi i vazhdimësisë arkitektonike përgjatë Bulevardit Epidamn, Bulevardit Dyrrah dhe Rrugës Aleksandër Goga deri në Muzeun e Dëshmorëve, ndryshe nga pjesët e brendshme të lagjeve.	Udhëzimet për ruajtjen janë plotësisht të zbatueshme. Mbrojtje e fortë në pjesës së jashtme të ndërtesës. Për ndërtesat historike ose ndërtesat me vlerë artistike, shtohen kufizime të mbrojtjes strukturore.	Shtojce: Përgjatë 3 rrugëve tregtare të respektohet radhitja në llojet dhe vëllimet arkitektonike. *Referuar Kartës I (2)*	Studimi urban i qendrës që do të integrohet kur të përfundojë plotësisht. Është e mundur plotësimi i listës së ndërtesave të mbrojtura në bazë të një inventari sistematik.
Trashëgimia e viteve 1930 *Referuar Kartës II*	Qendra e qytetit, zona pranë detit	S6			Objekt i udhëzimeve për ruajtjen, ndërtesave historike ose të atyre me vlerë artistike.	Shtimi i një zone të bashkë-shikueshmërisë në të cilën çdo pasuri kulturore do t'i nënshtrohet fillimisht miratimit nga KKTKM. dhe me pas do te	Këto janë kryesisht ndërtesa publike të shkëputura, të identifikuara mirë në planin e planifikimit të qytetit. Ato janë të mirëmbajtura në aspektin arkitektonik. Ka vetëm dy përjashtime, ndërtesa private, të

					Mbrojtje e lartë.	vazhdojë procedurën sipas ligjit të planifikimit Për të kombinuar mbrojtjen e ndërtesës me hapësirën publike të lidhur me të: Bashkia, Gjykata - Sheshi Liria, Hyrja në Port - Sheshi Mujo Ulqinaku, Pallati i Mbretit Zog - Hapësira e Gjelbër	braktisura, të cilat do të kërkonin ndërhyrje publike (shpronësim): pallati i Mbretit Zog dhe Hoteli Vollga
Objektet që duhet të mbrohen	Zona e qytetit	Zonat përkatëse e planit urban	Elementet mbrojtëse në rregulloren ekzistuese	Rekomandime për përshtatje në rregullore	Udhëzime për ruajtjen	Rekomandime për përshtatjen e udhëzimeve	Rekomandime të tjera
Trashëgimia Kulturore e viteve 1950-1970. Pronë publike **Referuar Kartës II**	Qendra e qytetit, Muzeu i Dëshmoreve, aksi kryesor i qytetit	Zona A dhe B: S6, S7, S1				Ndërtesa me vlerë historike dhe artistike për të shmangur rinovimin e papërshtatshëm apo edhe prishjen e tyre. Për të kombinuar mbrojtjen e ndërtesës me hapësirën publike të lidhur me të: Pallati i Kulturës - Sheshi Liria; Muzeu i Dëshmorëve - sheshi, aksi urban i rrugës së Dëshmorëve; Pallati i Sportit – aksi urban i rrugës së Dëshmorëve..	Këto janë objekte publike të shkëputura të ndërtuara në periudhën komuniste, të identifikuara në planin e qytetit si pronë publike, por jo të mbrojtura si ndërtesa. Rekomandohet që këto ndërtesa të përfshihen në listën e monumenteve të mbrojtura në bazë të një përmirësimi sistematik të arkitekturës racionale të viteve 1950 dhe 1970/80.

Trashëgimia kulturore e viteve 1950-1970. Ndërtesa Rezidenciale	Kufiri verior i qendrës së qytetit, aksi i rrugës së Muzeut të Dëshmorëve	Zona A: M2.0	Shikoni më lart: Ka të bëjë me ndërtesën në këndin juglindore midis Rrugës Aleksandër Goga dhe Rrugës së Dëshmorëve	Për konsistencë, do të ishte e parapëlqyeshme të klasifikohej ky grup në zonën A3.2 (më poshtë) *Shihni hartën (3)*		Identifikimi i aksit urban të Rrugës Aleksandër Goga si të tillë dhe Arkitekturës vijuese. Ndërtesat - aksin urban, rrugët dhe hapësirat gjelbëruese që janë gjatësore Mbrojtja e ndërtesave dhe hapësirës publike si trashëgimi kulturore. Referuar Kartës I (4)	Ky komponent është më tipik i planifikimit urban të viteve 50 dhe 70. Prandaj, duhet të regjistrohet me prioritet. Sidoqoftë, ka shumë ndërtesa të ngjashme publike në qytet. Ky është rasti përgjatë rrugës Egnatia, në lindje të qendrës së qytetit. Ka shembuj të tjerë në lagje, por përgjithshëm janë në gjendje të keqe, dhe të vështira për t'u mirëmbajtur.
		Zona B : A3.2	Rezidenciale Tregtare, hotele. Intensiteti i tokës: 2.4 6 nivele. Fasada të vazhdueshme në hapësirën publike. Përkojnë me tipin e ndërtesës				
	Në lindje të stadiumit	Zona B : A3.5	Aktivitet rezidencial Po aty A3.2				Lagje e rëndësishme e përbërë nga ndërtesa kolektive të banesave sociale të organizuara në paralel Nisja e një programi rehabilitimi Shihni hartën (5))
Objektet që duhet të mbrohen	Zona e qytetit	Zonat përkatëse e planit urban	Elementet mbrojtëse në rregulloren ekzistuese	Rekomandime për përshtatje në rregullore	Udhëzime për ruajtjen	Rekomandime për përshtatjen e udhëzimeve	Rekomandime të tjera
Trashëgimi Arkeologjike *Referuar Kartës III*	Zona A			Për çdo ndërtim (shihni më lart), bazamenti i ndërtesës do të duhet të përshtatet, në mënyrë që të sigurojë ruajtjen e rrënojave arkeologjike të zbuluara gjatë gërmimeve			



Figurë 79 –Propozim për të përshtatur rregulloret

Figurë 80 –Masterplan me shtresën e trashëgimisë moderne



Figurë 81 –Masterplan me shtresën e trashëgimisë arkeologjike

E.2.6 Mbrojtja e trashëgimisë të shekullit të 20-të

Ashtu siç u cilësua më parë, në seksionin valorizimit/vlerësimit, trashëgimia arkitekturore nga fillimi dhe fundi i shekullit të 20-të, kontribuon në mënyrë të dukshme karakterin e qytetit të Durrësit dhe është një shënjues i rëndësishëm historik. Edhe pse janë me të vërtetë më moderne, ato përmbajnë vlera kulturore historike, dhe estetike, dhe tregojnë tiparet e pjesës më të madhe të qendrës së qytetit. Krahas kësaj, ndërtesat e fillim shekullit të 20-të dhe rrënojat arkeologjike poshtë tyre, mbeten për t'u zbuluar. Kjo trashëgimi i përfshin të gjitha duke filluar nga ndërtesat popullore, të ndërtuara në shpatet kodrinore, ndërtesat tregtare, objektet rezidenciale.

E.2.7 Zona Arkeologjike Nënujore

Për më shumë se një mijëvjeçar, porti i Durrësit ishte një urë lidhëse mes rrugëve tokësore dhe të detit dhe mes lindjes dhe perëndimit. Burimet arkeologjike nënujore janë të panjohura dhe kërkojnë një mbrojtje shumë të madhe.

Figurë 82 – Një zbulim arkeologjik i kohëve të fundit, nga gjiri i Durrësit

Figurë 83 –Gjetje nga gjiri në pjesën e pasme të muzeut

Kërkimet nënujore arkeologjike, në gjirin e Durrësit kanë filluar në vitet '70 dhe vazhduan deri në mes të viteve '80 nën drejtimin e Muzeut të qytetit. Kërkimet u rifilluan në vitin 2000 dhe vazhdojnë dhe ditët e sotme nën drejtimin e Institutit Arkeologjik të Tiranës. Kërkimet mbulojnë të gjithë vijën bregdetare të qytetit me qëllim identifikimin e portit të lashtë mesjetar. Gjatë kërkimeve, janë gjetur në zonën e Batllës 4 anije të lashta, të cilat i përkasin periudhës nga shekulli i parë para Krishtit, deri në shekullin e 4-të pas Krishtit, një sërë spirancash antike, kategori të ndryshme enësh qeramike (nga periudha arkaike dhe deri në ditët e tona) si dhe objekte të tjera arkitekturore, metale, xham, etj. Zona e vetme e pakontrolluar është zona ku ndodhet porti modern, i cili filloi të ndërtohet në vitin 1920. Ndërtimi i portit shkatërroi të gjithë informacionin arkeologjik në këtë zonë, e cila ishte një nga zonat më të rëndësishme arkeologjike të qytetit.

Rezultatet e këtyre kërkimeve konfirmuan praninë e materialit arkeologjik nga Currilat deri tek Ura e Dajlanit, duke përjashtuar sipërfaqen e shkatërruar të basenit të portit, volumin e madh tregtar të portit gjatë periudhës antike mesjetare. Materiali më i hershëm arkeologjik është gjetur në Batlla, dhe ky fakt krijon hipotezën e ekzistencës së limanit arkaik në këtë zonë. Nuk ka asnjë element arkeologjik

të zbuluar për të mbështetur idenë e pranisë së një porti; përkundrazi, duke vlerësuar drejtimin dhe forcat e erërave mbizotëruese në gjirin e Durrësit, si dhe gjeomorfologjinë e bregdetit të tij konfirmojnë idenë e një porti apo porti natyror, i cili plotëson të gjitha nevojat portuale të qytetit. Kjo nuk përjashton praninë e një ose më shumë skelave prej druri, të nevojshme për përpunimin e mallrave të veçanta. Gjithashtu, nga kërkimet e deritanishme, nuk janë gjetur ambiente depo, kantiere detare apo sende të tjera, të cilat zakonisht gjenden pranë një porti. Duhet të theksohet se në ende nuk kemi një studim të plotë gjeomorfologjik dhe gjeo-arkeologjik që tregon lëvizjen e bregdetit gjatë pesë mijë viteve të fundit. Kemi informacion vetëm për një rritje mesatare indikative të nivelit të detit në mijëvjeçarët e fundit, e konfirmuar edhe nga treguesit arkeologjikë, të cilët gjenden në vijën bregdetare afër qytetit, por që shërbejnë vetëm si një trend dhe nuk janë të aplikueshme për llogaritje të sakta të vijës bregdetare. Prandaj, përveç potencialit të lartë arkeologjik nënujor të vijës bregdetare Batlla - Ura e Dajlanit, duhet të theksojmë se nuk përjashtohet mundësia e madhe e pranisë së rrënojave të anijeve, strukturave portuale, kantiereve të transportit ose depove dhe kampioneve që sot mund të jenë nën tokë. Shembuj të tillë gjenden në Mesdhe, të tilla si në Pisa ose Olbia të Italisë apo Yenikapi të Turqisë.

Çdo herë që është bërë një përpjekje për të konceptuar dhe për të ndërtuar site të mbrojtura arkeologjike në qytet, potenciali arkeologjik nënujor, nuk është marrë kurrë në konsideratë. Duhet theksuar se Shqipëria ka ratifikuar Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore në vitin 2009[47].

Për të mundësuar Zonën e re të mbrojtur të marinës, nevojitet:

a) Zhvillimi i një strategjie që të identifikojë potencialin e zbulimeve të arkeologjisë nënujore.
b) Përfshirja e zonave arkeologjike nëntokësore panë bregut të detit
c) Krijimi i një inventari të arkeologjisë nënujore dhe krijimi i një GIS-I që do të ndihmojë në planifikimet e ardhshme
d) Ndarja e mbrojtjes së arkeologjisë nënujore në dy zona, A dhe B
e) Hartimi i një strategjie të konsoliduar për mbrojtjen
f) Përfundimi i muzealizimit të katit të tretë të Muzeut Arkeologjik të Durrësit, dedikuar arkeologjisë nënujore, për informimin e publikut.
g) Krijimi i një qendre shkencore zhytjeje me personel të kualifikuar nën kujdesin e Institutit të Arkeologjisë që mund të lehtësojë gjithçka që u përmend më sipër.

[47] https://en.unesco.org/countries/albania/conventions

Figurë 89 –Zonat e propozuara të mbrojtura A dhe B për arkeologjinë nënujore

E.2.8 Mbrojtja e zonave periferike

Në antikitet, Durrësi shtrihej në një zonë relativisht të madhe. Qyteti nuk u ekzistonte vetëm nga një strukturë e dendur urban, por në përbërje kishte shume vila periferike, fortifikime dhe gjatë periudhës Mesjetare, edhe bazilika. Megjithëse të gjendura jashtë qytetit, ato karakterizojnë Durrësin. Për mbrojtjen më të mirë të monumenteve dhe për rrënojat arkeologjike që gjenden jashtë qytetit, do të ishte ideale shpallja e disa territoreve si zonë arkeologjike A. Këto zona janë të rëndësishme dhe mund të paraqesin një potencial të rëndësishëm për gjetjet arkeologjike, por për momentin këto zona janë të rrezikuara.

Koncepti arkeologjik i një *polis-i* apo një qyteti antik, shtrihej përtej perimetrit të ngushtë të fortifikimeve të tij. Zgjerim i këtij territori, jashtë qytetit të Durrësit, ka dimensione të ndryshme sipas periudhave të ndryshme kronologjike. Në rastin e *polis-it,* Epidamn-Dyrrachium (Epidamn- Dyrrah), territori ka evoluar gjatë shekujve. Territori origjinal ku shtrihej Durrësi, ndodhej vetëm në një zonë të vogël, të kufizuar nga laguna e brendshme, e cila fillimisht kontrollonte zgjerimin e qytetit. Midis arkeologëve, është pranuar se zona nën kontrollin e Durrësit, në shtrirjen e saj maksimale kufizohej me qytetet e sotme nga Kavaja në jug (me shume mundësi deri te lumi Shkumbin), Tiranën në lindje, dhe deri në lumin Mat në veri. Në ditët e sotme, vetëm një pjese e vogël e këtyre territoreve, është nën administrimin e Durrësit modern. Brenda këtij territori, ka një diversitet të madh arkeologjik nga dëshmitë sipërfaqësore të vendeve të zbuluara deri tek rrënojat, urat dhe kështjellat që tashme janë të dukshme. Shumë nga këto site janë të shpallura Pasuri Kulturore dhe janë të mbrojtura me ligji ndërkohë që të tjerat vazhdojnë të jenë të pambrojtura. Në shumë raste, pavarësisht shpalljes së këtyre siteve si Pasuri Kulturore, ato serish janë të rrezikuara, kryesisht nga zhvillimet ndërtimore. Duke marrë parasysh rëndësinë historike të këtyre monumenteve dhe gjithashtu potencialin e tyre për tërheqjen e turisteve, ato mund të bëhen pjesë e integruar e një koncepti holistik për vizita turistike. Prandaj është e nevojshme, që monumentet e rëndësishme të kufizohen/përfshihen në zonën e mbrojtur A. Kjo do të ndalonte ndërtimet e paligjshme dhe në të njëjtën kohë do të bënte të mundur identifikimin e këtyre ndërtimeve, tashme të përfunduara, përveç rasteve të veçanta, përveç rasteve kur janë të zbatueshme rregulla paraprake të miratuara me ligj. Ky seksion rendit dy lloje sitesh arkeologjike, të cilat meritojnë të përfshihen në Zonën e mbrojtur A, që janë të lidhura ngushtësisht me Durrësin. Disa nga këto site janë të njohura dhe tashmë të dala në dritë, ndërkohë që të tjerat janë akoma të pazbuluara dhe në të njëjtën kohë meritojnë të jenë pjesë e listës së Monumenteve Kulturore.

Këto zona të mbrojtura periferike përfshihen te Shtojcat.

E.2.9 Nominimi i Amfiteatrit në Listën e Pasurive të Trashëgimisë Botërore

Pavarësisht vendimeve të kaluara dhe vështirësitë që çuan në refuzimin e amfiteatrit në të kaluarën, ishte e qartë nga shumë palë të interesuara, përfshirë këtu dhe Ministrinë e Kulturës, që qëllimi ishte të nominohej sërish.

Siç u përmend dhe më sipër, ky proces është plot me vështirësi dhe duhet të ndiqet në bazë të një qasjeje afatgjatë. Udhërrëfyesi vijues është nxjerrë dhe marrë në formë të shkurtuar nga Udhëzimet Operative të Konventës së Trashëgimisë Botërore. Direktivat e Udhëzimeve Operative në këtë udhërrëfyes **janë zgjeruar me direktiva shtesë që nuk përfshihen në këto udhëzime.**

1) **Sigurimi që Amfiteatri të mbetet në Listën e Provës.** Kjo është një kërkesë absolute dhe duhet të rinovohet çdo dhjetë vjet. Kuptohet që ky rinovim nuk është realizuar në më shumë se një dekadë. Ky duhet të jetë hapi i parë si fillim.

2) **Përgatitja e dosjes së nominimit**

   a. MK të rishikojë udhëzimet për dosjen e nominimit
   b. Krijimi i komitetin të nominimit të ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë nga ICOMOS, dhe organe të tjerë.
   c. Mbledhja e dokumentacionit, hulumtimet dytësore dhe parësore, duke përfshirë inspektimet e kaluara të ICOMOS-it, raportet arkeologjike, zhvillimin e intervistave.
   d. Është e domosdoshme që të zhvillohet një sondazh shumë i saktë i pikave koordinuese dhe një zone tampon. Kjo është një arsye e zakonshme për refuzimin që në fillim, gjatë shqyrtimit të parë nga Qendra e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.
   e. Dokumenti draft për të justifikuar VJU-në, integritetin dhe autenticitetin
   f. Kontakti dhe sponsorizimi i Misionit Këshillues të UNESCO-s/ICOMOS për vizitë, vlerësim, mendim. Ky hap është thelbësor pasi është e nevojshme të ndërtohet mbështetja dhe lobimi për nominimin shumë vite përpara dorëzimit të dosjes së nominimit.

3) **Duhet të jetë një ftesë zyrtare e Shtetit Palë.** Nëse ka një mendim të favorshëm nga Misioni Këshillues, atëherë procesi i nominimit duhet të vazhdojë. Nëse nuk ka një mendim të favorshëm, procesi duhet të ndalet.
4) **Formati dhe përmbajtja e dosjes së nominimit** Dosja e nominimit DUHET të jetë e plotë dhe të mos plotësohet me nxitim. Ka shumë shqyrtime fillestare nga Qendra e Trashëgimisë Botërore, por pasi ata të bëjnë rekomandimin e tyre për Komitetin e Trashëgimisë Botërore, një refuzim është i prerë dhe amfiteatri nuk mund të nominohet sërish.

   a. Identifikimi i Pronës
   b. Përshkrimi i Pronës
   c. Arsyetimi për regjistrimin në listë
   d. Gjendja e ruajtjes dhe faktorët që ndikojnë në pronë
   e. Mbrojtja dhe menaxhimi (Plani i Menaxhimit posaçërisht për Amfiteatrin)
   f. Monitorimi
   g. Dokumentimi
   h. Kontakti i autoriteteve përgjegjëse
   i. Nënshkrimi në emër të shtetit palë

5) **Regjistrimi i nominimit**
   a. Sekretariati do të konfirmojë marrjen

6) **Dorëzimi në Komitetin e Trashëgimisë Kulturore Botërore**
7) **Vazhdoni përpjekjet lobuese për anëtarët e Komitetit TB, Qendra e Trashëgimisë Botërore, UNESCO, ICOMOS.** Kjo përfshin misione në Paris, ftesa për anëtarët kryesorë për të shpjeguar VJU-në e Amfiteatrit.
8) **Vlerësimi zyrtar i nominimit nga organet këshillimore**

   a. Shqyrtimi i dokumentacionit (vlerësuesit e dokumentacionit që janë të njohur me sitin dhe situatën studiojnë nominimin dhe rekomandojnë nëse procesi duhet të vazhdojë)
   b. Vizitë zyrtare (e paparalajmëruar dhe inspektimi kryhet pa njoftuar Shtetin Palë për vizitën)

9) Rekomandim për Komitetin e Trashëgimisë Botërore për regjistrimin në listë ose refuzimin Shteti palë mund të tërheqë nominimin në çdo kohë. Vendimi i Komitetit të Trashëgimisë Botërore është përfundimtar: regjistrimi, refuzimi, shtyrja.

Si një alternativë për nominimin e amfiteatrit, ekziston mundësia për të nominuar Rrugën Egnatia në Listën e Trashëgimisë Kulturore Botërore, si një nominim transkombëtar në seri. Një nga rrugët më të mëdha në Botë. Nëpërmjet saj, Roma dhe Perëndimi ishin të lidhur me Bizantin dhe Lindjen, ishte rruga e Apostullit Pal në misionin e tij të 2-të, e Jul Çezarit dhe Pompeit, Mark Antoni dhe Oktaviani ndoqën Kasiunin dhe Brutusin. Janë tashmë pesë prona ekzistuese të Trashëgimisë Botërore së bashku me itinerarin dhe të paktën katër zona në Listën Provë, duke përfshirë Apoloninë, Selanikun, Filipin dhe Stambollin. Dhe rruga nisi në Durrës. Durrësi dhe Amfiteatri i tij do të përfshiheshin në këtë nominim. Afër Kullës Veneciane, u bë një zbulim për fillimin e mundshëm të Rrugës Egnatia. Strukturat shihen nën ndërtesën e madhe, me një portë, e cila ishte pjesë e një portiku monumental të kombinuar me një portë monumentale nga e cila u nis Via Egnatia. Kjo do të përfshinte shqyrtimin e nominimit, dokumentimit të pasurive. Organizoni një konferencë ndërkombëtare për nominim ndërkombëtar në seri të itinerarit. Kërkimi i ndihmës nga donatorëve kombëtarë për të ndihmuar në drejtim të këtij nominimi, duke përfshirë kombet e Turqisë, Greqisë dhe Italisë. Kjo do të përfshijë site të tjera në Shqipëri, të tilla si Apollonia dhe Butrinti.

E.2.10 Plani i Menaxhimit të Riskut

Plani i Menaxhimit të Riskut (PMR) synon të forcojë sigurinë dhe mbrojtjen e qytetit nëpërmjet ndërhyrjeve për parandalimin dhe zbutjen e riskut. Krijimi i një Plani të detajuar të Menaxhimit të Riskut është jashtë fushës së PM-së; megjithatë, kjo çështje e rëndësishme duhet të trajtohet brenda PM-së. Ky seksion ofron rekomandime për të forcuar kapacitetet dhe zbatimin aktual të masave të menaxhimit të katastrofave dhe hartimin përfundimtar të PMR-së. Rekomandimet duhet të drejtohen për të trajtuar shkaqet (d.m.th., parandalimin e riskut nga katastrofa) dhe pasojat (d.m.th, zbutjen e katastrofës) e rreziqeve të identifikuara të katastrofës. Rekomandimet përkthehen në një listë projektesh që mund të zbatohen veçmas në PMR, dhe mund të sigurojnë rritjen e nivelit të sigurisë dhe sigurimit të Durrësit. Rekomandimet janë grupuar në kategori qeverisjeje, financimi për riskun, ligjore, dhe operative.

Qeverisja

- Organizimi i konsultimit/konferencës vjetore me aktorët për rehabilitimin e ndërtimit të Durrësit me qëllim diskutimin dhe identifikimin e strategjive dhe zgjidhjeve optimale për rreziqet ekzistuese dhe të shfaqura të katastrofave në qytet.
- Plani i Menaxhimit të Riskut[48] duhet të hartohet duke marrë parasysh kërkesat e Ligjit 45/2019 Për Mbrojtjen Civile.
- Ngritja e tri ekipeve ekspertësh për të përcaktuar faktorët kryesorë të riskut nga katastrofa në Durrës: (a) tërmeti, (b) siguria dhe (c) risku nga katastrofat e shkaktuara nga klima. Drejtimi dhe lehtësimi i diskutimeve brenda këtyre ekipeve për të krijuar mirëkuptimin dhe përparësinë

[48] Në planin e menaxhimit të riskut, duke pasur në konsideratë metodat e vjetra të ndërtimit, heterogjenitetin e llojeve të ndërtimit në këto zona dhe ekzistencën e kufizimeve mbrojtëse që pengojnë zbatimin e masave të sigurisë nga zjarri, nevojitet një trajtim specifik lidhur me sistemet pasive dhe aktive të mbrojtjes nga zjarri, duke garantuar një klasë minimale të rezistencës ndaj zjarrit prej 30 minuta për ndërtimet mbi tokë dhe 60 minuta për ndërtimet nën tokë.
Gjithashtu, duhet të parashikohet edhe skenari i përhapjes së një zjarri, si rrjedhojë e pranisë së shkallëve të hapura dhe komunikimeve vertikale në zonën arkeologjike.

e rrjedhës së veprimeve, trajtimin e nevojave ekzistuese dhe atyre që shfaqen në çdo zonë me përparësi.

Aktet Ligjore

- Rishikimi i strategjive kombëtare të zhvillimit, planet e veprimit dhe programet për të rekomanduar se si mund të integrohen dhe trajtohen sa më mirë nevojat për zbutjen e rreziqeve në Durrës.
- Ndryshimet ligjore që të gjitha pronat publike, duke përfshirë vendet arkeologjike (p.sh. muzetë, pronat e ministrive, etj.) të kenë plane emergjence, duke përfshirë një plan evakuimi të aprovuar zyrtarisht.
- Sigurimi që përpjekjet për zvogëlimin e riskut nga katastrofa të jenë pasqyruar sa duhet në legjislacion . Nëse është e nevojshme, të propozohen amendime ligjore **Financimi për Riskun**
- Për sa kohë nuk ka fonde të caktuara për aktivitetet e lidhura me riskun nga katastrofat dhe ka kufizime të forta financiare në të gjitha agjencitë qeveritare, duhet të kryhet një studim për të parë opsionet e financimit për riskun nga fatkeqësitë dhe të propozohen rekomandime të mundshme.
- Sigurimi për fonde të destinuara për aktivitetet e menaxhimit të riskut nga katastrofat brenda PM-së.

Operative

- Sigurimi që të gjitha pronat me vlera të jashtëzakonshme trashëgimie kulturore të jenë vlerësuar për riskun nga tërmeti.
- Hartimi dhe implementimi i aktiviteteve specifike (domethënë të përshtatura për vetë nevojën e pronës) për zbutjen e riskut nga tërmetit për secilën pronë me vlerë të trashëgimisë së Durrësit.
- Organizimi i seminareve për vendimmarrësit (ekspertë, politikëbërës, përfaqësues të ministrive të ndryshme dhe organizatave joqeveritare) për të rritur ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në përgjithësi dhe vlerën e shtuar të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë.
- Organizimi i stërvitjeve gjashtëmujore në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha agjencitë përkatëse, me mënyra reaguese për skenarë të ndryshëm (p.sh., ngjarje sizmike gjatë mbledhjeve masive, zjarr në një nga pronat e trashëgimisë kulturore, përmbytje në një nga gërmimet arkeologjike, etj.).
- Zhvillimi i një plani evakuimi për tubime masive. Kjo kërkon veprime të koordinuara midis organeve të ndryshme (p.sh., policia, zjarrfikësit, ambulanca) si dhe autoriteteve kombëtare dhe lokale (p.sh., ministria e transportit, etj.). Plani i evakuimit duhet të përfshijë, ndër të tjera, mjetet e transportit, kapacitetet ekzistuese dhe ato që mungojnë të organeve përkatëse, linjat e përbashkëta të komunikimit, mekanizmin e koordinimit për të cilin është rënë dakord dhe rendin e komandës, etj.
- Hartimi dhe implementimi i një fushate të gjerë të ndërgjegjësimit të publikut për të siguruar vlerësimin dhe mbështetjen e kulturës së sigurisë dhe mbrojtjes në mesin e popullatës lokale.
- Organizimi i ngjarjeve, programeve sensibilizuese për shkollat. Zhvillimi i iniciativave për sigurinë dhe mbrojtjen, organizimi i aktiviteteve lehtësuese, etj.

Shkrimi i një Plani Menaxhimi të Riskut duhet të zhvillohet për Durrësin dhe zonat e tij arkeologjike. Kjo do të ndihmojë qytetin, Ministrinë e Kulturës, Bashkinë etj i për të përgatitur dhe zbutur rreziqet natyrore dhe artificiale ndërkohë që planifikohet rimëkëmbja.



Figurë 84 – Tërmeti në Shqipëri godet zonën me rrezikshmërinë më të lartë në Ballkan, nëntor 2019 (Temblor)

E.2.11 Sistemi I Informacionit Gjeografik

Menaxhimi i qyteteve komplekse kërkon të dhëna për të marrë vendime të informuara. Prandaj, kërkohet krijimi i një Sistemi të Informacionit Gjeografik (GIS). Gjatë krijimit të PM-së u bë e dukshme mungesa e të dhënave. Misioni arkeologjik francez/shqiptar nuk i ndau të dhënat e tij, misioni arkeologjik italian/shqiptar ishte i vjetruar, bashkia kishte të dhëna vetëm në formatin statik PDF,

GIS është vendosur në mënyrë të përshtatshme në gjeoportalin e qeverisë shqiptare, kjo agjenci ka aftësi teknike, por objektivi i saj është i gjithë territori i vendit. Ndërsa ajo ka të dhëna të trashëgimisë kulturore, këto të dhëna janë në nivel makro me të dhëna pikë. Agjencia duhet të angazhohet për të ofruar shërbime që mbrojnë trashëgiminë kulturore të qytetit në një nivel më makro, me të dhëna specifike nga Ministria e Kulturës. Duhet të ketë gjithashtu aftësinë për t'i shkarkuar këto të dhëna nga agjencitë dhe konsulentët e miratuar për të punuar me informacionin.





- Layer Available = nuk mund të përdoret brenda ArcGIS
- Layer Not Available = nuk mund të përdoret brenda ArcGIS,
  por të dhënat mund të vizualizohen në një ËebGIS.
- Layer Available për blerje ose lidhje ËMS.

Disponueshmëria e Shtresave dhe GIS

Figurë 85 –Platforma GIS

Për më tepër, për të optimizuar menaxhimin e të gjitha të dhënave të mbledhura, ekipi implementoi një platformë GIS e cila duhet të përdoret për fazat pasardhëse të PM-së (implementimi, monitorimi dhe rishikimi). Platforma GIS mund të plotësohet më tej me të dhënat që lidhen me gërmimet e vjetra/ndërhyrjet për konservim dhe të dhënat e reja tematike për planifikimin e ndërhyrjeve të ardhshme. Nxjerrja e hartave tematike është bërë duke interpoluar të dhënat e rëndësishme përkatëse për secilin qëllim. Ky instrument do të përfshijë aplikacione për të monitoruar performancën e PM-së gjatë zbatimit.

Fatkeqësisht, mungesa e të dhënave GIS nga misioni arkeologjik shqiptaro/francez (MASHF) krijoi një pengesë për krijimin e një GIS-i koherent. Misioni pretendoi të drejtën e autorit dhe nuk lejoi që ekipi i PM-së të përdorte ose integronte informacionin e tyre në një Platformë GIS. Informacioni përkatës i gjeoreferencuar nuk është përfshirë. Ekipi i PM-së e kapërceu këtë ngërç duke mbledhur informacionin e duhur duke shtruar të dhënat dhe bibliografinë përkatëse, si dhe një hartë arkeologjike tematike që përfshin vendndodhjen e përafërt të shtatë siteve të gërmuara. Sidoqoftë, grupi i PM-së duhet t'u rekomandojë institucioneve kulturore shqiptare (MK dhe IA) të përmirësojnë kornizat e tyre kontraktuale me secilin mision arkeologjik dhe të përpiqen të ndajnë të gjithë informacionin e mbledhur. Përkundër kësaj përpjekjeje, jo të gjitha të dhënat arkeologjike gjenden në GIS-in e PM-së, pasi ka shumë site të panjohura për arkeologët dhe sepse ka shumë raporte të gërmimeve që u mungojnë të dhënat. Për këtë arsye, ka informacion të paplotë për gërmimet e njohura të së kaluarës, por me vendndodhje të panjohur.

Figurë 86 –Një shembull i platformës GIS, krijuar për të njohur qytetin e Durrësit, trashëgiminë e tij kulturore dhe kontekstin urban

Referencat ndërmjet objektivave dhe veprimeve

Për të integruar tri objektivat kryesore, ky seksion kryqëzon referencat dhe forcon integrimin e PM-së. Lidhjet midis objektivave dhe veprimeve përshkruhen shkurtimisht më poshtë.

- Miratimi i PM-së do të drejtojë projektet aktuale dhe të ardhshme të konservimit të përmendura në objektivin e mëparshëm.
- Projektet afatshkurtra të konservimit dhe vizitat e shtuara do të sjellin një vetëdije më të madhe për trashëgiminë kulturore të qytetit dhe kështu do të detyrojnë autoritetet e qytetit dhe MK-të të zbatojnë rregulloret ekzistuese dhe të inkurajojnë rregulloret e reja.
- Projekti TID në Rrugën e Tregtarëve, veçanërisht puna në fasada, do ta lejojë qytetin të rivlerësojë përpjekjet për të përditësuar Udhëzuesin e Ruajtjes në Master Plan.

E.3 Përmirësimi i menaxhimit, përdorimit dhe vlerësimit

E.3.1 Qasje

Përmirësimi i përdorimeve të siteve kulturore të Durrësit është një operacion kompleks që kërkon disa veprime në periudha afatshkurtra dhe afatgjata të ekzekutuara nga një larmi agjencish. Kjo përfshin projekte të shumta të përshkruara më herët, siç janë Zona e Përmirësimit Turistik (TID) aktualisht në zhvillim, projektet kulturore emergjente të UNOPS-it dhe puna e vazhdueshme dhe e planifikuar nga Ministria e Kulturës.

Vlerësimi është përpjekja për të zhvilluar trashëgiminë kulturore të qytetit, për të shtuar vlerën dhe statusin nëpërmjet veprimeve të organizuara. Vlerësimi është një nga objektivat kryesore strategjike (OKS). Për secilin OKS, është përcaktuar një grup i përcaktuar një ose shumë veprimesh. Pavarësisht nëse ndiqet një qasje e ngushtë ose e gjerë, procesi i vlerësimit duhet të paraprihet nga segmentimi i kërkesës turistike dhe nga pozicionimi i ofertës për të përmbushur nevojat e secilit segment të synuar.

Prandaj, PM ofron vlerësime për kërkesën potenciale, e cila do të përfshihet në Planin e Veprimit përpara paraqitjes së ndërhyrjeve të valorizimit.

Është e qartë se sitet arkeologjike duhet të jenë pjesë e jetës së banorëve, studentëve dhe fëmijëve, ndërsa gjenerojnë të ardhura shtesë, me përgjegjësi, për ruajtjen, prezantimin, edukimin, përdorimin dhe qasjen e qëndrueshme.

Ky përdorim dhe vlerësim i shtuar mund të përshkruhet nëpërmjet disa veprimeve strategjike.

- Analiza e kërkesave të turizmit
- Fillimi i një plani për gjenerimin e të ardhurave
- Përzgjedhja e një modeli të ri qeverisjeje pas një hetimi
- Krijimi i një fondacioni të ri për menaxhimin e përditshëm
- Krijimi i një programi për zhvillimin e turizmit kulturor me kontribut për Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit

E.3.2 Analiza e kërkesës për turizëm

Një nga aspektet e para të valorizimit është tërheqja e vizitorëve me trashëgiminë kulturore të Durrësit. Kjo kërkon të kuptuarin e vizitorëve dhe një analizë të kërkesës aktuale turistike për të vlerësuar kërkesën në të ardhmen. Qëllimet kryesore mund të përfshijnë një përzierje të segmenteve kryesore si vijojnë:

- **Turizmi vendas** i përbërë nga turistë shqiptarë, përfshirë shkollat, nga zona e Durrësit ose qytete të afërta si Tirana;
- **Turizmi i kohës së lirë**, i përbërë nga turistë rajonalë që vizitojnë ose qëndrojnë në Durrës për aktivitete çlodhëse (kryesisht dielli dhe rërë), të cilët shfrytëzojnë rastin të vizitojnë vendet e trashëgimisë kulturore ose të marrin pjesë në aktivitetet e tyre si ekskursionet lokale. Një grup i tillë përfshin, gjithashtu, ekskursione të mundshme të ndërmarra nga turistët që lundrojnë dhe që bëjnë ndalesa në portin e Durrësit;
- **Takime, nxitje, konferenca, ngjarje ose turizëm MICE** që përbëhet nga udhëtarë për qëllime biznesi ose pjesëmarrës në konferenca;
- **Turizmi për festa të ndryshme dhe festivale, turizëm i cili tërheq vizitorët si spektatorë të eventeve ditore ose atyre të natës që mund të zhvillohen në Amfiteatër;**
- **Turizmi Kulturor**, që përfshin:
    - Turistët që bëjnë vizita njëditore në Durrës si pjesë e një itinerari më të gjerë kulturor në Shqipëri;
    - Turistë që vijnë me qëllimin kryesor për të vizituar vendet e trashëgimisë kulturore ose për të marrë pjesë në aktivitete kulturore. Këto grupe mund të ndahen në kategori të tjera nën-kulturore.

a) Turizmi vendas

Kërkesa lokale përbëhet nga banorët shqiptarë. Një kërkesë e tillë mund të jetë e arsyeshme, pasi vetëm Durrësi është qyteti i dytë më i madh, me një popullsi prej rreth 130 mijë banorë[49], me të gjithë rrethin (duke përfshirë qytetet si Kruja dhe Shijaku) që zënë mbi 290 mijë njerëz[50].

[49]Burimi: http://popolazione.population.city/albania/Durrës/
[50]Burimi: https://www.albanianews.it/statistiche/instat-tirana-durazzo-province-popolate-albania

Rrethet Shqiptare	Popullsia
Tiranë	906.166
Durrës	290.697
Fier	289.889
Elbasan	270.074
Korçë	204.831
Shkodër	200.007
Vlorë	188.992
Lezhë	122.700
Berat	122.003
Dibër	115.857
Kukës	75.428
Gjirokastër	59.381

Figurë 87 –Popullsia e rretheve shqiptare

Rrethi i Durrësit është natyrshëm origjina kryesore potenciale e kërkesës lokale. Është gjithashtu interesante të merret parasysh se shtimii popullsisë së Durrësit është rritur nga 66.2 mijë në 1979 në 82.7 mijë në 1989, 99.6 mijë në 2001 dhe 113.2 mijë deri në 2011. Edhe pse regjistrimi i ri është shtyrë për shkak të pandemisë së COVID-19-ës, nëse marrim parasysh shkallën e rritjes së popullsisë 2001-2011 (1.3% në vit), atëherë duhet të ketë një popullsi afërsisht 130 mijë banorë.



Figurë 88 –Popullsia e Durrësit

Qytetet e tjera, veçanërisht kryeqyteti Tiranë, padyshim kontribuojnë në kërkesën lokale, duke pasur parasysh afërsinë e tij dhe prirjen e familjeve për të pasur shtëpi të dyta pranë bregdetit. Ky faktor është pjesërisht përgjegjës për pjesëmarrjen ekzistuese dhe të ardhshme në përvojën e trashëgimisë kulturore të Durrësit. Kjo varet nga rrethanat personale dhe shoqërore, si dhe nga faktorët e mundësive që përfshijnë aspekte të tilla si:

- Distanca fizike
- Transporti dhe lehtësia e aksesit, i cili është një efekt i kombinuar i elementeve të tilla si disponueshmëria, frekuenca, mënyra, kostoja dhe komoditeti

- Konkurrenca e siteve të tjera kulturore ose e qendrave të tjera më të afërta të kalimit të kohës së lirë që justifikojnë udhëtimet
- Tërheqjet plotësuese ose vendet ku mund të kalohet koha e lirë që kujdesen për preferencat e ndryshme
- Veçantia e ofertës që justifikon udhëtimin
- Plotësimi i kërkesave specifike
- Ndjeshmëria ndaj kostos
- Përpjekjet për promovim dhe marketing

b) Turizmi i kohës së lirë

Të dhënat bazike turistike janë të siguruara dhe të shpjeguara më lart në PM. Pandemia e Covid-19- ka pasur një ndikim shumë të madh në sektorin e turizmit Shqiptar, i cili në tërësi, varet thellësisht nga udhëtimet e huaja brenda shtetit. Në lidhje me perspektivat e së ardhmes dhe pavarësisht se të dhënat nga viti 2020 nuk ekzistojnë, një hamendësim i arsyeshëm mund të bëhet duke e krahasuar me mesataren Evropiane. Ky krahasim tregon për një ulje të theksuar prej 70% në krahasim me prurjet e vitit të kaluar[51]. Një vlerësim për një rimëkëmbje të rritjes pas vitit 2021, parashikon një rikthim në nivelet e vitit 2019, mes viteve 2023 dhe 2024. Modeli pas vitit 2024, ndërsa vijon rritja e përgjithshme, parashikon një rënie progresive e ritmit të rritjes nga vitit në vit. Është e rëndësishme të evidentohet që kjo rritje mund të ndikohet nga disa variabla, të brendshmet dhe ato të jashtmet, nga të cilat jo më pak e rëndësishmja është disponueshmëria e akomodimeve. Mund të supozohet që ritmi i rritjes së turizmit në Durrës do të jetë i njëjtë me atë të rritjes internacionale.



Figurë 89 –Turistet ndërkombëtare që hynë në Shqipëri. Vitet 2007-2030. (Vlerësimi i konsulentit)

c) Takimet, Nxitje, Konferenca, Evente ose turizmi i MICE-së

Ky lloj turizmi zakonisht quhet turizëm biznesi ose industri takimesh. Ai përfshin evente ose ekspozita, nxitje nga kompanitë për të arritur qëllimet e përcaktuara, madje edhe turizmin arsimor. Eventet MICE zakonisht përqendrohen rreth një teme, trajnimi ose grupi biznesi. Ky është një komponent i rëndësishëm i turizmit sepse grupet janë përgjithësisht të mëdha, rezervojnë blloqe të mëdha hotelesh dhe restorantesh dhe udhëtojnë së bashku. Shpesh këto janë ekskursione kulturore ose udhëtime studimore. Ky lloj turizmi ka marzh më të lartë fitimi dhe i ofron përfitime thelbësore qytetit pritës. Procesi i marketingut zakonisht kryhet nga qyteti pritës shumë përpara eventit dhe ka disa

[51]UNWTO (2020). "International Tourism Down 70% as Travel Restrictions Impact All Regions". *News Release*, 27 October, in https://webunwto.s3.eu-west-1.amazonaws.com/s3fs-public/2020-10/201027-barometer-en.pdf

komponentë të rëndësishëm siç janë disponueshmëria e akomodimit, e ambienteve të përcaktuara për konferencat dhe takimet, dhe mundësia e tërheqjeve dytësore të tilla si plazhi, argëtimet e tjera ose aktivitetet kulturore.

Ky lloj turizmi nuk ekziston aktualisht në Durrës. Nuk ka programe të parashikuara konferencash ndërkombëtare në Durrës për të gjithë periudhën nga 2021 deri në 2022. Kjo është e kuptueshme pasi pandemia globale e ka ndërprerë këtë lloj udhëtimi në të gjithë botën, por ky lloj turizmi nuk ekzistonte as më parë. Turizmi rajonal ose lokal i MICE-së ishte gjithashtu i kufizuar. Kjo ka të ngjarë të jetë për shkak të disa faktorëve:

- Mungesa e një qendre të madhe konferencash (aktualisht, hotelet janë ambientet e vetme që e ofrojnë këtë mundësi)
- "Vdekja" e marketingut dhe e promovimit nga bashkia dhe mungesa e një zyre konferencash.
- Konkurrenca nga Tirana, e cila ofron ambiente më të mëdha dhe të pajisura më mirë

Ndërkohë që kjo mund të cilësohet si shkurajuese, duhet të shikohet si një mundësi për të rritur turizmin e MICE-së. Trashëgimia kulturore, veçanërisht ambientet në Amfiteatër, mund të shihet si tërheqje për këtë lloj turizmi.



Figurë 90- Njoftimet për të gjitha konferencat, konferencat ndërkombëtare (ëëë.allconferencealert.com)

d) Eventet dhe turizmi i festivaleve

Ky segment i tregut, është pjesërisht i ri për qytetin e Durrës-it, i cili ka organizuar disa evente të vogla kulturore në hapësirën e Amfiteatrit, që e kanë fillesën në vitet 2000. Tashmë, sidoqoftë, ky ambient mund të propozohet për organizimin e disa eventeve të shënuara, evente këto, të cilat mund të jenë periodike, të karakterizuara nga kërkesa e lartë nga turistët, si dhe nga kostoja e lartë, të shoqëruara nga evente lokale dhe rajonale (periodike dhe unike, të karakterizuara nga një kërkesë më e ulët por e shpërndarë përgjatë gjithë vitit). Ndërkohë që të parat, mund të jenë me interes kombëtar dhe kanë gjasa të mëdha të tërheqjes së audiencave internacionale (p.sh. Festivali Internacional i Durrës-it), këto të fundit do t'i shërbenin më shumë nevojave të turizmit të pushimit (siç janë p.sh. plazhet). Kjo mund të ofrohet nga disa formate të standardizuara, ndërkohë që u ofrohet një platformë skenike artistëve dhe muzikantët shqiptarë.

Figurë 91 –Tipologjitë e eventeve që mund të realizohen në Amfiteatër

e) Turistët Kulturorë

Turistët Kulturorë janë ata turistë të cilët, vijnë në Durrës me synimin e vetëm, zakonisht të shprehur e të qartë, për të vizituar vendet e trashëgimisë kulturore. Pavarësisht nëse qëndrojnë një natë apo jo, do të numërohen si turistë formalë, sipas statistikave të UNËTO-së. Sidoqoftë, shumica qëndron vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, aq sa duhet për të vizituar të gjitha sitet arkeologjike. Kjo mund të zgjerohet dhe në këtë mënyrë të përfshijë, për shembull, ture këmbësore përgjatë rrugës Egnatia ose ture lundrimi. Siç tregohet dhe nga ky hulumtim, këto kategori nuk përbëjnë shumicën, kjo për faktin se turistët kulturorë janë më shumë të nxitur nga kërkimi i eksperiencave të reja, mundësitë për pushime të shkurtra, ose thjesht nga kurioziteti. Duke folur në mënyrë të përgjithshme, vizitorët e siteve të trashëgimisë kulturore, mund të ndahen në 5 seksione, përkatësisht: Kërkuesit e Eksperiencave, Kërkuesit e Faciliteteve, Eksploruesit; Profesionistët/ata që e kanë pasion këtë, Recharger (ata që kërkojnë të kenë eksperienca të plota)[52], identitetet e të cilëve, motivimet dhe pritshmëritë janë të listuara në tabelën e mëposhtme.

Seksioni	Kush janë	Të motivuar nga	Kërkojnë
Kërkuesit e eksperiencave	Grupe të rriturish Ture të organizuara Vizitorë të huaj Çifte të rinjsh në udhëtime të shkurtra	Jo të shndërrohen në ekspertë, por të kenë një eksperiencë të paharrueshme – Për të krijuar kujtime	Orientim të mirë, përndryshe vetëm bëjnë ecje dhe/ose ndjekin turmat Leximi i "Guide to the Museum's Best," dizenjuar për të theksuar dhe për të interpretuar në mënyrë sa më të përshtatshme ekspozitat e muzeut Të pasurit e një pamje të përgjithshme të vendit, dhe jo një të kuptuar më të thellë Aplikacione që japin pamjen e gjerë dhe disa fakte të përgjithshme-jo detaje të theksuara Gjetja e lehtë e shërbimeve higjienike dhe kafeneve Bërja e sa më shumë fotove, ngulitja në kujtesë e kësaj eksperience të rëndësishme gjithashtu dhe për të tjerët, në vendin nga vijnë Dyqani i suvenireve si një nga aspektet më të spikatura të një vizite
Kërkuesit e faciliteteve	Prindërit me fëmijët Grupe shokësh të drejtuara nga një person me më shumë eksperiencë Grupe studentësh	Duke mbështetur atë që është më e rëndësishme për të dashurit e tyre apo për ato që i shoqërojnë	Mbajtja të zënë, stimulimi dhe angazhimi i fëmijëve Vend edukimi/evente për t'u përfshirë në përvoja kuptimplota shoqërore Guida familjare, shënjues dhe programe të orientuara të krijuara posaçërisht për ta Sinjale që tregojnë për atraksione për fëmijët Shfaqje, ku përfshihen dhe fëmijët si vullnetarë

[52]Falk J. H. (2009). *Identity and the Museum Visitor Experience.* Walnut Creek, CA:Left Coast Press

			Shërbime ushqimi dhe shërbime higjienike Dyqane suveniresh dhe kafene, të cilat përdoren përpara largimit-si një lloj përmbyllje e këndshme e një dite të kaluar kënaqshëm Blerja e librave edukues, lojërave, ose e lodrave prej pelushi për të nxitur eksperiencën edukuese nëpër shtëpi/shkolla Aplikacione dhe mjete të tjera të realitetit
Eksploruesit (kuriozët)	Së bashku me turistët kërkues të eksperiencave, këta përbëjnë numrin më të madh të vizitorëve kulturorë Mund të bëhen profesionistë/pasionantë	Vende/evente sfiduese për nga karakteri intelektual, që kanë potencialin për të kënaqur kuriozitetin dhe interesin personal në një fushë specifike kulturore	Ekspozita jo të zakonshme apo të përshkruara Jo shumë mbështetje orientuese apo dhe udhëzuese Tabela, broshura dhe udhëzues për të arritur të mësuarit e Objektivave Mjetet e shtuara të realitetit Teknologji të reja që ofrojnë zgjedhje dhe kontroll për sa i përket kontekstit Jo shumë suvenire Libra në lidhje me temën e ekspozitës së muzeut ose diçka më thelbësore
Profesionistët /ata që e kanë pasion	Vizitorë të specializuar Vizitorë të rregullt Vizitorë të lidhur vërtetë me kulturën Në atraksionet e mëdha, janë zakonisht 5%e totalit të vizitorëve	Për kryerjen e një pune apo të një detyre, jo për kënaqësi vetjake	Asnjë mjet interpretues si p.sh ture, aplikacione ose broshura, por modeli i vjetër i ruajtjes vizuale Ture apo vizita të veçanta(behind the scenes) Ndërveprimi i drejtpërdrejtë me ekspertët e stafit të muzeut Libra të thelluar për temën e interesit, materiale referimi dhe libra ose pajisje të specializuara që nuk mund të gjenden diku tjetër
Recharger	Zakonisht banorët e vendeve afër	Gjetja e një cepi të qetë dhe estetikisht të këndshëm ku mund të pushohet Marrja e ushqimit shpirtëror dhe jo fizik ose tregtar	Një vend i qetë ku mund të pushojnë pa u shqetësuar - një vend ku mund të rikarikojnë bateritë e telefonave/pajisjeve të tyre Përvoja të veçanta Ushqime dhe pije në kafene për të përmbushur standardet e tyre të larta estetike

Figurë 92 –Seksionet Kulturorë, motivimi, dhe pritshmëritë

Këto kategori nuk janë ekskluzive të turistëve kulturorë, gjithashtu, janë të lidhura me kërkesën lokale dhe mund të mbivendosen me kategori të tjera si p.sh., turistët që zgjedhin plazhin. Interesante është përputhja e këtyre kategorive me tre segmentet kryesore që janë identifikuar.

Kërkuesit e eksperiencave janë kategori e mundshme kulturore e cila është e përbashkët për të tri kategoritë kryesore. Të ndjekur nga Eksploruesit, megjithëse do të kishte më pak gjasa që ata të gjendeshin midis turistëve të plazhit, për të cilët mund të supozohet se tërhiqen më shumë nga përvojat hedoniste (përvoja që u ofrojnë kënaqësi), siç janë eventet e natës në Amfiteatër.

Kërkuesit e faciliteteve përfshijnë kryesisht shkollat, të cilat mund të jenë një segment i rëndësishëm, veçanërisht për Muzeun Kombëtar Arkeologjik, nëse ai është i pajisur me shërbime dhe infrastruktura të përshtatshme.

Profesionistët/ata që e kanë hobi, në përgjithësi, përfaqësojnë një pjesë të vogël të kërkesës totale. Meqenëse, ndërmjet muzeve kombëtare, muzeu i Durrësit është i vetmi i pajisur për të paraqitur periudhën e Greqisë së Lashtë, periudhat Romake dhe Mesjetare; ka potencial për tërheqjen e ekspertëve kombëtare dhe ndërkombëtare, gjithashtu dhe të misioneve shkencore.

Së fundmi, nëse një vend i tillë si Muzeu Arkeologjik i Durrësit do të pajiset me një kafene arti, të vendosur në tarracë, ai mund të bëhet një pikëmbërritje lokale për Rechargers, siç dëshmohet nga përvojat e ngjashme në të gjithë botën.

Kategoritë Kulturore	Kategoritë Kryesore		
	Kërkesa vendore	Turistët e plazheve vendas	Turistët kulturorë
Kërkuesit e eksperiencave	++	++	+++
Kërkuesit e faciliteteve	++		++
Eksploruesit	++	+	+++
Profesionistët/Ata që e kanë hobi	+		+
Rechargers	+		

Figurë 93 –Kategoritë kulturore Brenda çdo kategorie kryesore. Burimi: Konkluzionet e konsulentit

Qasje e ngushtë

Nëse merret në konsideratë një qasje e ngushtë për valorizimin (megjithëse e kufizuar në sferën e trashëgimisë kulturore pa marrë parasysh kontekstin më të gjerë socio-ekonomik), ajo duhet të përfshijë veprime që synojnë përmbushjen e dy objektivave kyç strategjike të mëposhtme:

- Sigurimin e përvojës së shkëlqyer për vizitorët në atraksionet kryesore të trashëgimisë
- nëpërmjet prezantimit, ripërtëritjes ose përditësimit të shërbimeve dhe infrastrukturës.
- Kapërcimin e paragjykimit ndaj Shqipërisë dhe Durrësit nëpërmjet prezantimit të atraksioneve të jashtëzakonshme dhe marketingut të përmirësuar.

a) Sigurimi i një përvoje të shkëlqyer për vizitorët në atraksionet kryesore të trashëgimisë nëpërmjet prezantimit, ripërtëritjes ose përditësimit të shërbimeve turistike dhe infrastrukturës.

Shërbimet dhe infrastrukturat turistike për secilin sit të trashëgimisë kulturore janë parashikuar nga ToR-i. Duke u bazuar në to, plotësimet në secilin sit duhet të përshtaten në përputhje me synimet kryesore dhe eksperiencën e lidhur me vizitorët. Kjo përputhje paraqitet në tabelën vijuese.

Sitet e Trashëgimisë Kulturore	Objektivi i turizmit	Objektivat kyç	Përvojat e ofruara	Shërbimet/infrastruktura turistike
Amfiteatri Romak	Të luajë rol kryesor për përmbushjen e vizionit të Durrësit duke u bërë një qendër kulturore dhe magnet për Shqipërinë dhe rajonin, duke shfrytëzuar ikonën e tij në qendër të qytetit.	Kërkuesit e eksperienca ve janë synimi kryesor ,të ndjekur nga eksploruesit dhe facilitatorët	Përvojat e ofruara dallohen sipas periudhës së ditës dhe sezonit. Në netët e verës, ofrohet, "Festivali Mesdhetar i Durrësit " që përfshin shfaqje të tjera të mëdha. Gjatë ditës, siti është i hapur për vizitorët, gjatë gjithë vitit.	Itinerari i vizitorëve Panele/didaktikë Infrastruktura për të mikpritur evente të mëdha: • zyra e biletave • ndriçimi për rrugët • tualetet • kosh mbeturinash • dhomë e gjelbër për interpretuesit • vendet e uljes • skenë e përkohshme
Muzeu Arkeologjik i Durrësit (UNOPS)	Rritja e përvojës së vizitorëve në standardet ndërkombëtare të një muzeu arkeologjik bashkëkohor dhe të suksesshëm. Zhvillimi i vizibilitetit dhe njohjes kombëtare dhe ndërkombëtare të muzeut. Arritja e integrimit më të mirë të muzeut si një qendër kulturore, me jetën kulturore dhe shoqërore të qytetit të Durrësit	Kërkuesit e faciliteteve janë synimi kryesor, i ndjekur nga eksploruesit dhe rechargers	Shërbime didaktike dhe programe publike për të angazhuar shkollat dhe komunitetin lokal. Tarracat-bare me synim rechargers. Shtimi i përvojave të jetuara	Riorganizimi funksional i të gjitha ambienteve dhe tarracave, duke përfshirë: • zyrat e biletave • pikat e informacionit • hapësira ekspozimi të përhershme dhe të përkohshme • kafene •dyqan dhuratash(suvenire) • hapësirat didaktike • meeting rooms • auditoret Përdorimi i hapësirave të jashtme, përfshirë ndriçimin e jashtëm të ndërtesës dhe artefakteve për të tërhequr vizitorët gjatë natës
Termat Romake dhe Forumi Bizantin	Të ndodhura në zemër të qytetit, ato do të luajnë një rol drejtues në përmbushjen e vizionit të Durrësit duke paraqitur rëndësinë e qytetit ndër shekuj	Eksploruesit të ndjekur nga kërkuesit e faciliteteve	Zgjerimi vizitave të planifikuara nëpërmjet shtimit të përvojave të jetuara	Itinerari i vizitorëve Interpretimi i paneleve didaktike. Infrastruktura për vizitorët pritës: • masat e sigurisë parmakët/mbrojtëset • kosha mbeturinash • ndriçimi
Itineraret urbane		Eksploruesit të ndjekur nga facilitators	Zgjerimi i vizitave të planifikuara nëpërmjet shtimit të përvojave të jetuara	

Figurë 94 –Kategoritë kulturore brenda çdo segmenti kryesor. Burimi: Konkluzioni i konsulentit

b) Prezantimi i atraksioneve të jashtëzakonshme dhe forcimit të marketingut

Idetë për veprimet kryesore përfshijnë planifikimin, organizimin dhe nisjen e Festivalit Mesdhetar të Durrësit brenda Amfiteatrit. Mund të jetë një festival veror që organizon evente cilësore që mund të tërheqë një audiencë të madhe pasi plotëson nevojat argëtuese të turistëve në plazh dhe kërkesën lokale. Sipas përpjekjeve promovuese, ai, gjithashtu, mund të synojë një audiencë ndërkombëtare. Një tërheqje tjetër e mundshme që do të rriste identitetin kulturor të qytetit do të ishte organizimi i një Muzeu Interaktiv të Betejave Detare. Duhet t'u kushtohet betejave detare që u zhvilluan afër Durrësit (Pompei kundër Cezarit – 48-të p.e.s.; Bizanti dhe Venediku kundër Normanëve - 1081 p.e.s.; Britanikët/Francezët/Italianët kundër Austriakëve - 1915 p.e.s.) dhe, më gjerë, betejave detare më të famshme në histori. Mund të lidhet edhe me vizitat në arkeologjinë nënujore. Atraksione të reja si kjo janë të nevojshme për të rritur vizitat. Ndërsa në planin afatgjatë, kjo mund të vendoset në një hapësirë të re, në planin afatshkurtër, mund të përbëhet nga një ekspozitë e re në Muzeun Arkeologjik të Durrësit. Plani i Veprimit ka parashikuar prezantimin e ekspozitave të përkohshme bazuar në përvojat digjitale multimediale, duke përfshirë përdorimin e realitetit të shtuar dhe aplikacioneve digjitale, për të siguruar një përvojë gjithëpërfshirëse, duke filluar me historinë e betejave detare.

Konteksti më i gjerë ekonomik.

Për të rishikuar qasjet e mëparshme, qasja e Valorizimit të Gjerë përfshin më shumë çështje të politikave publike. Gjerësia u referohet kufijve të ndikimit ekonomik me valorizimin që e konsideron trashëgiminë si një mjet për të arritur qëllime më të gjera ekonomike, për punësimin dhe krijimin e vendeve të punës. Qasjet e ngushta ose të gjera nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Ato nuk konsiderohen si kategori veprimesh, por si shkallë të ndjekjes së objektivave ekonomike, pavarësisht nëse janë përfitime të gjeneruara drejtpërdrejt ose përfitime më të mëdha dhe indirekte ekonomike.

a) Promovimi i një rrethi turistik kulturor nëpërmjet drejtimit dhe sigurimit të stimujve mikrofinanciarë për turizmin lokal dhe ndërmarrjet e vogla dhe mesatare (NVM)

Veprimet kryesore përfshijnë krijimin e një fondi lëvizës. Ai përbëhet nga mikro-stimuj që synojnë të mbështesin lindjen dhe rritjen e iniciativave sipërmarrëse dhe jofitimprurëse në sektorin e industrisë kulturore-turistike, që synojnë të mbështesin valorizimin e atraksioneve të trashëgimisë së Durrësit.

b) Krijimi i një marke të certifikuar, Made in Albania, komercializimi i mallrave dhe zanateve me cilësi

Veprimet kryesore përfshijnë promovimin e mallrave me cilësi. Ai konsiston në krijimin e një katalogu të mallrave me cilësi të lartë që do të shiten në një dyqan fizik suveniresh dhe në një dyqan në internet.

c) Përfshirja e komunitetit lokal nëpërmjet aktiviteteve kulturore dhe çlodhëse, gjatë gjithë vitit, në vendet e trashëgimisë.

Veprimet kyç përfshijnë:

- **Programi Publik**. Zhvillimi i një programi publik për të angazhuar audiencën lokale (dhe turistët) nëpërmjet aktiviteteve pjesëmarrëse në të dy Amfiteatrin në Muzeun Arkeologjik të Durrësit (p.sh., shkolla për artet dhe spektaklin);
- **Marrja me qira e hapësirave për evente private** (festat e ditëlindjeve të fëmijëve, evente biznesi, etj.).

d) Ndërtimi i kapaciteteve për turizmin lokal nëpërmjet edukimit dhe trajnimit

Veprimet kryesore përfshijnë një laborator që do të aktivizohet në Muzeun Kombëtar të Arkeologjisë në bashkëpunim me Universitetin e Durrësit.

e) Organizimi, koordinimi dhe promovimi i produktit të turizmit të trashëgimisë Durrës

Veprimet kyç përfshijnë:

- Në qasjen e ngushtë, menaxhimi i amfiteatrit, ndoshta së bashku me të gjitha vendet e tjera të trashëgimisë në mënyrë që të rriten mundësitë për të arritur ekonomi të shkallës në operacione dhe marketing/promovim;

E.3.3 Plani i gjenerimit të të Ardhurave

Gjenerimi i të ardhurave direkte

Të kuptosh vizitorët dhe kërkesat e tyre është vetëm një pjesë e çështjes, duhet që kjo kërkese të kapitalizohet.

Një çështje thelbësore për përmirësimin e përdorimit dhe vlerësimit të siteve të trashëgimisë kulturore është gjenerimi i të ardhurave. Ky nuk është gjenerim i fitimit në vetvete, por për të mbështetur konservimin, prezantimin, gërmimet arkeologjike, etj. Ndërsa nga sitet nuk pritet të jenë plotësisht të vetë-financueshme, ato sidoqoftë mund të kontribuojnë pjesërisht në buxhet. Gjenerimi i të ardhurave nga sitet e trashëgimisë kulturore është i domosdoshëm për të kontribuar financiarisht në qëndrueshmërinë dhe në përmirësim të vazhdueshëm të tyre. Të ardhurat mund të përfitohen nga të tre projektet fillestare të planifikuara në Durrës, duke përfshirë shitjet e biletave, shitjet e biletave të eventeve, ekspozitat e përkohshme dhe vizitat me guidë.

Në planin afatshkurtër, për eventet në Amfiteatrin Romak dhe në një shkallë më të vogël në Forumin Bizantin, mund të kontraktohet një kompani eventesh. Kjo mund të realizohet sipas disa ndërhyrjeve bazike të përshkruara në pjesën e konservimit dhe prezantimit të PM. Kjo do të lejojë menaxhimin dhe MK të vëzhgojnë kërkesën, krijimin e përvojës me eventet, ndërtimin e kapaciteteve dhe dokumentimin e të ardhurave, kostove dhe shpenzimeve.

Kërkesa dhe të ardhurat për secilin shërbim do të vlerësohen në planin e biznesit

Shërbimet që gjenerojnë të ardhura	Amfiteatri Romak	Banjat termale Romake dhe Forumi Bizantin	Itineraret Urbane
Pranimet	√	√	
Anëtarësimi	√	√	
Evente Online	√		
Pajisjet dhe aplikacionet e shtuara	√	√	√
Shitjet me pakicë	√		
Kafene			
Ekspozita të përkohshme			
Programet			
Qiratë	√		
Evente për mbledhjen e fondeve	√	√	√

Vizitat me guidë	√	√	√
Të ardhura të tjera të vet-gjeneruara	√	√	√
Donacione (dhurime)	√	√	√

Figurë 95 –Burimet që gjenerojnë të ardhurat

Ndikimet indirekte dhe në nivel komuniteti

Cilido qoftë ndikimi i drejtpërdrejtë financiar nga aktivitetet që gjenerojnë të ardhura, të ardhurat nga shërbimet dhe aktivitetet kulturore, me përjashtim të organizimeve të eventeve të mëdha unike, mund të jenë të vogla nëse krahasohen me organizimeve të tjera private dhe vështirë se prodhojnë një të ardhura të konsiderueshme për financuesit. [53] Megjithatë, duke qenë se trashëgimia kulturore e Durrësit ka potencial për të tërhequr një numër të rëndësishëm vizitorësh, do të ishte gjithashtu e vlefshme matja e shpenzimeve të vizitorëve në ekonomitë e zonës - akomodimi, restorantet, dyqanet - megjithëse mund të jetë e vështirë të gjendet se cilat janë shpenzimet e mirëfillta shtesë që shkaktohen vetëm nga vizitat në vende të trashëgimisë kulturore.

Vlerësimi i ndikimit të qytetit ose zonës përreth nga muzeu lidhet me temën e ripërtëritjes urbane. Të pasurit e një trashëgimie kulturore tërheqëse ka shumë pasoja të dobishme, të tilla si përmirësimi i imazhit të qytetit, rritja e frekuentimit të bizneseve dhe krijimi i ndjenjës së gjallërisë. Përfitimet e dobishme si rrjedhojë mund të jenë qira më të larta për pronat fqinje, më shumë dyqane, më shumë punë, ulja e krimit dhe siguria më e madhe. Rezultate si këto janë tërheqëse për qeverisjen lokale dhe rajonale, por treguesit janë të paqartë dhe jo të drejtpërdrejtë, dhe gjithashtu kërkojnë kërkime për një periudhë të gjatë kohore. Ripërtëritja është një punë afatgjatë që mund të zgjasë 15 deri në 20 vjet ose më shumë; ndërkohë, përfundime të menjëhershme ka pak.

Ndikimet e tilla zakonisht vlerësohen nëpërmjet metodave që përpiqen t'u vendosin një vlerë financiare gjërave që nuk kanë vlerë financiare, të tilla si mirëqenia, të mësuarit, pasurimi kulturor dhe madje edhe vlera që jo-përdoruesit i kushtojnë të pasurit e një muzeu në qytetin e tyre. Ata përpiqen qartësisht të përcaktojnë vlerën e, për shembull, përfitimeve sociale dhe të mësuarit, që do të përfshinin gjithashtu vlerat e papërdorura, si vlera e ekzistencës së një atraksioni kulturor (d.m.th., njerëzit vlerësojnë që kanë muze në lagjen e tyre; edhe pse nuk shkojnë vetë, ata vlerësojnë faktin që të tjerët mund ta vizitojnë atë ose që ata vetë mund të shkojnë në të ardhmen).

Atraksioni kulturor, gjithashtu, mund të ndikojë pozitivisht tek njerëzit që merren me çështjet e shëndetit mendor ose papunësisë, etj., Fondet që do të shpenzonte sektori publik (p.sh., ndihmat e papunësisë) mund të shmangen nëse, për shembull, një pjesëmarrës në një program muzeal është në gjendje të gjejë punë të re nëpërmjet programit. Si është diskutuar tashmë, institucionet kulturore, përdoren gjithnjë e më shumë për të synuar prioritete të tjera të politikave publike, të tilla si shëndeti dhe mirëqenia, duke ulur ndikimin e lidhur me buxhetin e shtetit[54].

E.3.4 Modeli i ri i qeverisjes për përmirësimin e menaxhimit, përdorimit dhe vlerësimit

[53] Network of European Museum Organization (2016). *Money Matters: The Economic Value of Museums.* 24th Annual Conference. Karlsruhe, Germany. 10-12 November

[54] Shih p.sh Cosenza (2021). Op.cit.

E.3.4.1 Justifikim

Një nga tre objektivat kryesorë të MP është përmirësimi i menaxhimit, përdorimit dhe vlerësimit. Në pjesën e parë të MP-së, vlerësimi i kushteve aktuale, është bërë e qartë se modeli aktual i qeverisjes duhet të ndryshojë për të rritur përdorimin e trashëgimisë kulturore në Durrës.Prandaj, ky seksion trajton zgjedhjen e një mënyre të re qeverisjeje.

Objektivi i tretë i PM-së ka të bëjë kryesisht me përmirësimin e turizmit, vlerësimin e trashëgimisë kulturore përmes një grupi të përshtatshëm praktikash të menaxhimit të biznesit. Nga ana tjetër,ligji 17/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", VKM, Nr. 169, datë 20.2.2020, shoqëruar edhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Turizmin e Qëndrueshëm 2019-2023 (SKZHR) ofrojnë një kuadër të qartë. për qeverisjen e Zonës Arkeologjike të Durrësit, e cila duhet:

- Së pari, bazuar në një model biznesi financiar të qëndrueshëm dhe të fortë financiarisht;
- Së dyti, bazuar në përfshirjen e komunitetit;
- Së treti, të pajisura me tregues të realizueshëm të performancës.

Kur aplikohet në sektorin publik, qeverisja është "si organizata punon me partneri i saj, palët e interesuara dhe rrjetet për të ndikuar në rezultatin e politikave publike." .

Kur aplikohet në sektorin publik, qeverisja është "si organizata punon me partnerwt e saj, palët e interesuara dhe rrjetet për të ndikuar në rezultatin e politikave publike."[55]. Argumentet për të ndryshuar modelin aktual të qeverisjes janë paraqitur shkurtimisht më poshtë:

Rritja e turizmit

- INSTAT, agjencia shqiptare e të dhënave të statistikave raportoi se 377,211 të huaj vizituan Shqipërinë në janar 2023, krahasuar me 194,237 në janar 2022, një rritje prej 94,2%.Numri i turistëve vendas u rrit gjithashtu nga 259,835 në janar 2022 në 456,239 në 2023. Në vitin 2022, rreth 7.5 milionë njerëz vizituan Shqipërinë, një rritje prej mbi 32% nga një vit më parë. Një përqindje e mirë e këtyre turistëve vijnë në Durrës pasi është qyteti më i madh bregdetar. Sipas OCNAL, hotelet në Durrës ishin rezervuar me mbi 90 për qind kapacitet në verën e 2022.
- Nëse modeli i qeverisjes ndryshohet në një institucion të specializuar me një fondacion lokal, këto çështje të mësipërme mund të trajtohen në nivel lokal, koha e reagimit do të jetë më e shpejtë, etj., Përdorimi i vendeve të trashëgimisë kulturore si vende dhe destinacione kulturore është i mundur.

Vendimmarrja lokale

- Stimujt financiarë për fondacionin e ri **për të mbledhur fonde nga valorizimi/rijetëzimit i objekteve të trashëgimisë kulturore në Durrës**. Nëse fondet gjenerohen në nivel lokal, ato mund të qëndrojnë dhe të riinvestohen në ruajtje, përmirësim të infrastrukturës për vizitorët dhe prezantim.

Menaxhimi aktual jo efikas sa duhet

- Përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë për një periudhë të gjatë kohore u vu re se modeli aktual i qeverisjes nuk funksionon në mënyrë aq efikas sa duhet. **Pas tërmetit të fundit të gjitha sitet**

[55]Boivard T. ad Loffler E. (2009). "Understanding Public Management and Governance". *Public Management and Governance*. London and New York: Routledge

kryesore arkeologjike, u mbyllën me përjashtim të Amfiteatrit. E rëndësishme për t'u theksuar është se këto site **nuk po gjenerojnë të ardhura të mjaftueshme nga biletat e vizitorëve apo nga mungesa e alternativave të ndryshme ekonomike,** si mungesë kafeneje në muze apo aktivitete me pagesë në amfiteatër. Ndërkohë në Muzeun Arkeologjik një kat i tërë i tij ishte bosh pa asnjë përdorim.

- **Mirëmbajtja e dobët dhe gjendja e keqe e konservimit të zonave arkeologjike në Durrës me ujë të ndenjur, mbeturina të ekspozuara.** Kjo është vërejtur gjithashtu në shumë raste gjatë dy viteve.
- Ka **mungesë interpretimi në të gjithë Durrësin.** Vizitorët kanë pak ide për rëndësinë historike dhe kulturore të qytetit. Një fondacion i dedikuar për trashëgiminë kulturore mund të trajtojë këtë aspekt që mungon
- Përgjegjësitë aktuale për asetet kulturore të qytetit varen nga disa institucione të ndryshme duke sjellë një kakofoni llogaridhënie. Me ngritjen e një fondacioni të ri nga një institucion i specializuar i trashëgimisë kulturore do të kishte një linjë të qartë llogaridhënieje.

E.3.4.2 Opsionet e modelit të qeverisjes

Përzgjedhja e një modeli të ri qeverisjeje referohet nga Ligji 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë". Në veçanti, Seksioni II – Administrimi i Pasurive Kulturore, Neni 171, Mënyrat e administrimit. Ky nen përshkruan dy forma të ndryshme të menaxhimit:

1. **Administrimi direkt** nëpërmjet strukturave të specializuara organizative në varësi të institucioneve shtetërore ose institucioneve të tjera publike me autonomi shkencore, organizative e financiare dhe ekspertizë të specializuar teknike e shkencore. Institucionet publike mund të kryejnë menaxhim të drejtpërdrejtë në bashkëpunim me organe të tjera të administratës publike.

2. **Administrimi indirekt** nëpërmjet:
    a. **Fondacioneve të posaçme,** të krijuara sipas nenit 172;
    b. **Fondacioneve të themeluara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore,** sipas këtij ligji;
    c. **Personave fizikë dhe juridikë,** publikë apo privatë, të cilëve u jepet administrimi i pasurisë kulturore përmes procedurave publike bazuar në një vlerësim krahasues të projekteve të paraqitura.

Ky dokument kritik vazhdon duke deklaruar se "menaxhimi indirekt synon të ofrojë një menaxhim më efektiv të pronave kulturore". Ekipi e përdori këtë koncept në vlerësimin e modeleve të mundshme të qeverisjes në të ardhmen. Secili prej këtyre modeleve me avantazhet dhe disavantazhet e tyre është vlerësuar dhe diskutuar nga hulumtimi i thelluar. Të gjitha opsionet u diskutuan dhe u prezantuan me Ministrinë e Kulturës gjatë dy viteve.

ADMINISTRIMI DIREKT

Në thelb, ky model do të ishte status quo. Monumentet do të vazhdojnë të menaxhohen, mirëmbahen dhe konservohen drejtpërdrejt nga Qendra Muzeore e Durrësit dhe Ministria e Kulturës. Qendra Muzeore e Durrësit u krijua në vitin 2019, para pandemisë globale, ndërsa Durrësi nuk kishte një Plan Menaxhimi. PM kërkon që modeli i qeverisjes duhet të pasqyrojë përmirësime të cilat adresojnë sfidat thelbësore të nevojshme dhe mundësitë e pranishme në Durrës. Duke përfshirë gjetjen e mënyrave dhe mundësive fleksibël në zbatimin e projekteve, përmirësimin e menaxhimit, tërheqjen e fondeve

të jashtme, përmirësimin e shërbimeve ndaj vizitorëve, rritjen e kapaciteteve lokale dhe afrimin e komunitetit lokal me trashëgiminë kulturore.

ADMINISTRIMI INDIREKT

Kjo formë ofron tre opsione shumë të ndryshme:

Opsioni A) Fondacion i posaçëm – kjo formë kërkon krijimin e një subjekti të ri juridik jofitimprurës në formën e një fondacioni të bashkëthemeluar nga institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe një partner strategjik. Partner strategjik është një person fizik ose juridik privat, i cili konsiderohet thelbësor në zbatimin e politikave në fushën e trashëgimisë kulturore dhe sigurimin e objektivave të përbashkëta në zhvillimin e fushës, bazuar në përvojën e tyre, vlerën dhe cilësinë e sponsorizimit, marrëveshjen e gjatë të bashkëpunimit, shkëmbim vlerash intelektuale, burime njerëzore dhe financiare dhe kohëzgjatje bashkëpunimi me qeverinë shqiptare ose ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Modeli i një fondacioni të posaçëm të bashkëthemeluar ka shumë dobi, duke përfshirë një sasi të konsiderueshme autonomie që do të nxiste menaxherin(ët) për të kërkuar mundësi dhe burime të reja të ardhurash. Ky model do të lejonte gjithashtu bashkëpunim me një partner strategjik, i cili mund të ofrojë përvojën që zotëron në sektorin privat, duke bërë që ky model të jetë më i hapur ndaj donacioneve private. Në mënyrë tipike, donacionet private u bëhen subjekteve jofitimprurëse për një kauzë specifike kulturore dhe jo qeverive shtetërore.

Ky model mbart gjithashtu rreziqe të konsiderueshme pasi është një organizim kompleks dhe do të kërkonte një kohë shumë më të gjatë për t'u krijuar. Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të zonave arkeologjike, potencialin për rritje të turizmit dhe ndërtimet dhe zhvillimet e fundit, ky mund të jetë një rrezik serioz. Krijimi i një modeli administrimi të tillë në Butrint, u deshën gati katër vjet për t'u krijuar dhe u përball me pengesa të rëndësishme administrative politike dhe qeveritare. Krijimi i një fondacioni të përkushtuar të bashkëthemeluar gjithashtu nuk është kuptuar mirë nga publiku dhe ata natyrisht janë të kujdesshëm ndaj perceptimit të një subjekti privat që ndërhyn në trashëgiminë e kulturore të vendit.

Ngritja e mundshme e një fondacioni të këtij lloji mund të shtyhet deri në përfundimin e projekteve të rinovimit pas tërmetit, projektin (TID), projektin e shpronësimit dhe heqjen e të gjitha ndërtimeve të supozuara të ndërtuara pa leje. Ky afat kohor më i gjatë do t'i mundësonte Ministrisë së Kulturës të vëzhgonte ndryshimet që ndodhin në qytet, duke përfshirë portin e ri dhe projekte të tjera strategjike dhe të dokumentonte qasjen e valorizimit siç përshkruhet në këtë PM.

Opsioni B) Fondacion i krijuar nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore

Ngritja e një fondacioni nga një institucion i specializuar është nënopsioni i dytë, i cili ka shumë përparësi në kushtet aktuale dhe siguron një funksionim më të shpejtë nga ana e operimit administrativ. E rëndësishme është se ky model ofron një ndryshim shumë të nevojshëm të qeverisjes për të adresuar sfidat e fundit me të cilat përballet qyteti në lidhje me trashëgiminë e tij kulturore dhe ndërkohë ofron mbikëqyrjen e nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre pasurive kulturore nga Ministria e Kulturës. Niveli i autonomisë së këtij modeli mund të krijohet me kujdes për të nxitur dhe stimuluar gjenerimin e të ardhurave dhe rrjedhimisht menaxhimin dhe ruajtjen e fondeve. Është e rëndësishme të theksohet se Ministria e Kulturës nuk do të duhet të heqë dorë nga kontrolli për të arritur nivelin e nevojshëm të autonomisë. Ministria e Kulturës do të ishte ende përgjegjëse për ruajtjen/konservimin dhe e përfshirë në të gjitha vendimmarrjet kryesore dhe do të drejtonte të ardhmen e fondacionit. Funksionimi, mirëmbajtja e përditshme, organizimi i eventeve, ekspozita, promovime etj, do të kontrolloheshin nga Fondacioni.

Ky model ofron rrezikun më të vogël dhe mund të zbatohet në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, deri në përfundimin e projekteve të rinovimit pas tërmetit, TID, projektin e shpronësimit dhe heqjen e të gjitha ndërtimeve të ndërtuara pa leje duke adresuar nevojat urgjente të menaxhimi i përshkruar më sipër. Mbledhja e fondeve nga donatorët e jashtëm mund të jetë një komponent i rëndësishëm i veprimtarisë së fondacionit, megjithëse ende donatorët hezitojnë kur është fjala për ente qeveritare.

Ky model ofron mundësinë më të mirë për të ecur përpara dhe adreson të gjitha çështjet e përmendura më sipër.

Institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore

Referuar nenit 28 nën Titullin III, Institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, Aneksin 2, të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", listohen institucionet sa vijon:

a) Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
b) Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
c) Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore
d) Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale
e) Institucionet e Rrjetit Kombëtar të Arkivave
f) Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
g) Instituti i Studimeve të Artit dhe Antropologjisë Kulturore
h) Instituti i Arkeologjisë.

Në këtë moment nuk është e mundur të vlerësohen në detaje të gjitha këto institucione; Megjithatë, disa prej tyre, si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore dhe Institutin e Arkeologjisë, mund të jenë të duhurat për të krijuar një themel dhe për të filluar një model të ri qeverisjeje. Këto institucione kanë si mandat mbrojtjen dhe ruajtjen së bashku me kërkimin dhe menaxhimin. Vlerësimi i tyre dhe vendimi se cila do të ishte më e përshtatshme duhet të përcaktohet nga Ministria e Kulturës.

Opsioni c) Personat fizikë dhe juridikë

Ky opsion lejohet me ligj dhe në thelb është një transferim menaxhimi. Ai lejon autonomi të plotë me shumë pak mbikëqyrje nga autoritetet përgjegjëse. Ka shumë të ngjarë që ky model është përfshirë në legjislacion për site më të vogla dhe më pak të rëndësishme, si dhe për muzetë e komuniteteve lokale.

Ky opsion do të përballej me kundërshtime të konsiderueshme nga komuniteti dhe grupet e interesit dhe do të shihej si heqje dorë nga përgjegjësia e shtetit për një siti të rëndësishëm. Ky opsion nuk është i përshtatshëm duke pasur parasysh rëndësinë e Amfiteatrit të Durrësit që aktualisht është në tentativ listë tentative të Trashëgimisë Botërore. Është gjithashtu e mundur që Ministria e Kulturës të humbasë njëfarë ndikimi, edhe nëse do të ruante përgjegjësinë për mbrojtjen dhe ruajtjen.

Konkluzion

Duke pasur parasysh urgjencën për të menaxhuar në mënyrë aktive trashëgiminë kulturore të Durrësit në procesin e projekteve të shumta në vazhdim të ruajtjes pas tërmeteve, projekti TID, projektin e shpronësimit dhe heqjen e të gjitha ndërtimeve pa leje, duke iu përgjigjur sfidave në rritje - Një fondacion i krijuar nga institucionet e specializuara është modeli i qeverisjes që rekomandohet në këtë fazë. Është e rëndësishme të theksohet se ky model nuk përjashton pjesëmarrjen e një donatori apo përfshirjen e sektorit privat. Ministria e Kulturës do të mbetet përgjegjëse për mrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Fondacioni i ri do të jetë përgjegjës mirëmbajtja e përditshme, organizimi i eventeve, ekspozita, promovime etj. Misioni i fondacionit të ri do të përfshijë sa vijon:

- Objektivat zhvillimore dhe operacionale, të tilla si nxjerrja në pah dhe promovimi i trashëgimisë në aspektin kulturor dhe edukativ, organizimi i shërbimeve të vizitorëve dhe zhvillimi e i turizmit dhe produkteve të tij, krijimi i të ardhurave të mjaftueshme për të shlyer kostot e saj të zakonshme dhe të jashtëzakonshme dhe, ndoshta, një tepricë për të kontribuar kostot e ruajtjes të trashëgimisë kulturore.
- Ministria e Kulturës është ende përgjegjëse për ruajtjen dhe mbikëqyrjen. Institucioni i specializuar, duhet të ketë objektiva zhvillimi të ndërtuara në misionin, organizimin, aftësitë dhe burimet njerëzore.
- Një fondacion i ri të ketë staf të përshtatshëm me ekspertizë menaxheriale dhe organizative, menaxhim biznesi, komunikim, edukim, promovim, kapacitet inovativ etj.

OPTIONS për qeverisje	Avantazhet	Disavantazhet
ADMINISTRIMI DIREKT	Tashmë i krijuar	Nuk ka ndryshime në moment
	Ruan Status Quo-në (Gjendjen ekzistuese	Menaxhimi ekzistues nuk duket se funksionon në mënyrë efektive
		Më pak fleksibël për t'u përshtatur me situatat aktuale dhe në zhvillim
	Mund të përmirësohet	Do të duhet kohë për tu përmirësuar.
		Pak ose aspak fonde private të mundshme
ADMINISTRIMI INDIREKT		
Fondacion i Posaçëm	Përvojë në menaxhim privat	Duhet kohë e mjaftueshme për të krijuar
	E hapur për donacione private	Perceptim negativ
		I pafavorizuar politikisht
		Do të duhet kohë për të gjetur partnerin e duhur privat
		Mund të përforcojë dëshirën për të prodhuar fitime, në vend që t'i jepet përparësi ruajtjes dhe vizitës
		Mungesa e përvojës me fondacione ad hoc të bashkëthemeluara me një partner privat ose jofitimprurës
Fondacion i krijuar nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore	Krijon një model të qeverisjes vendore duke ruajtur ende lidhjet institucionale	Mund të shihet vetëm si një ndryshim formal, ende si një institucion i qeverisë
	Fondet e siguruar ka të ngjarë të shkojnë për ruajtjen/konservimin	Përfshirje e kufizuar private dhe mundësi të pakta dhurimi
	Lidhja me Ministrinë e Kulturës do të ishte e fortë	Mungesa e mundshme e përvojës në menaxhimin e ndërmarrjeve private apo partneriteteve
	Konservimi me prioritet	

Personat fizikë dhe juridikë	Do të ishte shumë e shpejtë për t'u krijuar	Nuk është e mundur me site me vlera kulturore të rëndësishme
		Është projektuar për site më të vogla dhe më pak të rëndësishme
		Nuk do të favorizohej nga publiku apo institucionet
		Eksperiencë e pamjaftueshme për të menaxhuar

Burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme

Duhet të merren parasysh nevojat e fondacionit të ri. Menaxhimi i përditshëm i zonave arkeologjike duhet të kryhet nga personeli i përhershëm. Stafi duhet të jetë i organizuar sipas funksioneve kryesore dhe i përshkruar në detaje. Megjithatë, faza e fillimit të fondacionit duhet të jetë sa më e thjeshtë. Fondacioni si organizatë duhet të ketë një organigramë funksionale, e drejtuar nga një Drejtor Ekzekutiv. Fondacioni, ndër të tjera, të kryejë funksionet e mëposhtme:

- Administrata, duke përfshirë burimet njerëzore, shërbimet administrative dhe prokurimin
- Organizimi i eventeve, i cili përfaqëson biznesin kryesor të fondacionit
- Shërbime turistike
- Marketingu, duke përfshirë mbledhjen e fondeve, komunikimin, biletat, shitjet.
- Ekspozita të përkohshme dhe shërbime digjitalë
- Programe dhe edukimi

E.3.5 Fondacioni i ri

Një fondacion do të krijohet nga një nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore në varësi të Ministrisë së Kulturës si modeli i qeverisjes sipas ligjit shqiptar në terma afat të shkurtër.



Figurë 97 - Skema organizative e Fondacioni i Zhvillimit të Kulturës Durrës

Grupi i ri i atraksioneve të trashëgimisë kulturore do të funksionojë si një njësi organizative nën kujdesin e kësaj organizate, e cila do të mbikëqyrë valorizimin e të gjithë trashëgimisë kulturore të Durrësit, Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake, Shtigjeve Urbane.

Shtrirja e përgjegjësive të Fondacionit të Ri:

1) Menaxhimi i Amfiteatrit, Banjave dhe Forumit
    a. Vendosja e politikave të biletave
    b. Mbledhja e biletave hyrëse
    c. Zhvillimi i mundësive të tjera për gjenerimin e të ardhurave, si p.sh. shërbime turistike, kafene etj.
2) Pritja e vizitorëve
    a. Kryerja e turneve interpretuese (elektronike dhe të personalizuara)
    b. Krijimi i materialeve për të inkurajuar vizitorët vendas
    c. Zhvillimi i ekspozitave të veçanta
3) Programimi dhe promovimi i ngjarjeve të përshkruara në PM
4) Menaxhimi i financave
    a. Kthimi i një përqindjeje të paracaktuar të çdo fitimi në MK për projekte specifike të ruajtjes në të njëjtat zona
    b. Në rast të humbjes financiare, barrën e mbartin bashkërisht
5) Ruajtja e vendeve historike në përditshmëri
    a. Ruajtja (mirëmbajtja) parandaluese në bashkëpunim me MK
    b. Pastrimi, largimi i mbeturinave, mirëmbajtja e nyjeve sanitare

6) Kryerja e aktiviteteve edukative në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Arsimit dhe shkollat lokale.

Sigurimi i fondeve dhe përgjegjësia e sitit

Fondacioni i ri mund të sigurojë fonde nga burime të ndryshme të ligjshme, nga palë të treta, si organizata të tjera, universitete, fonde private, e të ngjashme, duke siguruar kështu fonde për funksionimin e menaxhimit të sitit.

Prandaj, një detyrë kryesore e Drejtorit Ekzekutiv të fondacionit është të sigurojë që financimi të merret nga burime të ndryshme, (si në aspektin e financimit të investimeve kapitale në vijueshmëri, ashtu edhe në sigurimin e të ardhurave për punë operative dhe aktivitetet), për të adresuar rrezikun afatgjatë të investimeve. Kjo është praktikë e zakonshme për fondacionet në nivel global, veçanërisht me ato që kanë nevojë për fonde në mënyrë të vazhdueshme, për projekte konservimi, siç është rasti me Durrësin. Kështu, fondacioni siguron fonde si kapital, ashtu edhe shuma të të ardhurave për operacionet dhe aktivitetet. Çdo fond që gjeneron trashëgimia kulturore do t'i kthehet fondacionit si tepricë operacionale. Mund të kërkohet që këto fonde të riinvestohen në mirëmbajtjen dhe funksionimin e zonës ose të përdoren nga Ministria e Kulturës në projektet e konservimit të siteve të tjera.

Aspektet kyçe janë:

- Qeveria e Shqipërisë ruan pronësinë e të gjitha aseteve të sitit për përfitim publik në mënyrë të përhershme.
- Fondacioni i ri investon në kërkesat operacionale dhe kapitale të zonës arkeologjike, mundësisht në partneritet me donatorë të tjerë të jashtëm
- Fondacioni i ri i kthen MK-së një përqindje të rënë dakord të çdo teprice fitimi për ri investim konkretisht në Durrës.
- Bordi i fondacionit të ri do të emërojë një Drejtor Ekzekutiv të ngarkuar me kryerjen e të gjitha operacioneve të sitit nëpërmjet një plani menaxhues dhe investimi shtatëvjeçar të përditësuar çdo vit dhe të miratuar nga MK.
- Fondacioni i ri do të ketë kompetencë në të gjitha fushat e funksionimit që lidhen me mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë menaxhimin e vizitorëve, organizimin e ngjarjeve, menaxhimin e shërbimeve turistike, ngritjen e kapaciteteve të brendshme, angazhimin me komunitetin lokal.

Stafi i menaxhimit të sitit

Menaxhimi i përditshëm i zonave arkeologjike do të kryhet nga personeli i përhershëm me qendër në Durrës, i organizuar sipas funksioneve kryesore siç përshkruhet më poshtë. Lejohet kontraktimi i shërbimeve deri në një masë. Shërbimet tregtare (d.m.th. funksionimi i një kafeneje) dhe turistike mund të menaxhohen nga kompani private në bazë të marrëveshjeve. Stafi I zyrës së menaxhimit mund të rritet në numër për t'u përshtatur me kërkesat e ardhshme. Sidoqoftë, pika e fillimit duhet të jetë sa më e thjeshtë. Skemë organizative (organigrama) e propozuar me një përshkrim të përgjegjësive dhe mundësinë për të kontraktuar ose nënkontraktuar aktivitetin, propozon një organizatë funksionale, e cila do të drejtohej nga një Drejtor Menaxhues që kryeson gjashtë funksione kryesore:

Administrata, duke përfshirë burimet njerëzore, shërbimet administrative dhe prokurimin;

- Organizimi i eventeve, i cili përfaqëson biznesin kryesor të fondacionit;
- Shërbime turistike, duke përfshirë kafene dhe dyqan dhuratash;
- Marketingu, duke përfshirë biletat, shitjet dhe mbledhjen e fondeve, komunikimin;
- Ekspozita të përkohshme dhe shërbime digjitale;
- Programi dhe edukimi.



Figurë 98 -Organigrama e fondacionit

Pozicioni	Përgjegjësia	Nënkontraktim	
		JO	PO
Drejtimi			
Drejtor	Drejtues me kohë të plotë me qendër në zyrat e Parkut, i ngarkuar për menaxhimin, përfshirë personelin, buxhetimin, administrimin, kontratat me subjekte të jashtme, shërbimet e ofruara nga subjektet private, raportimin në Bord. Do të udhëzojë dhe miratojë oraret e punës së stafit. Do të koordinoj me institucionet e jashtme siç kërkohet nga detyrat dhe funksionet e tij, si dhe do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Bordit planin 7-vjeçar të menaxhimit dhe investimit.	√	
Sekretar		√	
Zyrtar i shtypit		√	
Administrimi			
Menaxher administrativ	Përgjegjës për kontrollin e kostos, kontabilitetin, pagesat	√	
Burimet Njerëzore	Përgjegjës për menaxhimin e kontratave të personelit	√	
Jurist			√
Mirëmbajtës	Përgjegjës për mirëmbajtjen e zakonshme të ndërtesave, shërbimeve komunale dhe pajisjeve në dispozicion të menaxhimit të parkut	√	
IT	Përgjegjës për aspekte të ndryshme të dixhitalizimi (Përditësimi dhe përpunimi i, ëebsite, aplikacionet, etj.)	√	
Zyrtar për prokurimet		√	
Siguria			√
Pastrues			√
Departamenti i organizimit të aktiviteteve/eventeve			
Drejtor	Përgjegjës për menaxhimin dhe planifikimin e aktiviteteve	√	
Arkëtar/Recepsionist		√	
Staf për eventet	Përgjegjës për eventete	√	
Teknik për shërbimet	Përgjegjës për shërbimet, audio, ndiçim montim skene, etj.	√	
Shërbime për turistike			
Kafene	Menaxhimi i kafenesë		√
Dyqan dhuratash	Menaxhimi i librarive dhe aktiviteteve të tjera tregtare		√
Shërbime për vizitorët	Guida turistike	√	
Marketing			
Drejtor i marketingut dhe shitjeve	Përgjegjës për menaxhimin dhe planifikimin e marketingut	√	
Shoqërues		√	
Shitjet dhe mbledhja e fondeve	Përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e marketingut, komunikimin me palët e interesuara dhe mbledhjen e fondeve	√	

Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun/Komunikim	Përgjegjës për komunikimit	√
Ekspozita të përkohshme dhe shërbime dixhitale		
Teknik		√
Programe edukimi		
Zv. Drejtor	Përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e programeve të edukimit	√
Zyrtar i programeve publike	Përgjegjës për edukimin dhe prezantimin e planeve, dhe aktiviteteve, koordinimin zhvillimin dhe zbatimin e programeve për shkollat; përgjegjës gjithashtu për shtrirjen dhe komunikimin e aktiviteteve kulturore dhe atraksioneve të vendeve	√
Asistent **Programet shkollore**		√
Asistent Shkolla/Edukimi		√

Figurë 99–Personeli i nevojshëm dhe fushat e përgjegjësive

E.3.6 Të dhënat financiare

Në gusht 2021 u përpunua një plan biznesi i fondacionit të ri, një përmbledhje e të cilit përfshihet në Aneksin G11. Këtu më poshtë janë përshkruar aspektet kryesore financiare.

Investimi total fillestar në objektet e reja të vizitorëve: 68,885,788 Lek

Shpenzimet fillestare që mbulojnë kostot që lidhen me ligjin dhe kontabilitetin fillestar, rekrutimin, trajnimin, marrjen e licencës dhe autorizimeve, blerjen e softuerit, etj: 4,739,500 Lek

Të ardhurat dhe kostot totale gjatë gjashtë viteve të para:

	Year 1	Year 2	Year 3	Year 4	Year 5	Year 6	Year 7
Të ardhurat vjetore	41,683,429	49,907,693	59,156,828	70,522,054	84,403,196	101,498,383	122,113,028
Kostot vjetore	72,909,245	75,104,582	77,645,048	80,576,145	85,593,853	90,988,826	93,913,382
(Bruto) Fitimi/Humbja Lek	-31,225,816	-25,196,889	-18,488,220	-10,054,091	84,403,191	10,509,557	28,199,646

Konvertimi i shumave nga USD në Lek është bërë me kursin e këmbimit të datës 19 dhjetor 2023 (1 USD = 94.79 Lek)

E.3.7 Programi i zhvillimit të turizmit kulturor

Organizimi i Zinxhirit të shërbimeve për Turizmin

Zhvillimi i turizmit kulturor të Durrësit kërkon organizimin e një zinxhiri shërbimesh të përkushtuar që merret me organizimin e atraksioneve bazë (siç u përmend më lart), përmirësimin dhe/ose përshtatjen e shërbimeve të prekshme dhe jo të prekshme ndihmëse në kontekstin e mikpritjes së turizmit.

Fondacioni zgjedh qasjen e gjerë që mund të këshillojë vetëm për çështje më të mëdha si akomodimi, aksesueshmëria dhe komoditetet. Sidoqoftë, një kontribut më i thellë mund të jepet drejt menaxhimit, imazhit dhe arsimit. Nëse fondacioni zgjedh qasjen e ngushtë, organizimi do t'i lejojë forcat e tregut ose veprimin e qeverisë të kontrollojnë zinxhirin e shërbimeve.

Figurë100 – Modeli konceptual

Shërbimet

1. **Akomodimi**

   Ndërhyrja në akomodim duhet të marrë parasysh veprimet e mëposhtme:

   - Akomodimi i përqendruar te turizmi kulturor dhe i eventeve (hotel butik/arti, hotele luksi, etj.);
   - Prezantimi i bujtinave në shërbim të shkollave ;
   - Përmirësimi i akomodimit informal

2. **Aksesueshmëria**

   Ndërhyrjet kryesore përfshijnë trenin me shpejtësi të lartë të parashikuar tashmë për në kryeqytet dhe në aeroportin ndërkombëtar, i cili është thelbësor për të zvogëluar distancën fizike nga tregjet ndërkombëtare;

3. **Komoditetet**

   Përveç atyre të parashikuara tashmë në sitet e trashëgimisë (të tilla si kafene në Muzeun Arkeologjik Kombëtar), ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

   - Planin e parkimit **me kapacitet në përputhje me kërkesën e parashikuar për Amfiteatrin**;
   - Lidhjen intermodale me portin, pasi eventet e darkave në Amfiteatër mund të bëhen interesante për turizmin në perspektivë të jahteve;
   - Vënien në përdorim të një qendre informacioni për vizitorët;
   - Stimulimin e aktiviteteve kulturore, veçanërisht **në arte & artizanat dhe organizimin e eventeve**, ndoshta nëpërmjet aksesit tek Fondi Lëvizës;
   - Certifikimin e **guidave turistike kulturore**.

4. **Aktivitetet**

   Ndërhyrjet kryesore përfshijnë organizimin dhe mundësimin e:

   - **Zhytjes me pajisje zhytjeje në rrënojat arkeologjike nënujore**;
   - **Paketave të përshtatura turistike** që kombinojnë komponentë të ndryshëm të trashëgimisë kulturore, për segmente të caktuara, përfshirë shkollat dhe programet e edukimit;

5. **Imazhi**

   Meqenëse imazhi përfaqëson një çështje madhore, transmetimi (shpërndarja) përfaqëson një mjet kyç për zhvillimin e turizmit dhe, veçanërisht, për transformimin nga turizmi bregdetar në një turizëm kulturor më të sofistikuar. Një strategji e tillë komunikimi duhet të bazohet në përdorimin e fortë të rrjeteve sociale dhe fushatës për shtyp së bashku me press tours dhe ture prezantimi të ofruara për gazetarët dhe operatorët turistikë.

6. **Edukimi**

   Përveç Aktiviteteve të parashikuara në Muzeun Kombëtar Arkeologjik si pjesë e strategjisë së programimit publik, zhvillimi i turizmit duhet t'i kushtojë vëmendje të madhe trajnimit dhe edukimit të personelit që do të punësohet nga sektori i trashëgimisë kulturore dhe nga shërbimet e induktuara.

   - Një shkollë artesh, kulture dhe performance
   - Forcim i edukimit për turizmin, mundësuar tashmë nga Universiteti i Durrësit

Kontributi për qëllimet e SKZHQT-së 2019-2023

Në tabelën vijuese, PM-ja ka krahasuar veprime që ndihmojnë për të zhvilluar turizmin e zonave arkeologjike të Durrësit me qëllimet specifike dhe të politikave të vendosura nga SKZHQT-ja 2019-2023 në mënyrë që të nxjerrë në pah qëndrueshmërinë dhe hapësirën për mbështetje reciproke.

Qëllimi specifik	Veprim i realizueshëm	Niveli i kontributit të planit (3 = i lartë; 2 = mesatar; 1 = i ulët)
Qëllimi i politikës 1: Promovimi i investimeve publike dhe private		
1.1 Promovimi i Investimeve Strategjike Private dhe tërheqja e markave të njohura ndërkombëtare në hoteleri dhe turizëm	Organizimi i ngjarjeve të mëdha në Amfiteatër në mënyrë që Durrësi të dallohet si vendi kryesor për organizimin e ngjarjeve të rëndësishme, gjë e cila do të stimulojë investitorët për investime të mëdha	3
1.2 Përcaktimi i zonave prioritare për zhvillimin e turizmit dhe orientimi i investimeve private drejt tyre.	Zhvillimi i Turizmit të Trashëgimisë Kulturore do të marrë në konsideratë investimet e PM-së, përfshirë Fondacionin e ri dhe shërbime specifike për t'iu përgjigjur nevojave të vizitorëve (restorante dhe shërbime kateringu, planifikim dhe menaxhim eventesh, etj.)	3
1.3. Orientimi i investimeve publike drejt zonave prioritare për zhvillimin e turizmit dhe destinacioneve turistike për përmirësimin e infrastrukturës së tyre themelore	Zhvillimi i turizmit të trashëgimisë kulturore do të sjellë përditësimin e infrastrukturës bazë së Durrësit si vendet e parkimit, shërbimet e informacionit turistik, etj.	3
2.1 Zhvillimi i modeleve të reja të vlerësimit, standardizimi, certifikimi dhe klasifikimi i shërbimeve për turizmin dhe operatorët turistikë	Zhvillimi i Durrësit si atraksion i trashëgimisë kulturore do të përfshijë promovimin e shërbimit për turizmin kulturor (hotele butik, hotele luksi, etj.)	2
2.2 Themelimi i një kuadri rregullator dhe institucional për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimeve në turizëm, si dhe përgatitjen e burimeve njerëzore të përfshira në këtë sektor	Zhvillimi i atraksioneve të trashëgimisë kulturore të Durrësit do të përfshijë zhvillimin e kualifikimeve të reja të tilla si: guida të specializuara turistike të trashëgimisë kulturore, planifikues eventesh dhe banketesh, menaxherë rekreacioni, etj.	2
2.3. Zhvillimi i Kuadrit Rregullator dhe Institucional për zhvillimin e shërbimeve dhe funksionimin e Porteve të Turizmit si dhe aktiviteteve në funksion të tyre	I parëndësishëm	1
3.1 Zhvillimi i një programi të turizmit detar e bregdetar si dhe krijimi i shërbimeve të reja	Zhvillimi i Durrësit si një pikë kyç atraktive e trashëgimisë kulturore do të inkurajojë investimet në lidhje me turizmin detar	2
3.2 Zhvillimi i një programi për Turizmin Natyror dhe krijimi i shërbimeve të reja	I parëndësishëm	1
3.3. Zhvillimi i një programi tematik të Turizmit dhe krijimi i shërbimeve të reja	Zhvillimi i Durrësit si një pikë kyç atraktive e trashëgimisë kulturore ka ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave specifike	3
4.1. Dizenjimi i Brand-it të turizmit dhe strategjive të marketingut	Zhvillimi i Durrësit si një pikë kyç atraktive e trashëgimisë kulturore, së bashku me organizimin e eventeve tematike në Amfiteatër do të ndihmojnë për diferencimin e Brand-it turistik shqiptar dhe për	3

	fokusimin te shërbimet autentike shqiptare të rrënjosura në mite dhe histori (p.sh., betejat detare)	
4.2. Promovimi i shërbimeve vjetore të turizmit brenda dhe jashtë vendit	Zhvillimi i Durrësit si një pikë kyç atraktive e trashëgimisë kulturore lejon uljen e sezonalitetit të turizmit, duke rritur kështu promovimin e shërbimeve vjetore të turizmit	3
4.3. Mbështetja e Agjentëve të promovimit në vend dhe në diasporë	I parëndësishëm	1

Figurë 101 –Kontributi i planit të menaxhimit të zonave arkeologjike Durrës në SKZHQT-në 2019-2023

Referencat ndërmjet objektivave dhe veprimeve

Për të integruar tri objektivat kryesore, ky seksion përdor referenca të kryqëzuara dhe forcon integrimin e PM-së. Lidhjet midis objektivave dhe veprimeve përshkruhen shkurtimisht më poshtë.

- Përdorimi aktiv i trashëgimisë kulturore të qytetit dhe procesi i valorizimit do të inkurajojë zgjedhjen e një modeli të ri të qeverisjes. Siç diskutohet në këtë seksion, kjo mund të lihet si shërbim i jashtëm nëpërmjet një kompanie eventesh duke u bazuar mbi testime për të provuar modelin.
- Projekti afatshkurtër për të vënë në përdorim amfiteatrin do të gjenerojë të ardhura, duke provuar kështu nevojën për krijimin e një fondacioni të ri.
- Përmirësimet e ruajtjes dhe prezantimit në tre projektet kryesore të zgjedhura të përmendura në objektivin e parë do të demonstrojnë rritje të vizitave dhe interesit. Sidoqoftë, midis banorëve kjo mund të rezultojë në një vizitë të vetme. Përdorimi i këtyre hapësirave në mënyrë të shpeshtë për aktivitete kulturore do të rezultojë në vizita të përsëritura.

Ë. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit fillon me një afat kohor në formën e një grafiku Gantt që i ndan projektet në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Kjo lejon lexim më të lehtë të afatit kohor dhe programimin e projekteve.

Kjo pasohet nga një matricë për secilën nga kornizat specifike kohore, periudhën afatshkurtër dhe afatmesme për 7 vitet e PM-së dhe periudhën afatgjatë përtej tij.

Matrica për secilin prej objektivave ndahet më tej në afatshkurtër (0-5 vjet), afatmesëm (6-10 vjet) dhe afatgjatë (11-15 vjet). Për projektet afatshkurtra të zbatimit në objektivin e parë, KONSERVIMI DHE PARAQITJA, katër Termat e Referencës janë zhvilluar tashmë për Amfiteatrin, Forumin Bizantin/Termat Romake, Muzeun Arkeologjik Durrës dhe Itineraret Kulturore Urbane. Këto katër projekte u zgjodhën bazuar në një listë të gjerë dhe analizë të çështjeve dhe mundësive të menjëhershme paralele me projektet e tjera që ndodhin në Durrës. Brenda secilit Term Reference (ToR) gjenden detyra shumë të përcaktuara të destinuara për publikim, për oferta dhe kontrata projektesh. Pas kësaj, do të realizohen projektet e zbatimit.

Për shkak se afati kohor është integruar brenda matricave gjatë këtyre tri periudhave të përcaktuara për objektivat specifike dhe detyrat mbështetëse, mund të jetë i vështirë për t'u lexuar. Prandaj është përfshirë, gjithashtu duke ndjekur matricat, një afat kohor në formën e një grafiku standard Gantt. Kjo mundëson leximin më të lehtë të afatit kohor. Plani i Veprimit, me objektivat e tij specifike, u zhvillua

bazuar në Raportin Fillestar të miratuar si dhe kërkimet, vëzhgimet dhe përfshirjen e palëve të interesuara. Objektivat janë strukturuar për të mbështetur vizionin e përgjithshëm.

Sipas rregulloreve, PM-ja është jo më pak se pesë vjet, por për PM-në kjo është përpunuar me një afat kohor shtatë-vjeçar. Pesë vjet afatshkurtër plus dy vjet shtesë për projekte në periudhën afatmesme. Për të ndjekur vizionin siç përshkruhet, periudha afatgjatë është përtej PM-së

Ë.1 Plani i veprimit, Afati kohor (7 vjet e përtej)

Ë.1 PLANI I VEPRIMIT, AFATI KOHOR [56]									
Viti Nr. i vitit	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Përtej 8-15
	TERMA AFATSHKURTËR						AFATMESËM		AFATGJATË
RUAJTA DHE PREZANTIM I PËRMIRËSUAR									
Amfiteatër									
Forumi/Termat									
Itineraret Kulturore Urbane									
Plani Interpretues dhe edukimor									
Gërmimet e Ardhshme Arkeologjike									
Zona e Përmirësimit të Turistëve, Rruga Tregtare, Citadela e Sipërme									
PDyD5s Qeveria Shqiptare, shpronësimet, prishjet									
UNOPS – Kulla Veneciane, Muzeu Arkeologjik, Hamami									
RRITJA E MBROJTJES									
Përshtatje e PM-së									
Përditësimi i listës së Pasurive Kulturore									
Rregullorja e përmirësuar për zonat arkeologjike A dhe B									
Zgjerimi i zonave arkeologjike A dhe B									
Përmirësimi i Master Planit									
Vënja në mbrojtje e Arkitekturës së shek. 20									
Vënja në mbrojtje Zona Arkeologjike Nënujore									
Mbrojtja e zonave të hapura arkeologjike									
Nominimi i Amfiteatrit, si Trashëgimia Botërore									
Hartimi i Planit të Menaxhimit të Rriskut									
Sistemi i Informacionit Gjeografik									
MENAXHIM, PËRDORIM DHE VLERËSIM I PËRMIRËSUAR									
Finalizimi i Përdorimit dhe Qasja Valorizuese									
Analiza e kërkesës së Turizmit									
Plani i gjeneruar i të Ardhurave									
Themelimi i Fondacionit të Ri									
Programi për Zhvillimin e Turizmit Kulturor									
Monitorim dhe zbatim plotësisht i Fondacionit									

[56] Projektet e treguara me gri të çelët janë të ndara nga procesi i formulimit të PMI, por ende kontribuojnë në strategjinë e përgjithshme.

Ë.2 Masat fizike afatshkurtra.* (5 vitet e para *të PM-së)

PLAN VEPRIMI AFATSHKURTËR (5 vitet e para)					
Detyrat (Veprimet)	**Institucioni Përgjegjës**	**Autoriteti miratues / mbikëqyrës**	**Afati kohor**	**Kohëzgjatja**	**Buxheti (LEK) (kostot e vlerësuara të investimit)**
RUAJTA DHE PREZANTIM I PËRMIRËSUAR (Projektet e treguara me gri të çelur janë të ndara nga procesi i formulimit të IMP, por kontribuojnë në strategjinë e përgjithshme)					
Masat fizike (Ndërhyrjet restauruese dhe rijetëzuese)					
Amfiteatri Termat e referencës të miratuara, botuara, Realizimi i konservimit të Amfiteatrit, hapja e hapësirave për evente	MK	MK	1-4 ose 5	1 vit planifikim, 1.5 vjet zbatim, 2 vjet valorizim, funksionim, vlerësim, përmirësim.	317,546,500 (shih seksionin E.1.1)
Forumi/Termat Termat e referencës të miratuara, botuara Zbatimi i projektit	MK	MK	1-4	0.5 vjet planifikim, 1 vit zbatim, vlerësim, valorizim	221,808,600
Itineraret Urbane Termat e referencës të miratuara, botuara, , & zbatimi i projekti	Bashkia Durrës	MK, Bashkia Durrës	2-4	0.5 vjet planifikim, 1.5 vjet zbatim (për të zgjidhur çështjet ligjore)	151,664,000 (shih seksionin E.1.1)
Interpretimi dhe plani i edukimit	MK	MK	3-6	4 vite	
Zona e Përmirësimit të Turistëve Fasadat e Rrugës së Tregtarëve Restaurimi i Citadelës së Sipërme Infrastruktura e rrugëve	MK	MK, Bashkia	2021-2022	1 vit	473,950,000 (e llogaritur)
PDyD5s Qeveria Shqiptare, Shpronësimi, zhvendosja, prishja e ndërtesave	Qeveria Shqiptare	MK	2021-2023	2 vite	947,900,000 (e llogaritur)
UNOPS Kulla Veneciane, Muzeu Arkeologjik, Hamami	UNOPS	MK	2021-2024	3.5 vite	1,421,850,000 (e llogaritur)

Konvertimi i shumave nga USD në Lek është bërë me kursin e këmbimit të datës 19 dhjetor 2023 (1 USD = 94.79 Lek)

PLAN VEPRIMI AFATSHKURTËR (5 vitet e para)					
Detyrat (Veprimet)	**Përgjegjës**	**Autoriteti miratues / mbikëqyrës**	**Afati kohor**	**Kohëzgjatja**	**Buxheti (LEK) (vlerësimi bazuar në eksperiencë)**
RRITJA E NIVELIT TË MBROJTJES (Aprovimi dhe zbatim i i çdo projekti mund të fillojë në vitin 2 ose më vonë, por veprimet e parashikuara përgatitore duhet të fillojnë në vitin 1 dhe do të kontribuojnë në planin e përgjithshëm.)					
Kuadri ligjor dhe instrumentet e mbrojtjes					
Përshtatje e PM-së përfshirë Planin e Biznesit	MK	Ministria e Kulturës, Bashkia Durrës	0-1	1 vit	Vetëm buxheti i stafit të brendshëm
Përditësimi i listës së pasurive kulturore Vënja në mbrojte e ndërtesave dhe zonave me vlera kulturore.	MK	MK	1 -4	4 vite	Vetëm buxheti i stafit të brendshëm
Rregullorja e përmirësuar për zonat arkeologjike A dhe B	MK	MK, Bashkia Durrës	1-4	4 vite	Vetëm buxheti i stafit të brendshëm, 9,479,000 vlerësimi i tarifës ligjore
Zgjerimi i zonave A dhe B	MK, IA	MK	5-6	2 vite	Vetëm buxheti i stafit të brendshëm, 9,479,000 vlerësimi i tarifës ligjore
Zgjerimi i Masterplanit të Durrësit	MK	MK	4-5	1 vit	47,395,000
Mbrojtja e Arkitekturës së shek. 20 Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore, referuar Ligjit. N. 27/2018 për të vënë në mbrojtura ndërtesa të shekullit të 20-të	MK	MK	2-3	1 vit	Për tu përcaktuar
Hartimi Plani të Menaxhimit të Rriskut	Bashkia	Bashkia	4-5	1 vit	7,583,200
Sistemi i Informacionit Gjeografik GIS	Bashkia	Bashkia / Kadastra	4-5	1 vit	9,479,000

Konvertimi i shumave nga USD në Lek është bërë me kursin e këmbimit të datës 19 dhjetor 2023 (1 USD = 94.79 Lek)

PLAN VEPRIMI AFATSHKURTËR (5 vitet e para)					
Detyrat (Veprimet)	**Përgjegjës**	**Autoriteti miratues / mbikëqyrës**	**Afati kohor**	**Kohëzgjatja**	**Buxheti (LEK) (vlerësimi bazuar në eksperiencë)**
MENAXHIM, PËRDORIM DHE VLERËSIM I PËRMIRËSUAR					
Integrimi i trashëgimisë kulturore në jetën e komunitetit, gjenerimi i vlerave te shtuara për nje konservim të qëndrueshem					
Themelimi i Fondacionit të Ri	MK	Ministria e Kulturës, Bashkia Durrës	1-2	2 vjet	47,395,000 kostot e fillimit për themelimin e fonacionit
Finalizimi i Përdorimit dhe Qasja Valorizuese Studimi i kërkesës turistike, të kuptuarit e kohës së lirë, Shtimi i vlerave të katër vendeve të trashëgimisë kulturore	MK	Ministria e Kulturës, Bashkia, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2-3	2 vjet	23,697,500
Analiza e Kërkesës së Turistëve	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MK	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	4-5	1 vit	Buxheti i stafit të brendshëm
Krijimi i një plani për gjenerimin e të ardhurave **Testimi i eventeve** Kontraktimi i kompanive për menaxhimin e eventeve, vlerësimi i shitjeve të biletave, Vizitat me guidë, Festivalet, etj.	MK, Partneri Strategjik	MK	2-4	3 vjet	47,395,000 për kompaninë e eventeve
Qasja e Menaxhimit të Pronave Kulturore	MK, Muzeu	MK	1-2	1 vit	Buxheti i stafit të brendshëm
Programi i Zhvillimit të Turizmit Kulturor	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MK	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MK	3-4	2 vjet	Për t'u përcaktuar

Konvertimi i shumave nga USD në Lek është bërë me kursin e këmbimit të datës 19 dhjetor 2023 (1 USD = 94.79 Lek)

Ë.3 Masat fizike afatmesme. Viti i 6-të dhe 7-të

PLAN VEPRIMI AFATMESËM (viti i 6-të dhe i 7-të)					
Detyrat (Veprimet)	**Përgjegjës**	**Autoriteti miratues / mbikëqyrës**	**Afati kohor**	**Kohëzgjatja**	**Buxheti (LEK) (vlerësimi bazuar në eksperiencë)**
RUAJTJA DHE PREZANTIMI I PËRMIRËSUAR					
Ndërhyrjet fizike					
Gërmimet e ardhshme arkeologjike	IA	Ministria e Kulturës, Bashkia Durrës	6- 7 dhe përtej PM	Varet nga shtrirja e vendosur	Për t'u përcaktuar
RRITJA E NIVELIT TË MBROJTJES					
kuadri ligjor dhe instrumentet e mbrojtjes					
Zona Arkeologjike Nënujore	IA	Ministria e Kulturës, Bashkia, IA, Agjencia Kombëtare e Mjedisit	6-7	2 vjet	23,697,500
Mbrojtja e siteve arkeologjike periferike	IA, MK	MK	6-7	2 vjet	Për t'u përcaktuar
Nominimi i Amfiteatrit në Listën e Trashëgimisë Botërore Analiza pse nominimi u refuzua, përgatitja e një dosje të re, fillimi i lobimeve	MK	MK	6-7	2 vjet	47,395,000
MENAXHIM, PËRDORIM DHE VLERËSIM I PËRMIRËSUAR					
Integrimi i trashëgimisë kulturore në jetën e komunitetit, gjenerimi i vlerave te shtuara për një konservim të qëndrueshëm					
Zhvillimi i turizmit kulturor, kontribut në qëllimet e SKZHQT	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MK, Bashkia Durrës	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MK, Bashkia Durrës	6-7	2 vjet	23,697,500

Konvertimi i shumave nga USD në Lek është bërë me kursin e këmbimit të datës 19 dhjetor 2023 (1 USD = 94.79 Lek)

Ë.4 Plani Afatgjatë i Veprimit -përtej MP-së

PLAN VEPRIMI AFATGJATË përtej 7 viteve të PM-së					
Detyrat (Veprimet)	**Përgjegjës**	**Autoriteti miratues / mbikëqyrës**	**Afati kohor**	**Kohëzgjatja**	**Buxheti (LEK)**
RUAJTJA DHE PREZANTIMI I PËRMIRËSUAR					
Ndërhyrjet fizike					
Vazhdimi i gërmimeve arkeologjike në qytet	IA, kompani private me licenca	Ministria e Kulturës	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar
RRITJA E NIVELIT TË MBROJTJES					
kuadri ligjor dhe instrumentet e mbrojtjes					
Vazhdimi i mbrojtjes së zonës arkeologjike nënujore	MK	Ministria e Kulturës, Bashkia Durrës	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar
Vazhdimi i mbrojtjes dhe gërmimi i siteve arkeologjike periferike	MK	MK	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar
MENAXHIM, PËRDORIM DHE VLERËSIM I PËRMIRËSUAR					
Integrimi i trashëgimisë kulturore në jetën e komunitetit, gjenerimi i vlerave te shtuara për një konservim të qëndrueshëm					
Vazhdimi i monitorimit të fondacionit të ri	MK	Ministria e Kulturës, Bashkia Durrës	4-8 dhe përtej	4 vjet	Për tu përcaktuar

F. IMPLEMENTIMI dhe MONITORIMI

Një PM nuk duhet të jetë një dokument statik, por një mjet për të trajtuar çështjet e identifikuara më parë, për të vendosur vizionin, objektivat dhe për të caktuar përgjegjësitë. Por është jashtëzakonisht e vështirë të planifikosh për pesë vjet, aq më pak për njëzet vitet e nevojshme për të ndjekur një vizion frymëzues. Ndodhin ndryshime politike, paraqiten sfida të reja, gjithashtu mund të përfshihen mundësitë gjatë hartimit të kësaj PM-je. Prandaj, PM-ja duhet të zhvillohet dhe të ketë një mekanizëm për t'u përshtatur me ndryshimet. Kjo e bën thelbësor ZBATIMIN dhe MONITORIMIN, jo vetëm për të siguruar që plani po shkon drejt objektivave të deklaruara, por dhe duke iu përshtatur ndryshimit të rrethanave. Brenda këtyre seksioneve gjenden matjet dhe treguesit për zbatimin e planit të menaxhimit në mënyrë që të arrihen objektivat e deklaruara.

F.1 Koordinimi dhe menaxhimi ndërinstitucional

Miratimi, koordinimi dhe menaxhimi i PM-së do të përfshijë formimin e një komiteti koordinues për të siguruar arritjen e strategjisë së PM-së nëpërmjet zbatimit të të gjitha aktiviteteve kryesore dhe të vogla. Përgjegjësia për koordinimin e këtij komiteti do të jetë nën drejtimin e Ministrisë së Kulturës, e cila do të caktojë përfaqësuesin e saj. Brenda menaxhimit, struktura do të përfaqësohet nga të gjithë aktorët kryesorë të përfshirë në zhvillimin e projekteve të ndryshme, përfshirë një përfaqësues të njësisë që do të promovojë zhvillimin kulturor.

- **MK**
- **MTM**
- **Partneri strategjik ose donatorët në përgjithësi/IA**
- **Fondacioni i ri**
- **Bashkia Durrës**

Përveç subjekteve që duhet të përfshihen vazhdimisht për të siguruar bashkërendimin e projektit, optimizimin e burimeve dhe respektimin e afatit të zbatimit, është e nevojshme të përfshihen dhe institucione shtesë kulturore të Durrësit dhe pronarët e monumenteve të mbrojtura.



Figurë 102–Struktura e Koordinimit dhe Menaxhimit ndërinstitucional të PM-së

F.2 Qasja e zbatimit dhe strategjia

